

1 E mërkurë, 17 korrik 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 9.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretar i
6 seancës, ju lutem paraqisni lëndën.

7 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Kjo është çështja KSC-
8 BC-2020-06, Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit,
9 Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Ju
10 faleminderit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

12 Vërej që të gjithë të akuzuarit janë të pranishëm në
13 sallën e gjyqit.

14 Përpara se të vijojmë me dëshminë e Dëshmitarit të
15 Prokurorisë W04752, është një aspekt paraprak që dëshiroj ta
16 trajtoj.

17 Trupi Gjykses vëren se është bërë një korrespondencë
18 *inter partes*, ku Mbrojtja ka kërkuar disa ndryshime të afateve
19 sa u takon disa parashtrimeve të protokolluara që do të
20 dorëzojë ZPS-ja, po këto periudha i takojnë të jenë brenda
21 periudhës së pushimit të Gjykatës. Veçanërisht, Mbrojtja
22 propozon që të ndryshohet kalendari i afateve për kërkesat e
23 pritshme në bazë të rregullës 153 dhe 154 dhe mocionet
24 jогоjorë të ardhshëm, si dhe rishikimin e transkripteve gjatë
25 kësaj periudhe kohore.

1 ZPS-ja dhe Mbrojtësi i Viktimave pajtohen me propozimin e
2 Mbrojtjes.

3 Sidoqoftë, Trupi Gjykses vëren se kjo kërkesë nuk i është
4 dorëzuar formalisht Trupit Gjykses. Prandaj do të donim që
5 Mbrojtja ose ta trajtojë tani para Trupit Gjykses me gojë këtë
6 çështje ose të dorëzojë një kërkesë me shkrim në mënyrë që ne
7 të marrim vendim.

8 Dhe gjithashtu Trupi Gjykses kërkon që ZPS-ja të
9 konfirmojë parashtrimin e protokolluar që synon të dorëzojë
10 përpara pushimit të Gjykatës.

11 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po. Jemi konsultuar ne me
12 Mbrojtjen edhe po ju themi që parashtrimin e protokolluar
13 synojmë që ta dorëzojmë ose këtë javë ose javën e ardhshme.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mbrojtja ka
15 gjë për të thënë?

16 Z. ROBERTS: [Përkthim] Po. Më jepni pak mundësi të shikoj
17 cilat afate kemi kërkuar.

18 Po, kemi diskutuar me Prokurorinë dhe besoj se jemi
19 pajtuar tani në mënyrë që të planifikojmë përgjigjet që do t'u
20 japim ne mocioneve që do të dorëzojë Prokuroria në mënyrë që
21 të mos vonojmë dhe vendimin që do të merret në lidhje me to.

22 Kemi mocion për rregullën 154 që do ta dorëzojë
23 Prokuroria sa i takon dëshmitarëve që janë të planifikuar në
24 bllokun e parë pas pushimit të Gjykatës. Pra, ne synojmë t'u
25 përgjigjemi brenda dhjetë ditësh, por kjo është para pushimit

1 të Gjykatës dhe në mënyrë të tillë do merret dhe vendimi që të
2 mos vonojmë dëshmitarët që do të vijnë. Më duket se janë vetëm
3 dy-tre dëshmitarë për të cilët s'është marrë vendimi sipas
4 rregullës 154.

5 Sa i takon mocionit 153, kemi propozuar një shtyrje të
6 afatit deri më 30 gusht që i takon e premtë.

7 Kjo është një kundërpërgjigje e një mocioni jogojor, për
8 këtë mocion jogojor kemi kërkuar shtyrje të afatit deri më 6
9 shtator.

10 Dhe mocione të tjera të rregullës 154 që lidhen me
11 dëshmitarët që nuk janë pjesë e bllokut të parë pas pushimeve
12 të Gjykatës, ne kemi kërkuar të shtyhet afati për t'u
13 kundërpërgjigjur mocionit të Prokurorisë më 23 gusht që është
14 e premtë.

15 Ne urojmë që Trupi Gjykses të na japi mundësinë që të
16 shtyjmë afatin për përgjigjet që janë më urgjente më 29 korrik
17 dhe 16 gusht.

18 Gjithashtu është dhe një rishikim transkripti që i takon
19 të bëhet brenda periudhës që është pushimi i Gjykatës. Po kjo
20 nuk është vetëm për ne, kjo është një afat për të gjitha palët
21 meqë janë pushimet e Gjykatës dhe kjo nuk mund të rishikohet,
22 do i kërkonim që të shtyhej afati për rishikimin e këtij
23 transkripti deri më 16 shtator që po ashtu është e premtë.

24 Sa u takon momentit aktual, në qoftë se nuk do të ketë
25 mocione që do të dorëzohen aktualisht, ne nuk kemi ndonjë

1 ndryshim afati rrjedhimisht.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Laws.

3 Z. LAWS: [Përkthim] Nuk kam asgjë për të thënë.

4 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dua t'ju informoj që do ketë një

5 kërkesë për një videolidhje që do bëhet nesër. Është një

6 kërkesë shumë e shkurtër, ta keni parasysh këtë gjë.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

8 Në rregull.

9 Duke marrë parasysh parashtrimet e palëve, Trupi Gjykses
10 mendon se janë dhënë arsye të vlefshme për të miratuar

11 ndryshimet e afateve në mënyrë që Mbrojtja t'u

12 kundërpërgjigjet mocioneve të ZPS-së, si dhe të ndryshohet

13 afati për rishikimin e transkriptit.

14 Rrjedhimisht, Trupi Gjykses miraton në bazë të rregullës

15 9(5) ndryshimet e afateve: Së pari, për çdo kërkesë për

16 pranimin e deklaratave të dëshmitarëve sipas rregullës 154 për

17 dëshmitarët që duhet të paraqiten pas 5 shtatorit 2024 por

18 kërkesat duhet të dorëzohen para pushimit të Gjykatës. Trupi

19 Gjykses miraton kërkesën e Mbrojtjes për shtimin e afatit në

20 mënyrë që t'u kundërpërgjigjet mocioneve deri më 23 gusht

21 2024. Trupi Gjykses thekson se kjo nuk përfshin përgjigjet sa

22 u takon kërkesave për pranimin e deklaratave të dëshmitarëve

23 sipas rregullës 154 që janë të planifikuar për bllokun e parë

24 pas pushimit të Gjykatës që i takon nga 19 gushti deri më 5

25 shtator.

1 Mbrojtja do t'u përgjigjet këtyre kërkesave në përputhje
2 me afatet që janë parashikuar aktualisht në rregullore.

3 Së dyti. Për çdo kërkesë për pranimin e deklaratave në
4 bazë të rregullës 153 të dorëzuara para pushimit të Gjykatës,
5 Trupi Gjykues miraton kërkesën e Mbrojtjes për shtimin e
6 afatit për t'iu kundërpërgjigjur mocioneve të Prokurorisë deri
7 të premtën deri më 30 gusht 2024.

8 Së treti. Për mocionin e ardhshëm jogojor nga Prokuroria
9 që është parashikuar të dorëzohet para pushimit të Gjykatës,
10 Trupi Gjykues miraton shtimin e afatit, e shtyn rrjedhimisht
11 afatin për 23 gusht 2024 që është e premtë.

12 Së katërti. Për çdo rishikim transkripti që është
13 parashikuar të kryhet gjatë pushimit të Gjykatës, Trupi
14 Gjykues ndryshon afatin për palët dhe pjesëmarrësit në mënyrë
15 që të bëjnë parashtrimet e tyre deri të premtën më 13 shtator
16 2024.

17 Me kaq mbyll urdhrin me gojë.

18 Tani jemi gati të vijojmë me dëshminë e dëshmitarit.

19 Ju lutem, sillni dëshmitarin në sallë.

20 [Dëshmitari vijon dëshminë]

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjesi,
22 z. Zyrapi.

23 DËSHMITARI: Mirëmëngjesi.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Edhe një herë
25 ju rikujtoj t'u përgjigjeni pyetjeve qartë me fjali të

1 shkurtra. Nëse se kuptoni një pyetje, lirisht kërkoni që
2 pyetja të përsëritet ose thoni që nuk e kuptoni në mënyrë që
3 pyetja të sqarohet. Gjithashtu mos harroni të na thoni ku e
4 bazoni ju njohurinë, faktet dhe rrethanat për të cilat do t'ju
5 bëjnë pyetje.

6 Gjithashtu, flisni pranë mikrofonit, prisni pesë sekonda
7 përpara se t'i përgjigjeni pyetjes si dhe flisni ngadalë për
8 hir të përkthyesve.

9 Në çdo moment që keni nevojë për pushim, na thoni dhe do
10 ta bëjmë të mundur.

11 Ju rikujtoj se jeni ende nën betim për të thënë të
12 vërtetën sikurse vetë e deklaruat përmes betimit solemn.

13 Siç ju këshillova dhe javën e kaluar, nuk jeni i detyruar
14 t'u përgjigjeni pyetjeve vetinkriminuese me përjashtim të
15 rasteve kur ua kërkon këtë Trupi Gjykses. Nëse lind një pyetje
16 e tillë, ju përmes Avokatit tuaj mund ta ngrini këtë çështje
17 para Trupit Gjykses dhe do të vendosim ne nëse do të
18 përgjigjeni apo jo dhe në ç'rrethana mund të detyroheni për
19 t'u përgjigjur.

20 Tani kemi pyetjet nga Gjykatësi Mettraux. Gjykatësi
21 Mettraux është në të djathtën time, në të majtën tuaj. Ju
22 lutem dëgjojeni me vëmendje.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësit
24 Smith.

25 DËSHMITARI: BISLIM ZYRAPI [Vijon]

1 Pyetjet nga Trupi Gjykses: [Vazhdim]

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mirëmëngjesi, z. Zyrapi.

3 Uroj të jeni shplodhur pak dje.

4 PË. Mirëmëngjesi. Po, faleminderit.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Njësoj si kolegu im,
6 Gjykatësi Barthe, edhe unë kam nevojë për disa sqarime që
7 lidhen me dëshminë që keni dhënë më herët. Unë do të filloj
8 duke i kërkuar Sekretarit të seancës të vendosë në ekran
9 provën materiale P1384.

10 Z. Zyrapi, a ju kujtohet që ua tregoi këtë dokument një
11 nga avokatët dhe folët për takimin që pretendohet që është
12 mbajtur më 14 korrik 1998? A ju kujtohen pyetjet lidhur me
13 këtë?

14 PË. Po, më kujtohet dokumenti.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Siç e kuptova unë, dhe më
16 korrigjoni nëse e kam gabim, ju lidhur me këtë takim të
17 Shtabit të Përgjithshëm që në fakt është 24 korrik 1998, ju
18 thatë se nuk keni ditur që është mbajtur një takim i tillë dhe
19 thatë mendimin tuaj se do të kishte qenë e pamundur që Shtabi
20 i Përgjithshëm të takohej në këtë datë për shkak se kishte
21 luftime në vazhdim e sipër, kështu?

22 PË. Po. po, ashtu është.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani i lutem Sekretarisë
24 të nxjerrë në ekran provën 1138.

25 Do t'u shpjegoj fillimisht çfarë është kjo. Është një

1 dorëshkrim që mendohet që është i Jakup Krasniqit dhe që është
2 gjetur në shtëpinë e tij. E kuptoni këtë?

3 PË. Po.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shkojmë tek faqja
5 SPOE00231431. Edhe shqipja mban të njëjtin numër. Shkojmë më
6 poshtë dhe tek shqipja dhe tek anglishtja.

7 Fokusohu tek ky paragrafi që thotë, që fillon pas
8 paragrafit me shkronja të errëta. Është ky që thotë: "Në
9 mbledhjen e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së ..." Pas fjalës
10 "betohem". "Në mbledhjen e Shtabit të Përgjithshëm u UÇK-së
11 ..." E shihni?

12 PË. Po. Po e shof.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dorëshkrimi që i
14 atribuohet Jakup Krasniqi thotë:

15 "Në mbledhjen e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së të
16 mbajtur më 23 korrik 1998, është aprovuar rregullorja e
17 përkohshme e nënrepartëve të zbulimit në luftë."

18 E shihni këtë fjali?

19 PË. Po, po. Po, po e shoh.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Një poshtëshënim, ju lutem
21 të shkojmë ka një poshtëshënim tek pika 20. Mund ta shihni
22 këtu që në këtë poshtëshënim thuhet: "Procesverbal i Shtabit
23 të Përgjithshëm të UÇK-së 23 korrik 1998". E shihni këtë?

24 PË. Po, e shoh.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pyetja ime e parë është

1 kjo: A keni ditur ju që është mbajtur një takim nga Shtabi i
2 Përgjithshëm më 23 korrik 1998?

3 PË. Jo, nuk e kam ditë se në atë kohë ishin luftimet, në atë
4 kohë ishin luftimet te vijat e mbrojtjes në Rahovec, mes
5 Rahovecit dhe Malishevës. Kështu që s'ka mujt të jem në takim
6 në atë kohë. Edhe për këtë nuk më bien ndërmend që ka pas një
7 takim të tillë.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A është e drejtë të themi
9 që e njëjta gjë vlen dhe për takimin që pretendohet se është
10 mbajtur më 24 korrik 1998, pra, as për këtë takim nuk mund të
11 thoni nëse është mbajtur apo jo?

12 PË. Po. Nuk mund të them atë, se nuk kam qenë.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A e keni ditur ju që në
14 korrik të 1998, të paktën në bazë të këtij dorëshkrimi, thuhet
15 që në 23 korrik është miratuar rregullorja për nënrepartet e
16 zbulimit në luftë? Keni qenë në dijeni ju për këtë?

17 PË. Jo.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Për procesverbal, i njëjti
19 takim duket se përmendet në provën materiale P1277 në U105-
20 8836. Ky është libri i z. Krasniqi "Kthesa e Madhe".

21 Tani, i lutem Sekretarisë që të nxjerrë në ekran provën
22 materiale me numër P633.

23 Z. Zyrapi, ju kanë bërë disa pyetje lidhur me këtë
24 dokument, megjithatë kam dhe unë disa pyetje të tjera. Tani do
25 ju përmbledh një herë si e kam kuptuar unë dëshminë tuaj në

1 lidhje me këtë, dhe më korrigjoni ju lutem nëse e kam gabim,
2 dhe pastaj do bëj pyetje.

3 Ju na shpjeguat se ky është një dokument që është
4 përgatitur që ta nënshkruanit ju dhe do emëronit disa persona
5 ju në pozicione komanduese, si dhe eprorë të zonës së
6 Pashtrikut dhe ju refuzuat ta nënshkruanit këtë dokument. Dhe
7 na thatë dhe arsyet pse nuk deshët ta nënshkruani dokumentin.
8 A e përmblodha saktë këtë që na keni thënë?

9 PË. Po.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju i shpjeguat Gjykatësit
11 Barthe se ky dokument në veçanti është diskutuar në takimin e
12 Shtabit të Përgjithshëm, kështu ka ndodhur?

13 PË. Jo, ky dokument nuk u diskutu në Shtab të Përgjithshëm.
14 Se unë edhe atëherë kur më kanë pyet, atëherë kur është bë
15 diskutimi, është bë që të ndërrohet, të zëvendësohet
16 komandanti i zonës jo dhe komplet kjo komandë dhe këta, se nuk
17 është përgjegjësi e imja këto me u marrë. Në takim është fol
18 për q'atë çështje, jo për krejt eprorët qysh është kjo listë
19 ose për këtë dokument nuk është fol fare.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Atëherë a mund të na thoni
21 kur dhe në ç'rrethana të është paraqitur ky dokument për t'u
22 nënshkruar?

23 PË. Ky dokument asnjëherë nuk më është paraqitur për t'u
24 nënshkru. Dokumentin për herë të parë e kam pa kur kam ardhë
25 këtu në seancën përgatitore. Më herët s'e kam pa.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shkojmë më poshtë dhe tek
2 shqipja dhe tek anglishtja.

3 Së pari, a mund të na konfirmoni që vula në këtë dokument
4 është vula e Shtabit të Përgjithshëm?

5 PË. Po, vula është e Shtabit të Përgjithshëm.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po inicialet AG dhe AM në
7 të majtë? A mund të thoni të kujt janë këto iniciale?

8 PË. AG është Adem Grabovcit. AM nuk e di. Muj me kanë tjetër
9 që ka punue.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në cilën drejtori ka
11 punuar z. Grabovci në kohën që është përgatitur ky dokument?
12 Ju kujtohet?

13 PË. Në personel, drejtorja e personelit.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shkojmë prapë më lart në
15 dokument.

16 Marrim, për shembull, pikën 2, Sadik Halitjahën dhe
17 Nexhmedin Kastratin. A e dini kush i emëroi më pas këta në
18 pozitat që përmenden këtu?

19 PË. S'e ma vonë nuk e di. Tash duhet me pytun sektorin e
20 personelit. Po çka i përket Nexhmedin Kastratit e di që e ka
21 emnu komandanti i zonës. Se ai prej komandantit të brigadës ka
22 avancu në shef të shtabit të zonës për shkak të përvojës së
23 tij, aftësitë e tij dhe e ka ngrit në këtë detyrë.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nëse do ju thoja se janë
25 emruar të dy nga Shtabi i Përgjithshëm, ju keni arsye për ta

1 kundërshtuar këtë?

2 PË. Jo.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani dua të flasim për
4 diçka që i keni thënë z. Misetiç, Avokatit të z. Thaçi. Ai ju
5 pyeti dhe nëse mendoni që nëse e kam kuptuar gabim ma thoni ju
6 lutem. Në transkript është data 6 korrik 2024, faqja 17664 dhe
7 17665.

8 Z. Misetiç ju pyeti nëse, në këndvështrimin tuaj, roli i
9 Shtabit të Përgjithshëm ishte më shumë një rol komandues apo
10 koordinues. Dhe ju u përgjigjët se sipas jush ishte kryesisht
11 një rol koordinues, kishte një natyrë koordinuese. A ju
12 kujtohet që e thatë këtë?

13 PË. Po.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani kam nevojë për një
15 sqarim. A pajtoheni ju në terma të përgjithshëm që koordinimi
16 është një pjesë përbërëse e punës dhe të komandantëve
17 ushtarakë

18 PË. Po.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, me fjalë të tjera
20 koordinimi nuk është në konflikt me funksionin komandues, por
21 ndërlidhen me njëri-tjetrin. A pajtoheni me mua?

22 PË. Po, plotësisht.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe, në fakt, koordinimi
24 është një nga aspektet më kryesore të funksionit komandues
25 sepse shumë shpesh duhet të përpiqesh që njësi të ndryshme,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bislam Zyrapi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses (Vazhdim)

Faqe 13

1 degë të ndryshme të një ushtrie të punojnë me njëri-tjetrin,
2 kështu?

3 PË. Po, ashtu është.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe kjo është një nga
5 punët që keni bërë ju në cilësinë si shef shtabi, në cilësinë
6 tuaj si shef shtabi, saktë?

7 PË. Po, është detyra e shefit të shtabit.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani, do t'ju pyes për
9 diçka tjetër.

10 Z. Roberts, Avokati i z. Selimi, iu bëri disa pyetje për
11 përvojën tuaj në ushtrinë boshnjake, në armatën boshnjake.
12 Ndërsa znj. Alagenda, përfaqësuese e z. Krasniqi, të pyeti
13 për përvojën ushtarake që kishin anëtarët e Shtabit të
14 Përgjithshëm të UÇK-së. Ju kujtohen këto pyetje?

15 PË. Po.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani dua t'ju bëj këtë
17 pyetje unë. Së pari, a mund të ma konfirmoni që anëtarët e
18 Shtabit të Përgjithshëm të armatës boshnjake qoftë në komandën
19 e Sefer Halilovic apo Rasim Delic, të gjithë anëtarët e
20 Shtabit të Përgjithshëm, pra, atje, si kurse dhe ju, ishin
21 oficerë të karrierës? Stjepan Siber, Hadzihasanovic --

22 PËRKTHYESJA: Përkthyesi nuk i kapi të gjithë emrat, ju
23 kërkon ndjesë.

24 DËSHMITARI: Po.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Të gjithë këta ishin

1 oficerë me përvojë, oficer karriere, apo jo?

2 PË. Po. Në armatën boshnjake, domethënë, te shtabi i armatës
3 boshnjake 80 për qind kanë qenë oficerë të karrierës me
4 përvoja të larta të punës.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të na shpjegoni,
6 nëse e dini, pse në ndryshim me armatën boshnjake, pra, për
7 dallim nga armata boshnjake, në UÇK u vendos të kishte persona
8 që nuk kishin përvojë ushtarake që të ishin në nivel drejtues
9 të UÇK-së? Me përjashtimin tuaj. Pse ndodhi kështu për dallim
10 nga armata boshnjake?

11 PË. Po dallimin mes armatës boshnjake dhe UÇK-së është kjo se
12 armata boshnjake ka pas edhe sistemin komplet të jetës,
13 organizimit si të funksionimit të shtetit prej presidencës,
14 qeverisë, ministrave e të gjitha. Dhe të gjithë ata eprorët
15 cilët kanë qenë në dispozicion i ka sistemue në ushtrinë
16 boshnjake.

17 Kurse te ne, ne e kemi formu një ushtri e cila ka dalë
18 prej vullnetit të popullit dhe e cila nuk ka pasur këto
19 struktura si qeverinë apo presidencën apo ato që të jenë nën
20 t'i vendosë, t'i ofron. Dhe duke marrë parasysh tjetër arsye
21 është se këta djemtë, nga fillimi i Ushtrisë Çlirimtare të
22 Kosovë si grupet guerile që kanë fillu qysh nga 1993-1994,
23 kanë vepruar në këtë drejtim edhe si në shtab po ashtu në këto
24 zona sikur që kemi spjegju edhe më herët si grupe. Për atë dhe
25 nuk ka mujt të jenë, pjesa më dërmuese e eprorëve ushtarakë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bislam Zyrapi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses (Vazhdim)

Faqe 15

1 të cilët kemi punu në ish-armatën jugosllave kemi qenë jashtë
2 Kosovës, në përfundim në shtetet e ndryshme ku kemi jetuar.
3 Kështu që për këtë arsye kanë qenë këta.

4 Pastaj, arsyeja tjetër është pse nuk u bë plotësimi dhe
5 siç gjatë shqyrtimit e shpjeguar që edhe eprorët që kanë ardhë
6 që kemi kërku që të plotësohen shumica e atyne eprorëve është
7 ndalë nga Qeveri e Përkohshme në Shqipëri. Dhe normalisht nuk
8 kemi mujt t'i kemi në dispozicion në fillim këta eprorë, kurse
9 kemi mujt pak më vonë pasi kemi bë atë marrëveshje të hynin
10 një pjesë e eprorëve të plotësojmë disa resorë në të cilat
11 kemi fillu qysh nga nëntori, dhjetori të fillojmë në këtë
12 drejtim.

13 Këto janë arsyet e dallimit mes ushtrisë boshnjake dhe ne
14 nga aspekti jem.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Atëherë do ju bëj një
16 pyetje tjetër. Ju i thatë z. Misetic që ka pasur një listë të
17 gjatë ish-oficerësh të ushtrisë jugosllave dhe ju përmendët
18 Kurtesh Fondaj, Ekrem Rexha, ju vetë. Këta persona - nëse e
19 dini sigurisht - pse nuk u caktuan si pjesë e Shtabit të
20 Përgjithshëm të UÇK-së kur erdhën në Kosovë, pse nuk ndodhi?
21 PË. Pikë së pari, këta kanë qenë në Kosovë kur folëm këta dy
22 emra dhe Kurtesh Fondaj dhe komandant Drini. Ata veç janë kanë
23 në pozicionet e shtabeve lokale. Se për mua ma shumë rëndësi
24 ka qenë të plotësohen në fillim shtabet më poshtë lokale, ose
25 ndryshe, brigadat, zonat, të kenë ato janë njësi operative dhe

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bislam Zyrapi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses (Vazhdim)

Faqe 16

1 taktike që përdoren më shumti dhe aty duhet të jenë eprorët
2 ushtarakë më shumti. Dhe pastaj, në kohën kur është arritur në
3 nivelin më tutje, atëherë kemi fillu eprorë tjerë që kanë
4 ardhun nga jashtë t'i ofrojmë në drejtim të shtabit që ka
5 fillu të bëhet ristrukturimin e shtabit, se dhe vetë shtabi më
6 herët nuk ka qenë i ristrukturim i tillë që kemi mujt edhe pse
7 kemi kërkue që të plotësohet nga eprorët. Po s'kemi mujt t'i
8 plotësojmë në atë kohë. Këtë kemi fillu prej nëntorit, ku
9 shifet, kemi fillu dalëngadalë tuj plotësu edhe drejtorinë
10 operative edhe drejtori të tjera, deri në mars kemi arrit një
11 farë niveli me pru, po jo aq të kënaqun që me qenë të plotë
12 për menaxhimin edhe udhëheqjen e këtyne resorëve dhe
13 drejtorive dhe shtabit.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kam dhe dy pyetje të
15 mëtutjeshme lidhur me këtë që thatë.

16 E para: Sipas jush, kush e zgjodhi grupin e parë të
17 anëtarëve që aso kohe quhej Shtabi Qendror dhe më pas u bë
18 Shtabi i Përgjithshëm? Pra, Azem Syla, Hashim Thaçi dhe të
19 tjerët që ishin anëtarët e parë të atij grupi, me aq sa keni
20 ju dijeni, ata i caktoi dikush apo u vetëcaktuan në këto
21 pozicione?

22 PË. Simbas asaj që unë e di, që Shtabi Qendror është përcaktu
23 dhe ky është UÇK-ja qysh ka lind nga partia politike e asaj
24 kohe LPK, Lëvizja Popullore e Kosovës dhe ajo në atë kohë i ka
25 përcaktuar në shtabin Qendror. Si, mënyrën, qysh janë taku,

1 nuk e di atë periudhë dhe si ka shku. Kaq di për këtë veprim.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani po të pyes si oficer
3 me përvojë, ushtarak, z. Zyrapi. Me aq sa e keni kuptuar ju,
4 çfarë pasoje ka pasur, në qoftë se ka pasur ndonjë pasojë, të
5 personave të cilët nuk kanë pasur përvojë ushtarake dhe që
6 janë vënë si përgjegjës për një organizatë ushtarake? Sipas
7 mendimit tuaj, sipas përvojës tuaj ushtarake, a ka pasur kjo
8 ndonjë pasojë ose ndonjë pasojë potenciale të mundshme dhe në
9 qoftë se po, çfarë pasoje do të kishte qenë kjo?

10 PË. Po. Pasojat mund të janë zhvillimi i shpejtë dhe
11 ristrukturimi i shpejtë i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe
12 hyrjes në sistemin ushtarak. Kjo është një, një pasojë e
13 madhe. E dyta është pasoja që kemi pas edhe gjatë shqyrtimeve
14 nëpër marrje e masave operationale të cilat pa i shqyrtuar, pa
15 i përgatitur njësitë, pa u përgatitë vetë për operatione të
16 tilla janë marrë. Kjo është pasoja të cilat ne i kemi vuajtur
17 në atëkohë.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A do ishte mënyrë e drejtë
19 ose e pranueshme të thuhet që në qoftë se do të ishin vendosur
20 persona me përvojë ushtarake në organizata ushtarake mund të
21 ekzistonte rreziku që vetë organizata të shpërbëhej, të
22 çorganizohet? A do pajtoheshit me mua në qoftë se do e thoja
23 këtë gjë, Dëshmitar?

24 PË. Mund me përsërit pak, se s'e kuptova mirë?

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Thuaje dhe një herë sepse

1 nuk e dëgjova përkthimin, z. Zyrapi.

2 PË. Mund të ma përsëritni se nuk e kuptova?

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pyetja ime është kjo: Nëse
4 vendos persona pa përvojë ushtarake përgjegjës për të drejtuar
5 një strukturë ushtarake, një organizatë ushtarake, a ekziston
6 rreziku që një strukturë e tillë të mos funksionojë siç duhet,
7 siç duhet, në fakt, të kishte funksionuar po të ishte ndryshe?

8 PË. Po, është edhe ai rrezik, e kuptueshme, por nuk kemi pas
9 më tej tjerë. Me aq çka kemi pas veç këto çka kanë qenë kemi
10 menaxhu e kemi ec.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Na thatë që jeni emëruar
12 që të ishit drejtori i drejtorisë operative në mes të korrikut
13 të vitit 1998, a është e saktë kjo?

14 PË. Po.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të na thoni, ju
16 lutem, se kush ka qenë, nëse të kujtohet, kush ka qenë personi
17 që e ka komunikuar këtë emërim tuajin?

18 PË. Sokol Bashota.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A do kisha të drejtë po të
20 thoja që emërimi tuaj si drejtor i drejtorisë operative do
21 jetë mbështetur në rregulloren e përkohshme të UÇK-së për
22 organizimin e jetës së brendshme të ushtrisë, a do kisha të
23 drejt në këtë gjë?

24 PË. Po, me siguri po, ndoshta janë bazuar në ato se nuk e di.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në librin e tij - që për

1 procesverbal është prova P1138 - Jakup Krasniqi sugjeron që
2 kjo rregullore e përkohshme është miratuar në takimin e
3 Shtabit të Përgjithshëm më 4 korrik të vitit 1998. Sa i takon
4 aspektit kohor, a përkon kjo me atë çfarë ju kujtohet juve
5 lidhur me këtë rregullore?

6 PË. Po sa i përket aspektit kohor mund të jetë që e kanë bërë
7 në atë kohë se unë nuk kam qenë unë në atë pozitën e
8 drejtorisë operative, drejtorit të drejtorisë operative dhe
9 nuk kam marrë pjesë në ato takime. Kështu që mund të
10 korrespondon me ato me emnimin tim, pastaj me rregulloren.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Tani kam
12 disa pyetje, në fakt, keni diskutuar aspekte të ndryshme me
13 drejtorinë e UÇK-së me Shtabin e Përgjithshëm. Megjithatë do
14 të doja t'ju bëja disa pyetje të tjera plotësuese lidhur me
15 këtë temë.

16 Së pari, na keni thënë që janë krijuar drejtori të
17 ndryshme në kohë të ndryshme ose në periudha të ndryshme, a
18 është e saktë kjo?

19 PË. Po.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A është e saktë të
21 kuptohet që kur është krijuar një drejtori e re, po ashtu
22 është caktuar edhe drejtori që do të udhëhiqte një drejtori të
23 tillë, është e saktë po të thuhet kjo?

24 PË. Po, saktë.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në aspektet ushtarake do

1 të thotë që nuk është se ka drejtori pa pasur një drejtor, me
2 fjalë të tjera, a është kështu?

3 PË. Po. Edhe drejtori edhe sektor nuk mundet të jetë në goftë
4 se nuk është një udhëheqës të tij.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mesa e kuptoj unë
6 procesin, ndërkohë që UÇK-ja ka krijuar drejtori, janë hartuar
7 gjithashtu edhe rregullore për funksionimin e këtyre
8 drejtorive të cilat më pas janë miratuar. A do ishte një
9 supozim i drejtë ky?

10 PË. Jo veç supozim, po është ashtu se me formimin e atyre
11 drejtorive ne kemi punuar detyrat dhe përgjegjësitë e atyneve
12 drejtorive dhe drejtorat që i kanë këto drejtori. Normalisht i
13 kemi përkthyer nga ushtritë e ndryshme. Me ato nevojat bazike
14 që u dasht që mund t'i përdornim në atë kohë.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe më pas caktohej stafi
16 përkatës për këtë drejtori, apo jo?

17 PË. Po. Pasi drejtori përcaktohet, pastaj drejtori përcakton
18 stafin e punës të tij.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Diçka për të cilën dua
20 t'ju pyes ka të bëjë me faktin se çfarë ka ndodhur ose më mirë
21 t'ju jap një shembull që ta kuptoni dhe për t'jua bërë pak më
22 konkrete pyetjen që të mos jetë shumë abstrakte.

23 Çfarë ndodh me një çështje përpara se të krijohet një
24 drejtori? Mund të jap një shembull për ta kuptuar më mirë
25 pyetjen time. Le të supozojmë që drejtorja e personelit ose e

1 kuadrove, që e keni quajtur juve, është krijuar në nëntor të
2 1998. Kush është marrë me çështjet e personelit më përpara? A
3 ka qenë një përpjekje e përbashkët, domethënë, që disa anëtarë
4 të shtabit janë marrë lidhur me çështje të shtabit apo çfarë
5 ka ndodhur, domethënë, kush i ka trajtuar çështjet që binin
6 nën drejtoritë përkatëse pasi janë krijuar drejtoritë përpara
7 sesa të krijoheshin këto drejtori?

8 PË. Po simbas asaj që mund ta vërej unë në atë kohë, pjesë të
9 personelit kanë krye gati thuaj këto drejtoritë që kanë qenë
10 aktive dhe anëtarët e shtabit kanë krye këtë detyrë sidomos në
11 administratën që kanë qenë pranë deri sa nuk është formue
12 drejtoria e personelit ose drejtoritë e tjera.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Është e
14 qartë.

15 Dua t'ju pyes lidhur me diçka që thatë që kishte të bënte
16 me drejtorinë e policisë ushtarake.

17 Mesa kuptoj unë dëshmia juaj është që ju besoni se kjo
18 drejtori është krijuar sipas jush, ju thoni, pra, që është
19 krijuar në fund të vitit 1998. A e kam kuptuar drejtë këtë?

20 PË. Po, në nëntor të 1998.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mesa kam kuptuar ju keni
22 thënë që në qoftë se do ishte krijuar më herët, ti do e kishe
23 ditur lidhur me krijimin e kësaj drejtorie. E kam kuptuar siç
24 duhet dëshminë tuaj?

25 PË. Po, saktë.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ky sugjerim ose ky mendim
2 që drejtorja për policinë ushtarake është krijuar diku nga
3 mesi i nëntorit ose fundi i nëntorit të vitit 1998 dhe lidhur
4 me këtë fakt ju keni dhënë dëshmi edhe në çështjen e Fatmir
5 Limës përpara Gjykatës Themelore të Gjakovës, a është e drejtë
6 kjo?

7 PË. Po.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Përsëri e kuptoj që ju nuk
9 jeni jurist me profesion, megjithatë a do ishte e drejtë që të
10 sugjerohej se kjo dëshmi ka qenë shumë e rëndësishme, ka qenë
11 kritike për pafajësinë e z. Limaj? A do pajtoheshit me
12 komentin tim?

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Kundërshtojmë. Është përfundim
14 juridik.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mund ta bëj dhe ndryshe në
16 fakt pyetjen. A e dini ju se mbi ç'bazë është deklaruar i
17 pafajshëm z. Limaj në çështjen që keni dhënë dëshmi ju?

18 PË. Nuk e di në cilën bazë. Po në dëshmi kam qenë aty.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A jeni në dijeni se cilët
20 persona të tjerë kanë dëshmuar për të njëjtën gjë sa i takon
21 kohës së krijimit të drejtorisë së policisë ushtarake në atë
22 çështje gjyqësore? A e dini se kush kanë qenë dëshmitarët e
23 tjerë për atë çështje që kanë dhënë të njëjtën dëshmi si ju sa
24 i takon kohës?

25 PË. Jo, nuk e di. Di që kanë qenë edhe shumë tjerë, po kush

1 saktë për këtë drejtim me dëshmu, nuk e di.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A jeni në dijeni se z.

3 Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi kanë dhënë dëshmi në atë

4 çështje?

5 PË. Jo, nuk kam dijeni në të.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit që

7 të paraqesë në ekran dokumentin SPOE00226858.

8 Do t'ju shpjegoj së pari se çfarë është ky dokument dhe

9 pastaj do ju jap kohën e nevojshme që ju duhet për ta lexuar

10 atë. Do t'ju tregoj pjesë të ndryshme të këtij dokumenti.

11 Është një dokument i cili i atribuohet Rexhep Selimit.

12 Do ishte mirë që të kalonim tek faqja tjetër në të dyja

13 gjuhët e dokumentit. Le të kalojmë në fund të kësaj faqeje. Po

14 ashtu edhe në fund të faqes dhe në versionin në anglisht.

15 Faleminderit.

16 Atëhere, siç mund ta shihni, pretendohet që autori i

17 këtij dokument të jetë Rexhep Selimi, si inspektor gjeneral i

18 UÇK-së dhe i është dorëzuar Z. Sadik Krasniqit.

19 Pyetja e parë që kam për ju është kjo: A mund të

20 konfirmoni se z. Selimi ka qenë dhe ka qëndruar inspektor i

21 përgjithshëm i UÇK-së deri në mars të vitit 1999, kur ai u bë

22 pjesë e Qeverisë së Përkohshme të Kosovës?

23 PË. Po.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ndërsa jemi tek kjo faqe,

25 desha t'ju pyes se kush është ky personi, z. Sadik Krasniqi?

1 PË. Jo, nuk e di.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] do i lutesha Sekretarit që
3 kalojmë tek faqja më përpara.

4 Pra, besoj se mund ta shikoni se çfarë dokumenti është
5 ky. Është një dokument i cili është gjetur në shtëpinë e z.
6 Selimi, pra, të Rexhep Selimit. E ka titullin "Rruga e
7 formimit dhe organizimit të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-
8 së". Dhe më tej thuhet "I dedikuar për: Muzeun e Kosovës. Ky
9 material nuk mund të përdoret apo të publikohet pa autorizim".

10 A e dini ju se çfarë është muzeu i Kosovës?

11 PË. Po, kjartë.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A është e drejt të thuhet
13 që ky është institucion i rëndësishëm kulturor në Kosovë?

14 PË. Po.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit
16 tani të kalojmë në faqen tjetër. Ju lutem shikoni fillimin e
17 kësaj faqeje, në versionin në shqip dhe është e njëjta gjë dhe
18 në versionin në anglisht.

19 Është një dokument i cili përshkruan organizimin e
20 Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së në maj të vitit 1998. A e
21 shikoni këtë?

22 PË. Po, po e shikoj.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Thuhet në këtë dokument
24 që:

25 "Në maj të vitit 1998 Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bislam Zyrapi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses (Vazhdim)

Faqe 25

1 formon të gjitha drejtoritë përbërëse të shtabit ku edhe merr
2 formën complete të tij që nga struktura komanduese e deri në
3 çdo detal përbërës të organizimit të Shtabit të Përgjithshëm”.

4 Më tej në dokument jepet një listë e drejtorive të
5 Shtabit të Përgjithshëm, vijohet me G1, G2, G3, G4, G5, G6,
6 G7. Dhe në G8 ka, drejtorinë e policisë ushtarake. A e shikoni
7 këtë, Dëshmitar?

8 PË. Po, po e shof.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A pajtoheni që, të paktën
10 sipas këtij dokumenti, drejtoria e policisë ushtarake
11 ekzistonte në maj të vitit 1998. A pajtoheni me këtë?

12 PË. Jo, nuk muj të pajtohem me këtë dokument edhe në këtë
13 kohë që është formu shtabi se nuk ka qenë shtabi i formu as
14 këto drejtoritë. Në atë kohë unë e kam cekë shumë mirë cilat
15 drejtori i kam njoft edhe cilat kanë qenë funksionale. Po të
16 gjitha këto, për shembull, drejtoria e personelit nuk është
17 formu në atë kohë. Ajo është formu qysh nga nëntori. Në qoftë
18 se ka pas diçka ndonjë sektor, diçka që ka punu është diçka
19 tjetër.

20 Me logjistikë është e kjartë se është baza në Shqipëri
21 dhe ka ekzistuar prej fillimit.

22 Marrëdhëniet civilo-ushtarake nuk kanë qenë. Marrëdhëniet
23 civilo-ushtarake si mbas strukturës të NATO-s është --

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ndaloni për një çast z.
25 Zyrapi.

1 Dje dhe përpara një jave ti na shpjegove që përgjegjësia
2 e z. Selimi ishte të dinte sesi funksiononte UÇK-ja, si
3 inspektor i përgjithshëm i UÇK-së. A është e drejtë kjo?
4 PË. Po. Po inspektor është vendosur në atë kohë kur kemi bë
5 ristrukturimin e Shtabit të Përgjithshëm. Deri atëherë nuk ka
6 pas inspektor të përgjithshëm. Domethënë, inspektori është
7 caktu tek nëntor kur e kemi bë në fillim ristrukturimin, jo në
8 maj. Ose data është gabim e gjithnjë ose nuk di çka kanë dasht
9 me thënë autori që e ka shkruar këtë. Se faktikisht unë po fol
10 ato çka unë kam gjet dhe çka di.

11 Në ato nuk kanë qenë këto drejtoritë të fomume. As
12 drejtoria e marrëdhënieve civilo-ushtarake. E ndërlihdjes nuk
13 ka pas fare. Tek u formu në nëntor. Financa ka qenë. Policia
14 ushtarake jo. Drejtoria politike nuk ka ekzistuar në atë kohë.
15 Inspektori gjeneral nuk e ka --

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Për ta përmbledhur
17 dëshminë tuaj, sipas jush, inspektori i përgjithshëm i UÇK-së
18 që pretendohet që ka shkruar këtë dokument ka bërë gabim,
19 kështu?

20 PË. Unë muj të them plotësisht që ka bë gabim, se q'ato
21 struktura nuk kanë qenë në maj, që thotë maj të 1998-s. Po të
22 ishin këto, unë do e kisha ditur, sidomos në qoftë se s'e kam
23 dit unë në maj, qershor, në korrik kemi vendos drejtorinë
24 operative se u dasht patjetër të koordinojmë me t'tjerët. E
25 kështu do e kisha ditur që ka dhe këto drejtoritë dhe këto

1 sektorë, po nuk ka pas.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit
3 tani të paraqesë në ekran dokumentin U015-8743 deri në U015-
4 9047.

5 Besoj se na keni thënë z. Zyrapi, që e dini që ekziston
6 ky libër, është ky libri që keni në ekran, që është një libër
7 i cili është botuar në vitin 2006, por që nuk e keni lexuar
8 atë, a është e saktë kjo?

9 PË. Po, e saktë.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Për procesverbal, pjesë të
11 ndryshme të këtij libri janë pranuar si prova materiale në
12 numrat P1277 dhe P189. Versioni që unë do përdor, domethënë,
13 është pranuar.

14 Megjithatë sa për ta shpjeguar, dua të them që libri i z.
15 Krasniqi është organizuar në mënyrë kronologjike ose ndjek një
16 lloj rendi kronologjik, dëshiroj të filloj nga maji i vitit
17 1998 dhe kjo përkon me faqen 85 ose me fjalë të tjera është
18 dokumenti U015-8828. Dhe po ashtu është prova materiale P1277.
19 Të njëjtën dhe në anglisht, ju lutem.

20 Këtu, z. Krasniqi, diskuton disa prej ngjarjeve për të
21 cilat ju keni dhënë dëshmi që kanë ndodhur në fillim të verës
22 të vitit 1998, duke përfshirë këtu njësitin Pëllumbi dhe
23 bashkimin e njësitit Pëllumbi me njësitin Lumi e Çeliku. A e
24 shikoni këtë, Dëshmitar?

25 PË. Po.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mendoj që nuk pajtoheni,
2 nuk është se keni ndonjë mospajtim në atë çfarë thotë z.
3 Krasniqi këtu ose me fjalë të tjera pajtoheni me atë çfarë ka
4 thënë z. Krasniqi?

5 PË. Tash, ça ka thënë z. Krasniqi është e tij. Unë s'i lexoj
6 librat për arsye se shumica e librave që shkruajnë pjesën më
7 të madhe e ekzagjerojnë prej realitetit që ka ndodhë. Mirëpo
8 tash këto ça ka shkruar, mund të jetë ashtu. Në qoftë se është
9 në pjesën që thonë prej organizimit qysh ka qenë në atë kohë
10 është e vërtetë. Kur kam ardhë kështu i kam gjet njësitë e
11 ndryshme.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Të kalojmë në faqen 88.
13 Ose me referencë tjetër është dokumenti U015-8831, i njëjti
14 numër është dhe për versionin në anglisht. Është po ashtu
15 numri i provës materiale P1277.

16 Këtu, z. Zyrapi, do ju lejoj që ta lexoni në qoftë se
17 doni që ta lexoni me mendje. Megjithatë thuhet në versionin në
18 anglisht që jepet një përshkrim i:

19 "Mungesës së burimeve financiare, na mungon logjistika,
20 furnizimin e të tjerë dhe po ashtu transporti bëhej kryesisht
21 me njerëz, me kafshë."

22 Gjithsesi këtu bëhet fjalë prap për majin e 1998-s.

23 "Dhe nga ana tjetër thuhet, që puna udhëheqëse dhe
24 komanduese por edhe sistematizimi i armëve po e pengonte
25 primitivizmi provincialist si dhe dëshira për të armatosur më

1 mirë 'njësitin tim' 'fshatin tim' e të tjerë ... natyrisht, në
2 fund pasojat i pësojnë të gjithë. Po këto pasoja ishin parë
3 edhe më herët, prandaj Shtabi i Përgjithshëm qe angazhuar për
4 shuarjen e njësiteve dhe formimin e formacioneve ushtarake
5 deri në formacionin e brigadës. Kjo do të bëhej pas ardhjes së
6 Bislum Zyrapi dhe Agim Qelës të cilët kanë dhënë kontribut të
7 çmuar për krijimin e formacioneve të rregullta të Ushtrisë
8 Çlirimtare të Kosovës."

9 A pajtoheni me rrëfimin që bën z. Krasniqi këtu? A është
10 në pajtim ai me atë çfarë keni gjetur ju kur erdhët në Kosovë,
11 kur u kthyet në Kosovë në maj të vitit 1998?

12 PË. Po. Po, e saktë.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani kalojmë tek faqja
14 tjetër.

15 Këtu, z. Krasniqi, diskuton se kush në atë kohë, në fazat
16 e hershme të verës së vitit 1998 e drejtonte UÇK-në.

17 Do i kërkoja Sekretarit që të kalonim pak më poshtë në
18 tekst për ta lexuar z. Zyrapi. Deri në fund te versioni në
19 shqip.

20 Mund ta lexoni vetë, z. Zyrapi. Kam të njëjtën pyetje për
21 ju. A është në të njëjtën linjë kjo me përvojën tuaj me
22 mënyrën sesi funksiononte Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së në
23 fillim të verës së 1998-s?

24 PË. Po.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani të kalojmë tek faqja

1 tjetër.

2 Këtu vazhdohet dhe përshkruhet diçka për të cilën ju keni
3 dhënë dëshmi që është përkatësisht njoftimi më 11 qershor të
4 vitit 1998, përmes Deklaratës Politike numër 3, që ai u shpall
5 zëdhënës i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Më tej vazhdohet
6 dhe përshkruhet përbërja e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së
7 në atë fazë, në atë kohë. A e shikoni këtë pjesë?

8 PË. Po.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mendoj që edhe kjo është
10 në pajtim me atë çfarë ju kujtohet juve lidhur me këtë
11 periudhë, apo e kundërshtoni ndonjë nga informacionet që jepen
12 këtu?

13 PË. Po së pari më poshtë po shkrun prapë ato pozitat
14 komanduese, dhe unë çka di hala nuk ka pas atëherë inspektor
15 të përgjithshëm, këtu shkrun që ka inspektor të përgjithshëm.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, përsëri sipas
17 dëshmisë tuaj dhe ky do ketë qenë gabim nga z. Krasniqi?

18 PË. Po sigurisht, po. Të paktën unë më nuk kam pas dijeni që
19 kanë pas këto drejtoritë që po shoh tash. Po të ishin, unë
20 thashë, nga korriku do të kisha koordinu me këto drejtoritë,
21 do të kisha pas nevojë për koordinim. Por nuk kanë qenë.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] The që nuk kanë qenë aty
23 apo nuk e dije në qoftë se kanë qenë aty?

24 PË. Për disa, për shembull, po. Drejtorinë për informim po,
25 drejtorinë -- kryeshefi për drejtorinë e shërbim informativ,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bislam Zyrapi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykues (Vazhdim)

Faqe 31

1 po. Ekonomi-financa, po, e kam ditë. Zëdhënësi po, ka qenë. Po
2 të thuhet kryshef prej drejtorie pushtet civil, nuk ka pas në
3 atë kohë s'është që është. Dhe logjistikës, furnizimit Xhavit
4 Haliti. E di që Xhavit Haliti ka qenë përfaqësues politik i
5 UÇK-së në Shqipëri dhe është marrë normalisht edhe me
6 logjistikat që ka ndihmuar. Se logjistikën atje është marrun
7 komandant Plaku, Xheladin Gashi dhe ai ka qenë përgjegjës për
8 logjistikën. Mua sa më kujtohet, në këtë periudhë kur folim
9 prej majit e tutje.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, nëse e kuptoj unë siç
11 duhet, z. Jakup Krasniqi që ka përshkruar veten si shef të
12 drejtorisë të autoritetit civil e ka pasur gabim, apo ju nuk e
13 keni ditur që ka ekzistuar një strukturë e tillë?

14 PË. Së pari, unë nuk di që ekziston një strukturë e tillë.
15 Një. E dyta, drejtori të pushtetit civil nuk ka pas. Çka e di
16 unë. Se po të ishte ato do t'i kisha pas mundësinë të
17 koordinoj me to punë për pushtet civil dhe ushtrinë. Për
18 zëdhënës e di që ka qenë i hapur dhe publik. Atë do ta
19 shpjegon z. Jakup Krasniqi pse e ka shkru kështu dhe në qoftë
20 se ka pas një strukturë të tillë, le ta shpjegon që ka pas.

21 Por unë nuk e di që ka pas strukturë të tillë dhe këto
22 pozicione. Marrim të paktën në atë kohë çka di unë deri sa kur
23 kam marrë drejtorinë operative dhe kur kam marrë detyrën
24 operative nuk ka qenë.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë.

1 Faleminderit, z. Zyrapi. Do bëjmë dhjetë minuta pushim
2 tani.

3 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
5 Bëjmë dhjetë minuta pushim.

6 --- Seanca ndërpritet në orën 10.01

7 --- Seanca rifillon në orën 10.10

8 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Silleni
9 dëshmitarin në sallë.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Kam diçka për transkriptin.

11 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Një çast të
12 vendos dëgjueset, ju lutem.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Më thanë që një pjesë e përgjigjes
14 së dëshmitarit nuk është përkthyer në fund. Është pyetur për
15 drejtorinë e pushtetit civil dhe me sa kuptuam ne ai ka thënë
16 që:

17 "Mesa kam unë dijeni, në atë kohë nuk ka ekzistuar një
18 strukturë e tillë. Të paktën jo kur e mora unë në rolin tim si
19 drejtori i drejtorisë operative."

20 Pastaj ai ka thënë që:

21 "Por edhe kur e mora unë këtë detyrë, nuk ka ekzistuar
22 një strukturë e tillë."

23 Më thanë që kjo fjali nuk është përkthyer në anglisht.

24 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

25 [Dëshmitari vijon dëshminë]

1 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Më thanë edhe mua -- edhe më
2 kanë thënë që ka një gabim në transkript në faqen 26, 4, ku ka
3 thënë që ka qenë zëdhënës publikisht. Fjala "publikisht" nuk
4 është shfaqur në transkript.

5 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

6 [Dëshmitari vijon dëshminë]

7 Z. Zyrapi do të vazhdojmë me pyetjet e Gjykatësit
8 Mettraux.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Zyrapi, do shkojmë te
10 faqja tjetër e librit, që është faqja 91. U015-8834. Nëse
11 dëshironi mund ta lexoni vetë me vëmendje dhe mund t'ju jap
12 kohën që ju nevojitet. Por këtu, z. Krasniqi, përshkuan disa
13 ngjarje që kanë ndodhur në atë kohë: vendimi që të shpallej
14 publikisht zëdhënësi; vdekja e Bekim Berishës; edhe disa
15 ngjarje të tjera.

16 Tani shkojmë në faqen tjetër, që është faqja 92 dhe në
17 anglisht dhe në shqip. Është prova materiale P1277 për
18 procesverbal.

19 Në libër thuhet se struktura e Shtabit të Përgjithshëm të
20 UÇK-së në këtë kohë, pra në verën 1998, ka qenë kështu:
21 komandanti i UÇK-së, zëvendëskomandanti, inspektori i
22 përgjithshëm --

23 PËRKTHYESJA: Po z. Roberts thotë:

24 Z. ROBERTS: [Përkthim] "Inspektori i përgjithshëm".

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Më falni, se s'po e lexoja

1 me vëmendje.

2 "... atëhere, inspektori i përgjithshëm, pastaj vinin
3 drejtoritë: Drejtoria Politike, Drejtoria Operative, Drejtoria
4 e Shërbimit Informativ, Drejtoria e Policisë, Drejtoria e
5 Informimit Publik, Drejtoria për Ekonomi dhe Financa dhe
6 Drejtoria Logjistikës."

7 Dëshmitar, a pajtoheni me mua që, të paktën sipas këtij
8 libri, në atë kohë, flasim për verën 1998, ka ekzistuar
9 drejtoria e policisë? Keni ndonjë shpjegim për këtë?
10 PË. Unë nuk do foli simbas librit, se librin, e thashë edhe
11 më herët, e ekzagjerojnë. Kur po marrim me këqyr tash
12 strukturën kjo, strukturën tjetër që tregon z. Rexhep Selimi,
13 nuk korrespondon njëra me tjetrën. Tash dikush gabim prej tyre
14 a e kanë.

15 E dyta, drejtoria e policisë ushtarake po kishte ekzistu
16 të paktën do kisha koordinu me ta, do kisha dit kush është në
17 atë drejtori. Do të kisha punu me ta. Se si drejtor i
18 operacioneve është dashtë të punojë me të gjitha drejtoritë,
19 të koordinojë punët për me mujt me përgatit një operacion ose
20 me punu në aspektin e trajnimit ose funksionalizimit ose
21 operacionalizimit të ushtrisë. Unë këtë drejtori nuk e kam pa.
22 As e di kush kanë qenë, as që kanë ekzistu. Tash kush i ka
23 shkru ato le të urdhnojnë të tana ta spjegojnë edhe le të
24 trajtojnë. Të paktën mua q'ashtu në atë kohë nuk e kam ditur.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Më falni që ju ndërpres, por më

1 duhet ta kundërshtoj karakterizimin sepse do të donim të dinim
2 për çfarë periudhe kohore, sepse nuk janë shfaqur disa fjali
3 në ekran.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Misetic, nëse
5 dëshironi, ju mund t'i trajtoni vetë këto në pyetjet tuaja.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Unë po them që ju po flisni për
7 verën -- që ai po flet për verën 1998, dhe unë po kundërshtoj
8 atë që po thoni ju.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Keni radhën tuaj dhe do të
10 bëni pyetjet tuaja, ta vini në pikëpyetje këtë.

11 Dëshmitar, a keni ndonjë shpjegim ju pse në këtë periudhë
12 që thoni ju nuk ka pasur drejtori ushtarake, në të njëjtën
13 kohë lëshoheshin deklarata nga drejtorja e policisë -- në emër
14 të drejtorisë së policisë ushtarake të UÇK-së, përfshirë këtu
15 edhe tetorin 1998. A keni një shpjegim për këtë? Pra, kur s'ka
16 ekzistuar si dilnin deklarata në emër të kësaj drejtorie.

17 PË. Po nuk e di tash, ato që po thoni ju, deklaratat, i kanë
18 lëshuar [E pakuptueshme], deklaratat që janë lëshuar në tetor
19 1998, po është që kam pa ato gjatë këtyne seancës që më është
20 tregu. Më herët nuk e di që ka shqiptue ose ka dhënë një
21 deklaratë kjo drejtori e policisë, se po të kish dhonë në atë,
22 do të kisha kërkuar kush është edhe koordinoj me to. Tash ose
23 e kanë pas këto drejtoritë dhe e kanë majt [E pakuptueshme] pa
24 i ditur unë, ose s'i strukturë s'ma kanë treguar dhe s'i kam
25 pa farë, as drejtorinë e policisë, as inspektoratin. Foli për

1 ato ç'ka unë e di edhe unë çka kam mujt --

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Atëherë, unë e kuptoj
3 kështu dëshminë tuaj, që ju nuk keni dijeni që të jenë lëshuar
4 deklarata për shtyp në tetor 1998 nga dikush që pretendonte se
5 ishte pjesë e drejtorisë së policisë ushtarake të UÇK-së?
6 PË. Është e saktë se këto deklarata i kam pa kur janë
7 paraqitë gjatë proceseve gjyqësore. Kanë qenë lëshu në tetor,
8 nëntor a kur janë lëshu. Ma herët nuk ka pa unë ato. Po të
9 kishte pa, ato do i kisha pyt kush është. Po s'e di.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Kalojmë në
11 një temë tjetër që e keni diskutuar dhe me avokatët dhe me
12 kolegun tim, Gjykatësin Barthe. Ky është rasti i Blerim Kuqit.
13 Nga sa kuptova unë, ju thatë se nuk e dini kush vendosi ta
14 arrestonte z. Kuqi, kështu?

15 PË. Po, atë ditë.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Por ju na shpjeguat që të
17 paktën ju e kishit kuptuar që vendimi ishte marrë, dhe kur
18 është marrë ky vendim ka qenë i pranishëm z. Kuqi, Rexhep
19 Selimi, Jakup Krasniqi dhe Fatmir Limaj, kështu?

20 PË. Po, e kam spjegu edhe dje edhe çdo herë në pyetje kur më
21 është bërë. Kur kam dalë unë nga vendi aty ku kemi qenë, kanë
22 mbetur Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi, Fatmir Limaj. Kush e ka
23 dhënë urdhrin prej tyre, nuk e di.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Të shohim kush mund ta
25 ketë pasur kompetencën për të lëshuar vendimin për arrestimin

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bislam Zyrapi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses (Vazhdim)

Faqe 37

1 e z. Kuqit. Sipas jush, të fillojmë me z. Selimi, si inspektor
2 i përgjithshëm, a mund ta ketë pasur z. Selimi, kompetencën
3 për të arrestuar, për të marrë vendimin për arrestimin e
4 Blerim Kuqit, sipas jush?

5 PË. Jo.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po Fatmir Limaj, si
7 drejtori i policisë ushtarake?

8 PË. Jo.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po Jakup Krasniqi, si
10 zëvendëskomandant?

11 PË. Po, zëvendësi, po, së bashku me sektorin juridik.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të themi që në
13 momentin që është marrë ky urdhër, pra u mor vendimi të
14 arrestohej z. Kuqi, ekzekutimin e këtij urdhri duhej ta bënte
15 policia ushtarake? Korrekt?

16 PY. Po, mbasi ta jep sektori juridik vendim të tillë, ose
17 komandanti atëherë policia ushtarake bën zbatimin.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit se iu
19 përgjigjët edhe pyetjes së radhës. Tani do të flasim për diçka
20 tjetër që ka lidhje me rolet dhe pozitat që kishin dy
21 zëvendësit e Shtabit të Përgjithshëm.

22 Gjithashtu, ju them sërish më korrigjoni nëse diçka s'e
23 kam kuptuar mirë ose ka ndonjë keqkuptim. Nga sa kuptova unë,
24 ju thatë se ka pasur dy zëvendës, z. Bashota dhe z. Krasniqi.
25 Dhe se z. Krasniqi ka qenë përgjegjës. Ju përdorët një

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bislam Zyrapi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses (Vazhdim)

Faqe 38

1 shprehje "për mbështetje dhe çështje politike", ndërsa z.
2 Bashota ka qenë mbështet, më falni, zëvendës për operacionet,
3 kështu?

4 PË. Po.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në intervistën për ZPS-në
6 që ka numrin P1355 në Pjesën 7, ju keni shpjeguar, edhe një
7 herë, ju lutem më korrigjoni nëse nuk e kam kuptuar mirë, ju
8 keni thënë se këta të dy nuk janë emëruar njëherazi. Pra që z.
9 Krasniqi u emërua i pari si zëvendëskomandant dhe e z. Bashota
10 u emërua si zëvendëskomandant më pas. Saktë e kam kuptuar?

11 PË. Nejse, varet koha [E pakuptueshme] për të njëjtën,
12 domethënë, periudhë, janë emnuar. Z. Krasniqi veç ka qenë
13 zëdhënës i Shtabit të Përgjithshëm, kështu që veç është riemnu
14 në zëvendëskomandant për mbështetje dhe politikë, kurse z.
15 Bashota nuk ka qenë në atë pozitë, është riemnu -- domethënë
16 është emnu pastaj në pozitën e zëvendëskomandant për
17 operacione.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Këtu doja të
19 dilja dhe unë.

20 Po a mund të na konfirmoni këtë, që në momentin që u
21 emërua z. Bashota, si zëvendëskomandant për operacionet ai
22 ndërkohë ishte më përpara, kishte qenë më përpara anëtar i
23 Shtabit të Përgjithshëm. A është kjo e saktë?

24 PË. Po, ka qenë anëtar i Shtabit të Përgjithshëm. [E
25 pakuptueshme] me spjegu edhe ma herët që ka qenë i drejtorisë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bislam Zyrapi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses (Vazhdim)

Faqe 39

1 operative, se unë me atë kam punu në drejtori operative.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në intervistën për ZPS-në
3 Pjesa 7, faqja 5, flisni për Jakup Krasniqin dhe thoni:

4 "... komandanti i përgjithshëm emëroi si zëvendësin e
5 parë, dhe çdo gjë që duhej të vinte i duhej drejtuar Jakup
6 Krasniqit."

7 A ju kujtohet ta keni thënë këtu?

8 PË. Po.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, në terma hierarkikë,
10 nga pikëpamja ushtarake, Jakup Krasniqi ishte zëvendësi i
11 parë, dhe z. Bashota, ishte zëvendëskomandant i dytë, kështu?

12 PË. Po.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Gjithashtu keni thënë në
14 Pjesën 7 të intervistës tuaj për ZPS-në që, në fakt,
15 zëvendëskomandanti i dytë ishte vartës i zëvendëskomandantit
16 të parë dhe se duhet të ushtronte detyrat e
17 zëvendëskomandantit të parë kur ky nuk ishte i pranishëm.
18 Kështu?

19 PË. Po, me rregull ushtarake ashtu shkon.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Tani do t'ju
21 pyes për Azem Sylën. Kemi folur ndërkohë për të, por kam
22 nevojë për disa sqarime. Fillimisht a e dini që Azem Sylë ka
23 qenë një nga anëtarët më të gjatë të UÇK-së që nga fazat më të
24 mëhershme, qysh prej krijimit të UÇK-së. Kështu?

25 PË. Po.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A e dini ju se ka qenë
2 anëtar i Shtabit Qendror edhe para luftës? E keni ditur këtë?

3 PË. Më vonë e kam mësu, po.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Azem Syla ka qenë një
5 person i arsimuar. Më duket se ka qenë profesor kimie?

6 PË. Po, ashtu është.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju thatë që ka qenë një
8 nga figurat e LPK-së dhe person që kishte përvojë të mëparshme
9 ushtarake, saktë?

10 PË. Po, saktë.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani dua t'ju pyes për
12 diçka që keni thënë edhe dje kur i jeni përgjigjur disa
13 pyetjeve të Gjykatësit Barthe. Kam një gjë që unë të paktën
14 s'e kam të qartë. Do të dua të kuptoj sa përfshirje ka pasur
15 z. Syla në vendimet operative. Dhe po përpiqem të kuptoj për
16 vendimet që ka nxjerrë z. Syla - më fal - jam përpjekur të
17 gjej vendimet që ka nxjerrë z. Syla, por s'kam gjetur asnjë.

18 Pra, pyetja ime është kjo: Me sa keni ju dijeni, Azem
19 Syla, a ka lëshuar ndonjë vendim apo urdhëresë me shkrim të
20 natyrës operative?

21 PË. Jo, sa di unë.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe kjo shpjegon, dhe më
23 korrigjoni, pra, nëse e kam gabim, kjo shpejgon faktin pse
24 operacionit -- vendimet operative lëshoheshin nga anëtarë të
25 tjerë të shtabit që ishin në terren, ishin në Kosovë në atë,

1 kështu?

2 PË. Po, në mungesë të komandant është ai që zëvendësi i lejon
3 apo i aprovon.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani dua t'ju pyes për
5 diçka që i ka thënë Rexhep Selimi Prokurorisë lidhur me këtë.
6 dhe do ju pyes nëse pajtoheni apo jo me këtë që do të them.

7 Për procesverbal, është prova materiale P761.4 në faqen
8 5. Këtu flet z. Rexhep Selimi me Prokurorin.

9 E pyesin kështu:

10 "A ishte paraparë asokohe, nëse ju kujtohet, që të
11 shërbenin" --

12 Duhet t'ju kisha thënë një herë kontekstin. Këtu po
13 flitet për zëvendëskomandantët e Shtabit të Përgjithshëm. Edhe
14 u pyet:

15 "Nëse ju kujtohet a ishte paraparë asaj kohe që ata t'i
16 jepnin informatat e nevojshme Sylës që ishte jashtë Kosovës,
17 t'i përcillnin raporte, t'i komunikonin urdhrat e t'i më pas
18 në terren?"

19 Z. Selimi, siç është -- thuhet këtu, ka thënë:

20 "Mesa kam kuptuar unë ata kanë qenë zëvendës dhe kanë
21 zëvendësuar z. Syla pasi që nuk ishte në Kosovë, por mesa di
22 unë ata nuk i raportnin z. Syla."

23 A përputhet kjo edhe me mënyrën si e keni kuptuar ju
24 rolin që kish apo marrëdhënien që kishin këta zëvendës me
25 komandantin?

1 PË. Nuk mund ta them atë se s'e di sa kanë pas ata kontakte
2 dhe sa kanë mujt ta mbajnë këtë vijën. Shumë pak, nuk kam
3 njohuri në to.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Drejtë. Kalojmë në një
5 temë tjetër. Flasim për sektorin juridik. Dhe për këtë ju kanë
6 bërë disa pyetje. Por edhe unë kam nevojë për disa sqarime.

7 Z. Misetic më 4 korrik 2024 në faqen 17641 ju pyeti:

8 "Nëse dyshohet se një person ishte kolaboracionist, ju
9 donit që këtë person ta çonit tek sektori juridik?"

10 Ju jeni përgjigjur:

11 "Po, po. Tamam kështu."

12 A ju kujtohet kjo pyetje dhe përgjigje?

13 PË. Po.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Sqarimi i parë për të
15 cilin kam unë nevojë është ky: Nga sa kuptova unë dje ju thatë
16 se sektori juridik nuk merrej vetëm me anëtarë të UÇK-së që
17 kryenin ndonjë vepër penale apo shkelje disiplinore, por
18 merrej edhe me civilët. E kam kuptuar saktë?

19 PË. Po, me ata të cilët janë, për shembull, bashkëpunëtorë të
20 kundërshtarit ose të armikut.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mbi ç'baza thoni ju që
22 sektori apo drejtoria juridike e UÇK-së ishte kompetente për
23 t'u marrë dhe me rastet e civilëve? Pra, kishte rregullore,
24 keni ndonjë bazë ligjore ku mbështeteni për të thënë këtë që
25 sapo thatë?

1 PË. Për ato bazat juridike se, për shembull, në qoftë se e
2 marrim një -- një veprim, në qoftë se është e ditur që ka
3 bashkëpunëtorë, i cili ka zbuluar për shembull sektori
4 zbulimit apo është zbuluar nga shtabet lokale nga -- se
5 zakonisht prej tyre janë marrë edhe informacionet, atëhere
6 janë dërguar në sektorin juridik që ai me u marrë me këto
7 çështje në bashkëpunim me organet të cilat kanë informuar për
8 këtë ndodhi, ose për këtë veprim. Pastaj është marrë ajo që të
9 mirret të shifet a është ajo e vërtetë s'është, dhe a është
10 bashkëpunëtor a nuk është, të cilat këta e dinë metodat në
11 çështjet juridike të nxjerrin ose të vërtetojnë a është apo
12 nuk është bashkëpunëtor.

13 Për atë dhe është dhënë që të shkohet në sektorin juridik
14 që atë të shqyrtojnë ato. Se nuk ka kon e imja ta shqyrtoj, se
15 nuk di ta shqyrtoj [E pakuptueshme] juridike apo dikujt
16 tjetër.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nuk jam shumë i qartë.
18 Mbase pyetjet janë shumë juridike për ju. Po nëse shohim
19 rregulloret që kemi parë bashkë, këto janë rregullore që
20 rregullojnë në thelb jetën e brendshme të UÇK-së. Tani unë do
21 ju bëj një pyetje nëse e dini përgjigjen, mirë. Nëse nuk e
22 dini, nuk ka asnjë problem. Unë po ju pyes, mbi ç'baza, sipas
23 jush, funksiononte sektori juridik i UÇK-së për të trajtuar
24 rastet e civilëve? Cila ishte baza ligjore? Gjithmonë nëse e
25 keni përgjigjen për këtë.

1 PË. Simbas asaj që më ka thënë Sokol Dobruna që i ka përdor
2 ligjet ekzistuese të asaj kohe, të ish-Jugosllavisë.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju vetë, keni dijeni ku të
4 ketë pasur ndonjë rast ku sektori juridik të ketë trajtuar
5 kolaboracionistë, apo person të dyshuar si kolaboracionist,
6 por që nuk ishin anëtarë të UÇK-së? Dini ndonjë rast konkret?

7 PË. Jo, nuk e di.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dua t'ju tregoj një
9 dokument tjetër. Është prova materiale P157. Shqipja të
10 zmadhohet pak që ta shohë edhe dëshmitari. Të fokusohemi te
11 Komunikata 53.

12 E shihni Komunikatën 53?

13 PË. Po, e shoh.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Këtu thuhet, pra kjo është
15 Komunikata 53 e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Dhe kjo është
16 botuar në gazetën Zëri i Kosovës më 24 shtator 1998.

17 Nëse shkojmë më poshtë, që ta shohë edhe dëshmitari, këtu
18 do të shihni që komunikata e mban datën 18 shtator 1998. Është
19 në të djathtë. Prishtinë, 18 shtator 1998.

20 E shihni?

21 PË. Po.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A është kjo periudha
23 kohore kur ju keni qenë në Shqipëri?

24 PË. Saktë.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Keni ndonjë njohuri lidhur

1 me këtë komunikatë, apo është hera e parë që e shihni?

2 PË. Nuk kam njohuri me këtë komunikatë.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shohim fillimin tek
4 shqipja. Fillimin e komunikatës.

5 Z. Zyrapi, ju lutem, fokusohu te paragrafi i tretë i
6 kësaj komunikate. Thuhet, të paktën në anglisht:

7 "Masat ndëshkuese të formave të ndryshme po ndërmerren
8 edhe kundër elementeve kolaboracionistë, të cilët po vazhdojnë
9 t'i kryejnë shërbime pushtetit okupator."

10 E patë këtë?

11 PË. Po.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A e dini ju cilat ishin
13 këto masat ndëshkuese të cilat përmenden në këtë dokument?

14 PË. Jo, se komunikatën s'e di cila ka qenë në atë periudhë,
15 edhe këto masat çfarë janë marrë, nuk e di.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A pajtoheni që kjo nuk
17 është se ka pas të bëjë me sektorin juridik, apo jo?

18 PË. Po atëhere hala s'ka pas sektor juridik.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po, ekzaktësisht kështu.
20 Pra, a keni ndonjë ide se çfarë masash ndëshkuese -- për çfarë
21 masash ndëshkuese bëhej fjalë këtu ose domethënë me fjalë të
22 tjera, përpara sesa të krijohej sektori juridik, çfarë
23 ndëshkimi kanë marrë kolaboracionistët nga UÇK-ja? Sigurisht
24 në qoftë se keni informacion lidhur me këtë

25 PË. Jo, për këtë informacion nuk ka sesi.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A e dini se cilët janë
2 këto elementë kolaboracionistë për të cilët flet kjo
3 komunikatë dhe a e dini se çfarë ju ka ndodhur atyre?

4 PË. Jo, jo, nuk e di.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit që
6 të shikojmë provën materiale P228.

7 A ju kujtohet ta keni parë këtë dokument, z. Zyrapi?

8 PË. Po. Po.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pyetja e parë e imja
10 lidhur me këtë dokument është kjo: A keni qenë në dijeni që
11 kolaboracionistët e armikut janë trajtuar ndërmjet të tjerëve
12 nga policia ushtarake dhe nga njësitet speciale? A keni qenë
13 në dijeni të kësaj gjëje?

14 PË. Jo.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do i lutesha Sekretarit të
16 kalojmë tek faqja 3 e këtij dokumenti.

17 Z. Zyrapi, do ju kërkoja të përqendroheshit te germa f) e
18 raportit tuaj nën "Mbrojtja dhe siguria". E shikoni?

19 PË. Po.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në këtë paragraf, të
21 paktën në anglisht, është fjalia e fundit e paragrafit në
22 anglisht në raportin e hartuar prej jush, ku thuhet që:

23 "Njësitë i posaçëm dhe policia ushtarake përballojnë me
24 sukses luftën speciale të armikut dhe dorën e zgjatur të tij."

25 A e shikoni këtë, Dëshmitar?

1 PË. Po.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, në fakt, ju e dinit
3 që njësitë speciale dhe policia ushtarake po merreshin me
4 kolaboracionistët, apo jo?

5 PË. Kjo është raporti përmbledhës të cilin e kam bo në atë
6 kohë dhe është simbas raporteve të komandantëve të zonave,
7 edhe këto zakonisht në këtë periudhë kur është bërë, ka qenë
8 dukuria shumë e madhe të cilat janë veshur policët lokalë
9 nëpër disa fshatra, sidomos në Rrafshin e Dukagjinit, po dhe
10 vende të tjera. Për atë dhe kjo është shkruar simbas raportit të
11 atyre që e kanë raportu edhe komandantit dhe është shënu
12 këtu.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, vetëm thjesht
14 dua që të nxjerr në pah një problem përkthimi. Fjala
15 "kolaboracionistë" ose "bashkëpunëtorë" nuk është tek teksti.
16 Ndërkohë që Gjykatësi e përdori këtë fjalë dhe nuk -- do të
17 doja t'ju thoja, domethënë, që nuk është se është e thënë
18 shprehimisht në këtë tekst.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të na thoni,
20 Dëshmitar, se për çfarë e keni pasur fjalën konkretisht kur
21 keni shkruar që njësitë speciale dhe policia ushtarake po
22 përballojnë me sukses këtë çështje. Domethënë, çfarë doni të
23 sillni në vëmendje, për çfarë e kishit fjalën kur keni bërë
24 këtë formulim? A mund të na e thoni?

25 PË. Për këtë formulim, siç e ceka edhe më herët, është bërë

1 prej raporteve të komandantëve të zonave të cilët në këtë kohë
2 dukuria ma e madhe që ka qenë që fillimi i veshjeve të disa
3 njerëzve, kuadro të policisë lokale të armikut, edhe
4 normalisht që këto njësitë vëzhguese kanë pas të vëzhgojnë
5 lëvizjet e tyre dhe të hulumtojnë se kush janë krejt të
6 gjithë. Dhe në qoftë se është marrë ndonjë masë atëherë polici
7 ushtarake ka mujt t'i merr ato masa. Po ato varet edhe prej
8 komandantit të zonës dhe zonave që kanë vepruar.

9 Konkretisht nuk e di në atë kohë që është ndërmarrë një
10 veprim i tillë, por nga kjo ky kontekst është shkruar kjo edhe
11 është përmbledhës i raportit është dërguar
12 zëvendëskomandantit.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Sipas shpjegimit tuaj
14 kështu duhet që ta kuptojmë neve përmendjen e njësisë speciale
15 këtu në tekst?

16 PË. Po njësitë speciale kanë -- shkruhet për njësitë
17 vëzhguese janë, të cilat kanë qenë edhe të Shtabit të
18 Përgjithshëm edhe njësite nëpër zonat. Ato dhe kanë pas
19 detyrën e vëzhgimit, prandaj quhen njësi të veçanta ose njësi
20 speciale.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E kisha fjalën për "luftën
22 speciale", në fakt, sepse në anglisht, të paktën, referenca
23 është "lufta speciale e armikut". Domethënë çfarë mund të na
24 thoni për luftën speciale?

25 PË. Po lufta speciale, kjo përveç asaj që thashë që janë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bislam Zyrapi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses (Vazhdim)

Faqe 49

1 veshur këta të rinjtë në polici -- me rrobat e policisë serbe
2 si -- kanë vepru edhe te popullata duke propagandu të
3 kundërtën, faktikisht, negativën për Ushtrinë Çlirimtare të
4 Kosovës. Që dhe ne kemi pas shumë pastaj dhe probleme që mund
5 të kalojmë në ato fshatra ose të afrohemi te ato fshatrat ose
6 të afrohemi te popullata. Dhe kjo ka qenë një ndër edhe [E
7 pakuptueshme] lufta që ata kanë zhvillue në atë kohë. Që është
8 dashtun gjithnjë të ruhemi dhe të marrim masa adekuate.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit
10 tani të paraqesë në ekran provën materiale P884. Duket se
11 është i njëjti dokument si prova 1D29.

12 Përsëri është një dokument të cilin e njihni mirë, z.
13 Zyrapi. Na keni thënë më herët që ju e keni shkruar këtë
14 dokument, pra jeni autori i këtij dokumenti, kështu që kam
15 disa pyetje të tjera plotësuese lidhur me të.

16 E keni shpjeguar, dhe përsëri domethënë, nuk e kam
17 kuptuar siç duhet mund të më korrigjoni. Por, na keni
18 shpjeguar që keni marrë informacione të ndryshme përmes
19 komunikata të UÇK-së, të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së,
20 përmes artikujve të gazeve, dhe gjithashtu përmes vizitave në
21 terren, që kishte fjalë që qarkullonin apo kishte opinione
22 lidhur me krimet e kryera nga anëtarë të UÇK-së, kështu që në
23 përgjigje të këtyre informacioneve të mbledhura apo këtyre
24 fjalëve që qarkullonin, ju keni nxjerrë këtë urdhër. A është e
25 saktë kjo?

1 PË. Po, saktë.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kam disa pyetje që kanë të
3 bëjnë me këtë dokument. Së pari, kush e kishte si përgjegjësi
4 që të siguronte që kjo urdhëresë e juaja respektohej?

5 PË. Komandantët e zonave.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kush e kishte
7 përgjegjësinë për të siguruar që komandantët e zonave e
8 respektonin urdhëresën e lëshuar prej jush?

9 PË. Normalisht përgjegjësi është edhe e shtabit që të
10 kontrollon zbatimin e tyre aq sa në atë kohë është mujt edhe
11 kanë dëgju ose kanë marrë këtë urdhëresë me e zbatu.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kur thoni "shtabi" e keni
13 fjalën për Shtabin e Përgjithshëm, apo jo?

14 PË. Po.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në intervistën e ZPS-së,
16 po edhe gjithashtu përpara Trupit Gjykses, ju keni përmendur
17 një rast kur të është thënë ty më herët kur jeni futur në
18 Kosovë, nga Rexhep Selimi, që ishin shpërndarë broshura që ju
19 i kishit kuptuar që ishin broshura të Kryqit të Kuq
20 Ndërkombëtar në nënzona, në atë kohë. E kam kuptuar drejt
21 këtë, Dëshmitar?

22 PË. Po.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kam të njëjtën pyetje si
24 më herët. Kush e kishte si përgjegjësi për të siguruar që këto
25 broshura ose përmbajtja që është shkruar në këto broshura

1 respektohej?

2 PË. Përmbajtjen e këtyre broshura e ka pas të respekton,
3 domethënë, zonat operative, komandantët e zonave, komandant e
4 njësisive lokale të asaj kohës, çdo pjesëtar i UÇK-së që ka qenë
5 në kuadër këtyne shtabeve.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Më pas Shtabi i
7 Përgjithshëm duhej që të siguronte, domethënë, që realisht
8 ndodhte ashtu që zbatohet përmbajtja e tyre, kështu?

9 PË. Shtabi i Përgjithshëm ka mujt të shof a kanë mbërri ato
10 broshurat deri te më poshtë, njësitë më poshtë, domethënë,
11 është detyra e shtabit, a ka mbërri deri aty. Në qoftë se ka
12 mbërri deri atyre domethënë e ka arritur detyrën e vet.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Por që edhe respektohen
14 ose zbatohen, apo jo?

15 PË. Po ata sa kanë mujt të zbatohen, respektohen në atë kohë
16 është pak diskutabile, po ne me tentativë të asaj kemi shku që
17 të zbatohen ose të respektohen.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] I keni thënë diçka tjetër
19 z. Misetic, në veçanti kjo referohet në faqen 17542. E keni
20 thënë me datën 3 korrik. Iu bë një pyetje lidhur me urdhrat që
21 nuk kishin vulë dhe firmë. Mënyra se si e kam kuptuar unë
22 dëshminë tuaj është që, sipas pikëpamjes tuaj një urdhër që
23 nuk ka nënshkrim dhe/ose një vulë, pra sipas mendimit tuaj,
24 një urdhër i tillë që nuk ka ose vulë ose vulë edhe nënshkrim
25 nuk është i zbatueshëm, apo jo? Nuk ka fuqi, apo jo?

1 PË. Po, në qoftë se nuk është i nënshkruar ai dokument, nuk
2 është i vulosur, nuk është i protokolum, domethënë, ai
3 dokument nuk është në fuqi, nuk mundet me qenë në fuqi.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Pyetja ime e
5 parë lidhur me këtë është kjo: Unë kam parë rregulloret e UÇK-
6 së që i kemi ne në dispozicion për të gjetur një parim të
7 tillë dhe nuk e gjeta të shkruar gjëkund. Kështu që do të
8 doja t'ju pyesja se ku mund të kërkoj unë për të gjetur këtë
9 informacion ose këtë parim? Apo është diçka që ju e keni
10 marrë, e keni miratuar nga një burim tjetër?

11 PË. Në qoftë se marrim, kjo është parim administrativ. Nuk
12 është parim t' tjera ushtarake. Nuk shkruhet në rregulloren
13 ushtarake të veprimit atje. Po të aspektit administrativ, po.
14 Se një dokument të cilin nuk është i nënshkruar dhe sot, në
15 qoftë se s' është i nënshkruar, s' është i vulosur, s' është i
16 protokolluar, ai s' është dokument. Mund të jetë tentativë që
17 është shkruar apo menduar në atë drejtim, por nuk ka hi në
18 zbatim. Nga aspekti jem kështu e kuptoj.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Sepse pashë, për shembull,
20 rregulloren e brendshme të UÇK-së, që është për procesverbal
21 prova 8, në faqen 20, rregulla 4. Dhe thuhet që kur kërkohet
22 një nënshkrim ose një vulë në rregullore, parashikohet një gjë
23 e tillë konkretisht. Për shembull, në rastin e lejeve për të
24 udhëtuar, në rastin e këtyre lejeve, ishte e nevojshme që të
25 jepet edhe vula edhe nënshkrimi. A është e saktë kjo,

1 Dëshmitar?

2 PË. Po. E saktë.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nëse e kuptoj drejt
4 dëshminë tuaj, ajo çfarë juve e quani "parim administrativ"
5 atë nuk e gjejmë të paraqitur në rregulloret e UÇK-së. Këtë po
6 thoni?

7 PË. Nuk -- jo veç këto, po ka edhe shumë rregullore të tjera
8 që nuk kemi mujt t'i shkrujmë ose t'i kemi. Ne kemi ato
9 rregullore [E pakuptueshme] rregullore pjesë bazë të zbatimit
10 ose veprimit tonë në atë kohë. Është e pamundur t'i kemi pas
11 të gjitha rregullore. Është dashtë të kemi edhe shumë
12 rregullore të tjera dhe udhëzime, po nuk kemi mujt t'i
13 arrisim.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E kuptoj. Tani dua të
15 kalojmë në një temë tjetër. Do i kërkoja Sekretarit të
16 paraqesë në ekran provën materiale P1009.

17 Përsëri ky është një dokument të cilin e keni parë dhe më
18 herë, z. Zyrapi, kështu që nuk ka ndonjë befasi lidhur me këtë
19 dokument.

20 Të kalojmë në faqen U002-2861. Faleminderit. Të kalojmë
21 më poshtë në faqe në të dyja versionet.

22 Z. Zyrapi, a ju kujtohet që ky dokument iu është treguar
23 edhe më herët, me datën 9 korrik, më konkretisht?

24 PË. Po. Po.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, dhe ju

1 kërkoj ndjesë që ju ndërpreva. Për transkript jepet në faqen
2 17485.

3 Juve ju bëhet një pyetje konkretisht për germën c.,
4 "Komisioni për Caktimin e Vijave të Kufirit të Zonave
5 Operative". Z. Emmerson, avokati i z. Veseli ju bëri një
6 propozim të gjatë sa i takon këtij paragrafi dhe në veçanti
7 përmendjen e Kadriut. Referencën e Kadriut. Dhe përgjigja që
8 ju dhatë është si më poshtë:

9 "Së dyti, është e vërtetë ajo çfarë shkruhet këtu që
10 Komisioni për Caktimin e Kufijve të Zonave Operative që do të
11 caktohen nga zëvendësi i Kadriut, nuk kishte zëvendës. Luli
12 ishte aty, që pseudonimi i z. Veseli, ndërkohë që sa i takon
13 numrit që është këtu, nuk e di se kush është ky numri dhe nuk
14 e di se kush e ka diskutuar këtë numër. Megjithatë, sa i takon
15 takimit, takimin e mbaj mend shumë mirë."

16 Dua të jem i qartë lidhur me atë çfarë keni thënë në
17 përgjigje të pyetjes që ju është bërë. A po thoni këtu që nuk
18 përmendet fare se kush ka qenë zëvendësi i Kadriut në këtë
19 dokument, apo po thoni që Kadri Veseli nuk ka pasur fare
20 zëvendës në atë kohë, apo po thoni që ju nuk e dini kush ka
21 qenë zëvendësi i tij në atë kohë? A mund të na e shpjegoni pak
22 cila ka qenë situata? A mund të na e shtjelloni më tej?
23 PË. Sa më kujtohet mua, në atë kohë ai nuk ka pas fare
24 zëvendës, se kjo është hala në kohën në fillim, domethënë,
25 gjatë ristrukturimit nuk ka pas. Për atë, dhe dikush kush e ka

1 pas numrin e tij ka kërku që të bisedon si ta zgjidhin këtë
2 çështje. Po nuk ka pas. Unë ç'ka e di në atë kohë, nuk ka pas.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të paraqesim në
4 ekran prova materiale P623.

5 Sikurse mund ta shikoni edhe vetë, Dëshmitar, është një
6 dokument që mban datën 30 dhjetor 1998. Që quhet "Urdhëresë"
7 në shqip. Ka edhe një numër.

8 Kështu që në qoftë se mund të kalojmë më poshtë në fund
9 të kësaj faqeje.

10 Do shikoni që është një dokument i cili është i vulosur
11 dhe është i nënshkruar dhe jepet gjithashtu dhe i atribuohet
12 zëvendëskomandantit të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së,
13 Jakup Krasniqi. A e shikoni këtë, Dëshmitar?

14 PË. Po.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mund të kalojmë më sipër
16 në faqe.

17 A pajtoheni që në fakt ky është zbatimi i vendimit që
18 është marrë në takim, procesverbalin e të cilit ne e pamë
19 përpara një çasti? A pajtoheni me mua lidhur me këtë?

20 PË. Po.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do ju kërkoja që të
22 përqendrohni tek pika 1 e urdhëresës. Në këtë pikë
23 regjistrohet fakti që Jakup Krasniqi është caktuar në
24 Komisionin për Përcaktimin e Kufijve të Zonave Operative në
25 tërë Kosovën. Domethënë Jakup Krasniqi ka caktuar për

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bislam Zyrapi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses (Vazhdim)

Faqe 56

1 Komisionin për Përcaktimin e Kufijve të Zonave Operative në
2 tërë Kosovës dhe dua që të shikoni pikën 6, "Dy anëtarë të
3 shtabit luftarak nga drejtoria operative e Shtabit të
4 Përgjithshëm të UÇK-së". A e shikoni këtë pikë?

5 PË. Po.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kjo ka qenë drejtoria
7 juaj, apo jo?

8 PË. Po. Drejtoria operative.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nëse ju kujtohet, a mund
10 të konfirmoni se, dy zotërinj që janë përzgjedhur nga
11 drejtoria operative e Shtabit të Përgjithshëm për këtë detyrë
12 konkrete kanë qenë Naim Maloku dhe Musë Jashari? A është e
13 saktë kjo?

14 PË. Po. Faktikisht tre kanë qenë të angazhuar -- në komision
15 kemi pas Sali Veselin, për këtë drejtim, Naim Malokun dhe Musë
16 Jasharin.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, për ta kuptuar ne më
18 qartë se si ka funksionuar kjo. A do të ishte e saktë të
19 thuhej, zotëri, që Jakup Krasniqi e ka marrë këtë urdhër,
20 domethënë nën paragrafin 1(6), që të emëron të dy anëtarë të
21 Shtabit të Përgjithshëm nga drejtoria operative dhe pastaj
22 ishte vendimi juaj që Naim Malokun dhe Musë Jasharin ta
23 caktonit nga drejtoria operative apo e ka marrë dikush tjetër
24 këtë vendim?

25 PË. Po e spjegojmë pak më mirë. Në takimin që është mbajtur

1 në Shtabin e Përgjithshëm është marrë vendimi që të formohen
2 këto komisione. Pastaj aty është dhënë që nga këto drejtori,
3 në këto drejtime, të përcaktohen individë që do të punojnë në
4 këto komisione.

5 Dhe kur thuhet tash për formimin e komisionit për
6 caktimin e kufijve, çdo drejtor që e ka drejtorinë që e
7 udhëheq, përcakton një epror apo një zyrtar të asaj drejtorie
8 që të merr pjesë në këtë komision për përcaktimin e kufijve.
9 Dhe këto emrat janë dhënë nga ne, për shembull, nga drejtoria
10 operative i kam dhënë unë. Nga drejtoria tjetër i ka dhënë
11 tjetri, e kështu rend. Dhe pastaj të tana Jakup Krasniqi ka bo
12 vendimin që ky është komisioni që do të punojë për kufijtë.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, në qoftë se e kuptoj
14 drejtë, në pikëpamjen ushtarake kjo urdhërese ju urdhëron ju,
15 si shef i drejtorisë operative, që të caktoni këto dy emra,
16 dhe pastaj miratimin përfundimtar e bën z. Krasniqi, kështu?
17 PË. Po, ai urdhëron që t'i bëjmë këto komisione dhe t'i jap
18 emrat e këtyne individëve që do të punojnë. Kjo është.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tek pika 5, flitet për
20 zëvendësshefin e drejtorisë informative.

21 Me sa e keni kuptuar ju, zëvendëskomandanti i Shtabit të
22 Përgjithshëm të UÇK-së z. Jakup Krasniqi, a e ka ditur në atë
23 kohë në qoftë se ka pasur një zëvendësshef të drejtorisë
24 informative?

25 PË. Në qoftë se ka pas. Po unë ç'ka nuk ka pas në atë kohë se

1 ky komision kur ka përfundu punën ka pru raportin, cilët
2 anëtarë kanë qenë, kanë marrë pjesë në këtë komision, e kanë
3 kry këtë detyrë, kështu që ky zëvendës nuk ka qenë. As emri i
4 tyre nuk ka qenë i këtij sektorit fare.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ju kujtohet se kush
6 është emëruar në këtë komision në emër të drejtorisë
7 informative? Kush është caktuar nga drejtoria informative për
8 këtë komision?

9 PË. Jo, nuk ka pas fare. Përcaktuese s'ka qenë, faktikisht,
10 drejtori i drejtorisë informative, z. Veseli, brenda në
11 Kosovë, ka qenë jashtë dhe nuk kemi pasur askënd ta
12 përcaktojmë në këtë detyrë.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A e njihni Ferat Shalën?

14 PË. Po.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të na tregoi se
16 çfarë roli ka pasur ky individ në UÇK? Në veçanti nga fundi i
17 1998-s dhe në fillim të 1999-s.

18 PË. E di që deri në 1998 deri nga fundi i 1998-s ka qenë
19 komandanti i njësisë Pëllumbi, faktikisht, njësisë në fshatin
20 Negrovç, rrugës së -- të afër, domethënë, Llapushnikut. Ka
21 qenë në këtë detyrë dhe pastaj është transferu nalt, në cilën
22 detyrë, nuk e di më tej.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, nuk e dini se në
24 çfarë posti është caktuar ai pasi njësiti Pëllumbi u bë
25 brigadë e UÇK-së? Nuk e dini çfarë posti ka marrë ai më pas?

1 PË. Jo, nuk e di atë.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Megjithatë ju keni
3 ndërvepruar me të, keni folur me të nga fillimi i 1998-s, apo
4 jo?

5 PË. Me to kemi folur jo në 19 -- mujt, me thënë nga shkurti
6 kur kemi bërë trajnimet e kemi fillue, q'atëhere kemi -- një
7 herë e kam takue. Faktikisht, po edhe në një [E pakuptueshme]
8 e kam taku, një herë kur kemi shku bashkë me z. Jakup Krasniqi
9 në Shalë, në zonën operative të Shalës, ka qenë edhe ai me ne.
10 Është e saktë. Po nuk e kam pyetur asnjëherë cilën pozitë e
11 ka.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Jeni takuar me të sepse
13 keni qenë në Shalë së bashku me Jakup Krasniqin dhe Ramë
14 Bujën, kështu?

15 PË. Po, saktë.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju keni qenë aty për të
17 trajtuar çështjen e trajtimit dhe lirimit të tetë ushtarëve të
18 armatës jugosllave, të katërt ju, apo jo?

19 PË. Po, saktë.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, ju keni qenë aty si
21 shefi i shtabit i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, kështu?

22 PË. Po, në atë pozitë.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Krasniqi ka qenë aty në
24 pozitën e vet si zëvendëskomandant, kështu?

25 PË. Po.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe Ramë Buja ka qenë aty
2 si shefi i G5-s, kështu?

3 PË. Po, marrëdhëniet civile-ushtarake.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po Ferat Shala në çfarë
5 posti, në çfarë cilësie ka qenë aty?

6 PË. Ai ka qenë aty po nuk e di në cilën cilësi, se ai ka qenë
7 bashkë me zëvendësin.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A jeni në dijeni të
9 përfshirjes së tij me shërbimin informativ, pra, për sa i
10 takon krijimit, përmirësimit në sistemin informativ të UÇK-së?
11 A jeni në dijeni të ndonjë prej roleve të kësaj natyre për
12 këtë person?

13 PË. Jo, në atë kohë nuk kam pas atë detyrë -- atë
14 informacion, por më vonë kur u formua shërbimi informativ i
15 Kosovës mbasi është formu Qeveria e Përkohshëm nga Rambuje, e
16 di që ka dalë në atë sektor, po këtu çka ka punu në sektorin e
17 shërbimit informativ, nuk di. Çfarë detyre ka pas, a ka pas
18 detyrë aty apo jo. Se të paktën nga ai s'kam marrë asnjëherë
19 informacione të cilat mu kanë dashtë për çështjet ushtarake.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Këto pyetje
21 kisha.

22 Të lutem përmende, thuaje edhe një herë fjalinë e fundit
23 se nuk e kapi përkthyesi.

24 PY. Po, thashë: Nga ai nuk kam marrë informacionet ushtarake.
25 Nga ai. Si informacion raport për me ditë se cilën detyrë

1 është.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, z. Zyrapit.

3 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Zyrapit, do
4 bëjmë pushimin e zakonshëm për gjysmë ore. Mund të dilni me
5 shoqërinë e Asistentes.

6 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

7 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

8 --- Pauza fillon në orën 11.06

9 --- Seanca rifillon në orën 11.35

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, z. Ellis.
11 Vetëm një çast ju lutem.

12 Po.

13 Z. ELLIS: [Përkthim] Mbasi po flas paraprakisht se
14 Gjykatësi Gaynor po ashtu ka pyetje. Por desha t'ju kërkoja
15 pak kohë që të përgatitemi edhe ne për pyetjet e radhës për
16 këtë dëshmitar.

17 Se shumë nga aspektet që janë trajtuar sot paradite
18 lidhen drejtpërsëdrejti me z. Krasniqi dhe duam pak kohë të
19 përgatitemi. Kështu që do të donim që t'i fillonim nesër
20 pyetjet tona.

21 Në fakt, unë po flas nga vetja ime se nuk e di çfarë kanë
22 kërkuar kolegët.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po kjo varet
24 edhe nga parashikimi i secilit, se nesër duhet të përfundojmë
25 me këtë dëshmitar, sido që të jetë.

1 Z. ELLIS: [Përkthim] Po, ne duhet ta bëjmë këtë, por...

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk po them
3 shpresojmë, po themi është e padiskutueshme që do përfundojmë
4 nesër.

5 Z. ELLIS: [Përkthim] E di këtë dhe ne jemi ekipi i fundit
6 që do të bëjmë pyetjet. Jemi në dijeni të kësaj.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të mbarojmë
8 me këto pyetjet e Gjykatësit Gaynor dhe të bëjmë një
9 rivlerësim të kohës që do të na nevojitet gjithsecilit për
10 këtë dëshmitar. Mbase edhe ju do ta keni më të qartë se sa
11 kohë do ju nevojitet për dëshmitarin.

12 Tani mund ta sillni dëshmitarin në sallë.

13 [Dëshmitari vijon dëshminë]

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Zyrapi,
15 tani pyetjet i ka Gjykatësi Gaynor që është majtas. Dëgjojeni
16 me vëmendje.

17 Gjykatësi Gaynor, fjala është për ju.

18 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit.

19 Mirëdita, z. Zyrapi.

20 PË. Mirëdita.

21 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Ju keni dhënë dëshmi se me
22 kërkesë të Azem Sylës, ti dhe Kadri Veseli keni përfaqësuar
23 UÇK-në në bisedimet me qeverinë Bukoshi, pra, qeveria që ishte
24 në mërgim, që këto bisedime janë mbajtur në Stamboll, në
25 Tiranë e gjetkë, kështu?

1 PË. Po.

2 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Përveç Tiranës dhe
3 Stambollit, ku tjetër u bënë këto bisedime?

4 PË. Unë e di veç në Tiranë edhe në Stamboll që janë mbajt, që
5 kam marrë pjesë; në të tjera nuk di.

6 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Sa kohë qëndruat në Stamboll
7 ju dhe z. Veseli?

8 PË. Po atëherë kur kemi shkuar në Stamboll kemi qëndruar më
9 duket dy ditë apo tri, nuk e di saktë por q'ajo periudhë ka
10 qenë.

11 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Sa kohë zgjatën negociatat
12 me qeverinë Bukoshi?

13 PË. Po në Stamboll kanë zgjat një ditë, [E pakuptueshme] që
14 kemi bë bisedimet se dy ditë kanë qenë, ja, dita e shkuarjes
15 edhe dita e kthimit. Pastaj dhe kemi vazhduar edhe disa ditë
16 të tjera në Tiranë, ku kemi diskutuar në Tiranë me anëtarët e
17 Ministrisë së Mbrojtjes së Qeverisë së Përkohshme -- Qeverisë
18 në Ekzil. Kështu që ka zgjat diku deri, mund të them, deri nga
19 3, 4 nëntori '98-s.

20 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Shohim projekt-marrëveshjen,
21 nëse është e mundur.

22 I lutem Sekretarit të seancës të nxjerrë në ekran
23 materialin me numër 1D00166 dhe të shohim faqen 2 dhe në
24 anglisht e në shqip.

25 Them "projekt-marrëveshja", në fakt, kjo është

1 marrëveshja që keni nënshkruar ju, ndonëse më pas nuk hyri në
2 fuqi.

3 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ju lutem ta sqaroni këtë që thatë
4 "nuk ka hyrë në fuqi", se nuk ka prova për këtë.

5 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në fakt është një nga
6 pyetjet e mia; do flas për këtë.

7 "Këtu janë mbajtur disa takime të përbashkëta", thotë
8 këtu, "të eprorëve të autorizuar dhe më 31 tetor 1998 ...",
9 thuhet, "... u mor vendimi për të miratuar strukturën e re të
10 Shtabit të përgjithshëm".

11 Nga sa duket nga ky dokument marrëveshja është arritur
12 deri më -- pra, është arritur më 31 tetor 1998, kështu?

13 PË. Po, marrëveshjen.

14 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Marrëveshja juaj për
15 riformatimin ose për ristrukturimin e Shtabit të Përgjithshëm
16 ishte një çështje me rëndësi të madhe për UÇK-në në
17 përgjithësi, por veçanërisht për anëtarët ekzistues të Shtabit
18 të Përgjithshëm, a është kështu?

19 PË. Po, saktë.

20 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Atëherë, si i informuat ju
21 anëtarët e tjerë të Shtabit të Përgjithshëm gjatë kohës që po
22 vazhdonin negociatat, si i informonit ata?

23 PË. Ne informojmë komandantin e përgjithshëm, ishte, Azem
24 Sylën në Tiranë. Ne informoshim atë dhe pastaj kur i ka
25 informuar, si i kanë informuar nuk e di.

1 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Kur e kontaktonit në Tiranë
2 dhe në Stamboll, në çfarë forme komunikimi, pra, çfarë forme -
3 - mjeti komunikimi keni përdorur për të komunikuar me të?
4 PË. Po në Stamboll kemi komunikuar me telefon; kurse në
5 Tiranë drejtpërdrejt se ka qenë aty në Tiranë; jemi taku me
6 të; kemi diskutu normalisht veç ka qenë jo veçëm Azem Syla,
7 por ka qenë edhe Xhavit Haliti; kanë qenë edhe anëtarë të
8 tjerë që ishin aty; diskutojshin për të gjitha këto
9 marrëveshje që ishin duke u bërë.

10 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Jeni konsultuar me ndokënd
11 që ishte brenda në Kosovë?

12 PË. Unë, jo.

13 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po z. Veseli dini gjë, është
14 konsultuar?

15 PË. Nuk e di. E di që ne kemi pas komandantin e përgjithshëm
16 aty, me të kemi bisedu. Pastaj a ka informu ai, a e ka diskutu
17 me këta të brendshëm, nuk e di.

18 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në terma të përgjithshme,
19 qoftë kur keni qenë në Stamboll apo në vende të tjera, a keni
20 pasur vështirësi ta kontaktonit Azem Sylën në Tiranë?

21 PË. Po në qoftë se prej Stambollit po, menjëherë s'mundshim
22 ta merrshim, por në Tirana jo; në Tiranë se ka qenë afër aty.

23 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po. Situata e telefonatave
24 ndërkombëtare në '98-n ishte, për shembull, që Tiranën mund ta
25 merrje kollaj, lehtësisht në telefon nga çdo pjesë e botës.

1 Domethënë, kishte rrjet të mirë komunikimi, mund të lidheshe
2 me Tiranën, kështu?

3 PË. Po, kemi pas komunikime.

4 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Dua të flas për diçka që e
5 ka thënë avokati i z. Veseli. Fillimisht, kjo marrëveshje hyri
6 ndonjëherë në fuqi, apo nuk hyri në fuqi?

7 PË. Po, kjo marrëveshje ka hyrë në fuqi.

8 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pra, të shohim listën e
9 përfaqësuesve të Shtabit të Përgjithshëm që është tek faqja e
10 katërt edhe në anglisht dhe në shqip.

11 Në këtë faqe shohim listën e strukturës së Shtabit të
12 Përgjithshëm për të cilën jeni pajtuar me qeverinë Bukoshi.
13 Dhe shohim dhe vulën e Republikës së Kosovës, Ministria e
14 Mbrojtjes Prishtinë dhe vulën e Ushtrisë Çlirimtare të
15 Kosovës, që do të thotë qeveria e Bukoshit ishte vula e parë,
16 kështu?

17 PË. E para, e UÇK-së është e Shtabit të Përgjithshëm, dhe e
18 dyta, është e Bukoshit, qeverisë Bukoshi, Ministrisë së
19 Mbrojtjes.

20 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Kjo përbërje e Shtabit të
21 Përgjithshëm ose kjo strukturë a u materializua ndonjëherë?

22 PË. Jo e gjitha menjëherë. Për shembull, Agim Çeku nuk ka
23 ardhë në atë kohë kur jemi marrë vesh, por ka ardhë më vonë,
24 ka ardhë në prill të '99-s. Sokol Bashota veç ka qenë; kurse
25 zëvendësin tjetër që është paraparë Ismet Aliaj jo, për shkak

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bislam Zyrapi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses (Vazhdim)

Faqe 67

1 se ai ka qenë udhëheqësi reaktiv në armatën boshnjake dhe ka
2 qenë atasheu ushtarak në atë kohë në Turqi. Unë, po; Rexhep
3 Selimi, po; Hashim Thaçi nuk është bërë i personelit në atë
4 kohë; Kadri Veseli, po; ka mbetur ky i J3 që është dashtë të
5 jetë në operacione, Ramizi, i njëjti ka qenë oficeri i armatës
6 boshnjake aktive, nuk ka mund të vjen; të katërt Xhafer
7 Jashari është bërë më vonë, mbasi kemi filluar, domethënë,
8 atje të fillon marsit, prillit '99-s është transferua në
9 Ministrinë e Mbrojtjes te ne; Mark Shala, po; Xhafer Kabashi,
10 jo, nuk ka qenë, nuk ka ardhë për shkak se ka qenë aktiv në
11 armatën boshnjake; Adem Grabovci, po; ndërlidhjes është konë
12 veç Musë Jashari; Enver Basholli dhe Shaban Dragaj veç e kemi
13 diskutu edhe më herët që ai ka ardhë më herët, por që është
14 kyçën, ka qenë Brigada 121. Kurse Enver Basholli është vonë,
15 domethënë, në kohën mars, prill dikur është kyçën në ministri.

16 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po, marrëveshja me qeverinë
17 Bukoshi, të paktën me sa dini ju, a hyri ndonjëherë në fuqi
18 kjo marrëveshje?

19 PË. Po, në qoftë se e keni përcjellë e kam shpjeguar që grupi
20 i parë [E pakuptueshme] i oficerëve dhe ushtarëve ka hyrë në
21 nëntor në zonën e Pashtrikut, ku janë shpërndarë edhe eprorët
22 dhe kanë filluar riorganizimin e Ushtrisë Çlirimtare të
23 Kosovës në këtë zonë. Pastaj grupet e tjera kanë filluar rend
24 të vijnë nga jashtë që janë sistemuar pastaj nga shtabi janë
25 sistemuar nëpër zonat operative aty ku ka pas nevojë dhe ku

1 është dashtë të sistemohen. Krejt deri në fund kur edhe fillon
2 operacioni ku kyçet edhe pjesa më e madhe e mbetur e eprorëve
3 dhe e ushtarëve të kësaj qeverie të kyçur në operacionin
4 Shigjeta në drejtim të Koshares kur janë kyçur të gjithë ne në
5 atë drejtim. Normalisht ata që kanë dashtë; ata që s'kanë
6 dashtë kanë mbetur pa u kyçur ose janë larguar drejt nga
7 Tirana.

8 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në këtë marrëveshje shohim
9 që Kadri Veseli ka G2-shin [Sipas përkthimit] këtu. A mund të
10 na shpjegoni për çfarë, domethënë çfarë nënkupton G2-shi [Sipas
11 përkthimit]?

12 PË. Këtu është J2-shi, është domethënë e Shtabit të
13 Përgjithshëm është zbulim edhe kundërzbulim.

14 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Te kjo strukturë nuk shohim
15 emrin e Fatmir Limajt. A mund të na shpjegoni kush ka qenë
16 përgjegjës për policinë ushtarake sipas këtij versioni?

17 PË. Sipas këtij versioni nuk ka pas drejtori t'policisë
18 ushtarake në atë kohë kur kemi diskutuar. Drejtorja e policisë
19 ushtarake është formuar më vonë, domethënë, pas ristrukturimit
20 [E pakuptueshme] kur kam hyrë edhe këtu shihet që nuk e kemi
21 as drejtorinë e marrëdhënieve civile-ushtarake. Këto të dyjat
22 janë pasi kemi fillu ristrukturimin e kemi vendos pasi e kemi
23 marrë ristrukturën nga perëndimi se çka duhet të ketë një
24 shtab, atëherë e kemi vendos edhe ato dy drejtori.

25 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pra, në kohën e nënshkrimit

1 të kësaj marrëveshje në varësinë e kujt operonte apo

2 funksiononte policia ushtarake?

3 PË. Kjo shkon në marrëveshje të cilat u shkruan, u nënshkruan

4 që të bëhet një infrastrukturë e tillë. Por nuk ka pas diçka

5 funksionale. Unë e kam cek edhe para saj që unë nuk di që ka

6 pas drejtori të policisë ushtarake dhe në qoftë se e ka pas

7 kush e ka udhëheq.

8 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Shkojmë në faqen tjetër të

9 këtij dokumenti, në të dyja versionet.

10 Është një koment diku nga mesi i faqes. Këtu ku është

11 Bicaj Gazeta Ekspres [Sipas përkthimit].

12 Z. EMMERSON: [Përkthim] A mund të flas me Trupin Gjykses

13 për këtë faqe gazete, por pa praninë e dëshmitarit?

14 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Patjetër.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar do

16 të duhet të dilni pak çaste nga salla.

17 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

19 Z. EMMERSON: [Përkthim] Kjo faqe nuk është pjesë e

20 dokumenteve, po, më falni.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

22 Z. EMMERSON: [Përkthim] Më dëgjoni?

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani, po.

24 Z. EMMERSON: [Përkthim] Kjo faqe nuk është pjesë e

25 marrëveshjes. Ka dy versione të marrëveshjes: Një është e

1 plotë; edhe është një dokument ky që po shohim këtu që është
2 përfshirë te provat, por që nuk lidhet me marrëveshjen. Po
3 vetë -- pra, ZPS-ja ka dy versione të të njëjtit dokument. Në
4 një dokument e ka të plotë; një dokument e ka pa këtë faqe.

5 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në fakt unë nuk po e thoja,
6 nuk doja t'i thoja dëshmitarit që kjo është pjesë e
7 marrëveshjes. Unë doja t'i bëja një pyetjet lidhur me diçka që
8 thuhet në këtë faqe.

9 Z. EMMERSON: [Përkthim] Atëherë keqkuptimi im. Mendova se
10 do ta pyesnit lidhur me marrëveshjen.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
12 dhe faleminderit që kërkuat që të larohej dëshmitari. Kjo
13 ishte diçka e dobishme.

14 Mund ta sillni sërish dëshmitarin në sallë.

15 [Dëshmitari vijon dëshminë]

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
17 do vazhdojmë, z. Zyrapi.

18 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Z. Zyrapi, faqja që po
19 shohim këtu, që ta qartësojmë, nuk është pjesë e marrëveshjes.
20 Po këtu thuhet:

21 "Bicaj", këtë e ka shkruar një gazetar nga sa kuptojmë
22 ne.

23 "Bicaj: Këtë marrëveshje e kemi punuar për më të mirën.
24 Duhet pyet Xhavit Haliti pse nuk u zbatua."

25 Më pas thotë, ka detaje të tjera.

1 Tani, a keni ndonjë koment lidhur me këtë, për këtë
2 pretendimin, pra, pse duhej pyetur Xhavit Haliti, pse nuk u
3 zbatua kjo marrëveshje? Pse e keni thënë këtë gjë?
4 PË. Më fal, këtë e ka thënë Bicaj, Halil Bicaj ministri i
5 mbrojtjes së qeverisë Bukoshi. Marrëveshja ushtarake në
6 aspektin që e shpjegova është zbatuar, por është ajo pjesë që
7 u dashtë të zbatohet edhe marrëveshja politike në të cilën nuk
8 është zbatuar. Sigurisht në këtë kontekst edhe e ka shpjeguar.

9 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në rregull. Shkojmë në faqen
10 e parë të këtij dokumenti në të dyja gjuhët.

11 Në mes të këtij dokumenti, në qendër të këtij dokumenti
12 mund të shohim nënshkrimet. Këtu shohim emrin dhe nënshkrimin
13 tuaj dhe emrin dhe nënshkrimin e Kadri Veselit. Këtu thuhet që
14 është nënshkruar në Prishtinë, në 2 nëntor 1998, dhe mban
15 vulën e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së përbri, pra, krah
16 nënshkrimit tuaj nënshkrimit të z. Veseli, kështu?

17 PË. Po, po nënshkrimi nuk u bë në Prishtinë, por u bë në
18 Tiranë, por gjithnjë është shkruar dokumenti për arsye që [E
19 pakuptueshme] është Prishtina. Por është e vërtetë, nënshkrimi
20 është i imi, vula është e Shtabit të Përgjithshëm dhe është
21 bërë ky nënshkrim edhe...

22 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Që ta sqarojmë, përpara se
23 të nënshkruhej kjo në emër të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-
24 së, çfarë hapash ndërmoret ju që të vërtetonit se kjo
25 marrëveshje vërtet pasqyron vullnetin e Shtabit të

1 Përgjithshëm të UÇK-së?

2 PË. Kjo sipas asaj që kemi bisedu, ju e shihni edhe në
3 bisedat dhe kush ka marrë pjesë krejt, domethënë, një pjesë e
4 madhe e anëtarëve të Shtabit kanë qenë aty të cilët kanë
5 shprehur edhe ata vullnetin që të shkonte bashkimi i këtyne
6 forcave. Dhe normalisht pa vullnetin e tyre, ata faktikisht e
7 kanë dhënë vullnetin edhe [E pakuptueshme] që t'i nënshkruajmë
8 këtë marrëveshje dhe të zbatohet në të ardhmen. Dhe ne, unë
9 personalisht me anëtarët e pjesës së shtabit të brendshëm,
10 pastaj kur kemi fillu i kemi zbatuar këtë marrëveshje.

11 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po pse ti dhe z. Veseli, pse
12 e nënshkruat ju dhe z. Veseli? Pse nuk e nënshkroi Azem Sylja
13 këtë marrëveshje?

14 PË. Për shkak se ne kemi fillu bisedimet me ata t'i bëjmë
15 qysh më herët dhe bisedimet, përfundim bisedimet i
16 nënshkruajmë ne që kemi marrë pjesë në këto bisedime. Dhe këtu
17 na është dhënë nga ana e komandantit të përgjithshëm që ne ta
18 nënshkruajmë këtë marrëveshje.

19 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Do flasim për një temë
20 tjetër.

21 Në dëshminë që keni dhënë në gjykimin e Milan Milutinovic
22 dhe të tjerë, në faqen 5959 keni thënë kështu:

23 "Gjatë kohës që isha Shef Shtabi, deri në mars të '99-s,
24 UÇK-ja kishte përafërsisht 17.000, 18.000 ushtarë në
25 territorin e Kosovës."

1 Dhe pastaj sqaroni më tej dhe thoni që nuk ishin të
2 gjithë ushtarë me kohë të plotë. A ju kujtohet kjo dëshmi?
3 PË. Po.

4 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Tek kjo shifra 17.000,
5 18.000 ushtarë, a përfshihen edhe policët ushtarakë?

6 PË. Në këtë shifër përfshihen të gjitha. Edhe njësitë e UÇK-
7 së, policia ushtarake, mbrojtja civile që ka pas edhe mbrojtje
8 civile të cilët kanë qenë në mbrojtjen e fshatrave dhe
9 rrugëve. Gjithsej, domethënë prej tyre kanë qenë këto.
10 Faktikisht brenda numri ka qenë, në qoftë se lexohet mirë aty,
11 brenda kanë qenë 12.600, kurse 6.000 të tjerët janë pjesë e
12 forcave të cilët në operacionin Shigjeta kanë marrë pjesë,
13 janë mobilizuar më vonë prej prillit, majit për këtë operacion.
14 Gjithsej, unë kam thënë, ka pasur 18.000 e diçka.

15 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Nga këta 12.600 në
16 territorin e Kosovës, sa syresh ishin të policisë ushtarake?

17 PË. Nuk e di sa saktë numrin e sa kanë qenë të policisë
18 ushtarake se kanë qenë të saj. Unë në përgjithësi e kam dhënë
19 numrin se në atë kohë kur e foli për këtë numër deri në 15
20 mars të vitit '99 kanë kërkuar nga komandanti i zonës që të më
21 dorëzojnë të gjitha sa ushtarë i kanë në zonat e veta me emër
22 e mbiemër dhe armët dhe numrin e përgjithshëm të zonës. Tani
23 sipas raporteve të tyre, domethënë, dalin 12.600 në
24 përgjithësi. Tani sa janë konë në polici se sa janë konë të
25 asaj nuk e di, nuk mund të them tash se është kohë e gjatë.

1 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Bëni dot një vlerësim,
2 për afërsisht, sa mund të kenë qenë të policisë ushtarake?
3 PË. Mund të them për afërsisht, por s'mundem me e thënë të
4 saktë. Në qoftë se marrim nga këto veprime që Shtabi i
5 Përgjithshëm i ka pasur një kompani. Faktikisht ka pas në
6 realitet policë ushtarakë që e kanë mbrojt Shtabin aty janë
7 konë diku 25 apo 30. Zonat që kanë pas kompanitë kanë mund
8 kanë qenë deri 20, 30 ushtarë. Marrim, po i marrim 7 zonat nga
9 30, po bëjnë 210 apo ato 250 kanë me u konë deri në 300, ka
10 mund ta arrisim, domethënë, të policisë ushtarake,
11 për afërsisht.

12 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Për afërsisht, nga këta
13 12.600, sa ishin të ZKZ-së, nga kjo shifër?
14 PË. Ah nuk e di. Ju lutem, po më kërkoni diçka çka 25 vjet
15 kanë kaluar dhe nuk i kam listat përpara me e dit se sa janë
16 konë. Ne mundna me e dit dhe si sektorë që kanë ekzistuar,
17 pastaj vetë jam konë e nuk mujt me e dit atë se është kohë e
18 gjatë nuk mund të jap, them, përmendësh mund të ketë numra të
19 ndryshëm.

20 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në rregull. Tani do kalojmë
21 te komunikatat ose komunikimet - më falni.

22 Juve përmendët përdorimin e radio Motorola, të telefonave
23 satelitorë dhe të korrierëve, të njerëzve që ju shërbenin si
24 korrierë. A keni përdorur telefona civilë, domethënë, me fjalë
25 të tjera, a keni përdorur rrjetin civil të komunikimit me

1 telefon? Me "civil" e kam fjalën rrjet të zakonshëm telefonik,
2 komunikimi telefonik.

3 PË. Të qartë e kam. Çka di unë, jo, personalisht, jo. A kanë
4 pas të tjerë, nuk e di. Zakonisht unë çka e di që është përdor
5 gjatë kësaj kohe kanë qenë Motorolat, frekuenca të shkurtra
6 dhe kanë qenë telefonat satelitorë. Për të tjera telefona nuk
7 e di që ka mujt të përdoren ose çka përdor dikush. Unë të
8 paktën kam parë.

9 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Përveç radiove Motorola, a
10 kishte UÇK-ja njësi përsëritjeje ose releje?

11 PË. Më fal, nuk e kuptoj njësi përsëritëse.

12 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Mendoj që i njihni nga
13 shërbimet në armatën jugosllave, besoj, që vala e një radioje
14 mund të zgjatët më tej, duke përdorur një njësi e cila bën, si
15 me thënë, transmetimin më tej të sinjalit, për këtë e kisha
16 fjalën.

17 PË. Do të thoni repetitor, po. Jo, nuk ka pas.

18 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po.

19 PË. Një më vonë dikur kur na ka ardhë, ku, a ka qenë shkurt a
20 mars, s'e di, kemi vendos, por me ato nuk kemi mund t'i
21 arrisim krejt territorin e Kosovës ta përfshijmë, për shkak se
22 konfiguracioni i terrenit të cilit ka qenë i ndërprerë. Por
23 atë sistem nuk e kemi pas zhvilluar shumë.

24 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pra, po thoni që në një
25 forcë prej 12.600 personave keni pas një njësi repetitore,

1 këtë po thoni?

2 PË. Po, po saktë.

3 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pasi keni marrë telefonat
4 satelitorë, besoj që keni aluduar në dëshminë e dhënë ca
5 vështirësi që kishin të bënin me përdorimin e këtyre
6 telefonave. A mund të na thoni konkretisht se çfarë problemesh
7 ose çfarë vështirësish keni pasur konkretisht për përdorimin e
8 telefonave satelitorë?

9 PË. Po sidomos telefonave satelitorë në atë kohë, por edhe
10 Motorola ka qenë mbushja e baterive të tyre me energji
11 elektrike që në atë kohë mungonte, dhe nuk kishim aq mundësi
12 që t'i mbushnim çdoherë. U duke t'i mbushnim t'i ruanim, t'i
13 përdorim sa më shkurt, pra, me mujt me e pas më gjatë në
14 komunikim. Këto ishin problemet.

15 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Nga shërbimi në ushtrinë
16 boshnjake dhe në armatën jugosllave besoj që keni qenë të
17 njohur me praktikën e pasjes së gjeneratorëve për prodhimin e
18 energjisë elektrike besoj, apo jo?

19 PË. Ajo është e qartë që kanë qenë edhe ato dhe është
20 përvojat në ato, por nuk kanë mundur me i pas të gjitha. Dhe
21 lëvizjet sidomos gjatë ofensivave ose gjatë sulmeve që t'i
22 kemi edhe gjeneratorët me vete dhe t'i ndezim për me i mbush.
23 Është problem i madh. Ajo është në paqe që mund të bëhet, por
24 në luftë s'mund në territor ku ka luftime e vështirë është që
25 të punohet në atë drejtim që të përdoret, përdoren

1 gjeneratorët.

2 Por kur na ka luftime kemi mund diku ku ka pas
3 gjeneratorë t'i përdorim për t'i mbushur ato bateritë për t'i
4 pasur, por jo edhe çdoherë, në sulme jo.

5 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Problemi i rënies së
6 baterive a ka pas, a ka qenë i vetmi problem që ekzistonte sa
7 i takon komunikimit me telefona satelitorë?

8 PË. Po, më së shumti po.

9 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po çfarë problemesh të tjera
10 ka pas përveç kësaj?

11 PË. Me çka më kujtohet më shumë probleme kanë qenë këto, me
12 energji elektrike.

13 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Tani do të kaloj te policia
14 ushtarake. Nga dëshmia juaj e kuptoj që përpara krijimit të
15 drejtorisë së policisë ushtarake nuk ka pasur një autoritet
16 ose një organ koordinues për policinë ushtarake, kjo është
17 dëshmia juaj?

18 PË. Po, saktë.

19 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit tani
20 të paraqesë në ekran provën P83, më konkretisht, ju lutem,
21 paraqisni faqen 4 në shqip dhe po ashtu faqen 4 në anglisht.

22 Gjatë javëve të fundit z. Zyrapi, ne kemi parë referenca
23 të përsëritura për rregulloret e brendshme të Shtabit të
24 Përgjithshëm që do shfaqet tani në ekran për juve. Pra, do e
25 shikojmë një rregullore të Shtabit të Përgjithshëm. Do ju

1 kërkoja që të shikonit paragrafin 14. Në këtë paragraf
2 përshkruhet drejtoria e shërbimit informativ.

3 Dhe po lexoj: Drejtoria e shërbimit informativ është
4 drejtori e cila "merret me ekspertizën e organizimit të
5 masave, metodave dhe mënyrave të kundërzbulimit dhe sigurimit
6 të fshehtë dhe merr pjesë në propozim e të tjera".

7 E shikoni këtë pjesën, Dëshmitar?

8 PË. Po.

9 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Si është zhvilluar kjo gjë
10 në praktikë, si ka ndodhur kjo realisht në praktikë?

11 PË. Në fakt në praktikë ka qenë shumë vështirë prej asaj
12 kohës, domethënë, të ristrukturimit se veç drejtori i saj nuk
13 ka qenë një kohë e gjatë aty dhe nuk kemi mujt t'i zbatojmë
14 këto. Kjo është përkthimi që është bërë nga, përkthimi që kemi
15 bërë nga ushtritë perëndimore dhe kemi tentuar që të shkohet
16 në atë drejtim, por nuk kemi arrit t'i bëjmë këto masa ose
17 këto veprime.

18 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në paragrafin tjetër thuhet
19 që drejtoria e shërbimit informativ "kryen detyra dhe
20 aktivitete të tjera mbi bazën e komandave dhe Shefit të
21 Shtabit të UÇK-së". E shikon këtë, Dëshmitar?

22 PË. Po.

23 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Sa i takon shefit të shtabit
24 që i takon që keni qenë ju, si keni dhënë ju direktiva ose
25 urdhra për drejtorinë e shërbimit informativ?

1 PË. Unë në atë kohë nuk kam mund me t'i dhënë urdhra, shefi i
2 shtabit kërkon ose t'i jep urdhra në drejtim të grumbullimit
3 të informacioneve të forcave të armikut, domethënë, forcat e
4 tyre, sa ushtarë ka, mjetet teknike ose armatimin që e ka; ku
5 janë të bazume, nga janë duke lëvizur, me mundësi, planet e
6 tyre. Këto janë që i kërkon shefi i shtabit nga zbulimi, ky
7 sektor, për t'i pasur në dijeni, për me mundur me i përgatit
8 operacionet si të mbrojtjes po ashtu edhe të sulmit, shkurt se
9 ka edhe shumë të tjera.

10 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Lloji i informacionit që ju
11 mund të urdhëronit ishte informacion kundërzbulimi, apo jo?

12 PË. Jo. Zbulimit, fort zbulimit të forcave serbeve.

13 Kundërzbulimi është aspekti kur kundërzbulon -- kundërzbulimi
14 është pjesa e cila bëhet zbulimin e bashkëpunëtorëve ose
15 spiunëve të cilët janë në radhët e ushtrisë apo në territor ku
16 grumbullon informacione nga pjesa e armikut që e ka dërguar.
17 Kurse zbulim, folim, kur folim këto, këto janë pjesë të cilët
18 kërkohet nga aspekti i vëzhgimit, të cilët mblidhen në
19 formacion për armikun, për forcat e tyre, për mënyrën për
20 mujtën shefi i shtabit me e organizu operacionet ose mbrojtjes
21 ose sulmit.

22 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Por sigurisht ju si shef
23 shtabi dhe gjithashtu edhe komandantët dhe zëvendëskomandantët
24 pritnit që t'ju tregoheshin pa vonesë informacione zbulim-
25 kundërzbulimi apo jo?

1 PË. Po, ashtu me rregull është.

2 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Cilat subjekte ose cilat
3 njësi veçanërisht ju jepnin informacion ju që kishin të bënë
4 me shërbimin informativ, me kundërzbulimin?

5 PË. Po në atë kohë më së shumti që binin informacione kanë
6 qenë informacion njësitë të zonave, i marrshim prej zonave,
7 kanë qenë prej shtabeve lokale të cilët kanë qenë të
8 organizuar në atë drejtim. Kemi marrë prej tyre informacionet
9 për territorin, për lëvizjen e armikut, për të gjitha në ato
10 që janë përcjellur. Pastaj përmes saj në zona prej zonës në
11 shtab. Dhe ne pastaj me formimin e njësive vëzhguese që janë
12 konë në Shtabin e Përgjithshëm, pastaj kemi dërguar këto
13 njësitë që të vëzhgojnë territorin edhe vëzhgojmë forcat serbe
14 ku gjinden, cilat janë dhe të gjitha ato çka i ceka.

15 Nga të gjitha këto struktura janë marrë këto
16 informacione.

17 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Do i lutesha Sekretarit që
18 ta heqë dokumentin nga ekrani. Domethënë jo, të njëjtin
19 dokument dua që ta kaloni më poshtë te faqja, më poshtë nën
20 faqe.

21 Atëherë te paragrafi 15 drejt fundit të faqes, ju lutem,
22 hidhini një sy. Është një drejtori, pra, flet, ky paragraf për
23 drejtorinë operative që ka qenë nën drejtimin tuaj. Thuhet që:

24 "Kjo drejtori merret me analizat ose në këtë drejtori
25 janë të gjitha informatat, analizat, konkludimet, llogari e të

1 tjera, të cilat janë të domosdoshme për marrjen e vendimeve të
2 operacioneve luftarake, si dhe për organizimin e veprimeve të
3 ndryshme luftarake (taktike)".

4 E shikoni këtë pjesën?

5 PË. Po, po e shikoj.

6 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A mund t'i tregoni Trupit
7 Gjykses, ju lutem, se si drejtoritë kishin të gjitha raportet,
8 analizat, informatat që përmenden te kjo pjesa?

9 PË. Folim për drejtoritë, drejtoria operative. Drejtoria
10 operative për të i ka, folëm edhe më herët. Të gjitha ato
11 drejtoritë, po edhe informatat që vijnë për lëvizjet e forcave
12 serbe, për të gjitha këto dërgohen në shtab. Shtab ka qenë i
13 organizum në drejtorinë operative, salla operative, aty ku
14 janë grumbullu informatat që kanë ardhur. Prej nga atyhit janë
15 përpunuar këto informata dhe janë përgatitur, siç e ceka, për
16 operacionet e ndryshme si për mbrojtje, si për sulm, si për
17 lëvizjet luftarake. Dhe mbas kësaj, normalisht, kur
18 grumbullohen të gjitha këto informata përpilohen planet
19 operacionale.

20 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Tani do të kalojmë te një
21 dokument që e keni diskutuar më herët shkurtimisht me
22 Gjykatësin Mettraux. Janë Rregulloret e Përkohshme të UÇK-së
23 për Organizimin e Jetës së Brendshme të Ushtrisë.

24 Do i kërkoja Sekretarit të seancës të paraqesë në ekran
25 një version që është pranuar në provën 8, P8. Ju lutem na

1 kaloni te faqja 15 e këtij dokumenti, Sekretar.

2 Nëse e keni të vështirë që të lexoni, më thoni se kemi
3 edhe një version tjetër që është më i qartë për t'u lexuar. Z.
4 Sekretar, ju lutem e kaloni në të djathtë fletën, faqet në të
5 dyja, në shqip dhe në anglisht. Ky kre ka të bëjë me policinë
6 ushtarake dhe detyrat e saj.

7 Ju lutem na thoni në qoftë se e lexoni dot apo jo. Në
8 qoftë se nuk e lexoni dot mund të kërkojmë që të paraqitet një
9 version që është më lehtësisht i lexueshëm. E lexoni dot?
10 PË. Po.

11 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Te paragrafi 4 thuhet:

12 "Organet e policisë ushtarake varen nga drejtoria e
13 policisë ushtarake ..."

14 Që cakton komandantët në nënzonat operative të policisë
15 ushtarake. A e shikon këtë pjesë?

16 PË. Po.

17 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A pajtoheni me këtë pohim që
18 kjo është mënyra se si është menduar të bëhet puna?

19 PË. Në këtë kuptim kjo pikë është në cilën në atë kohë është
20 përdorur për çështje të mund duhet të pyetet edhe drejtoria e
21 policisë ushtarake për përgatitjet e njerëzve që mund të
22 vendosen në pozitën komanduese. Por vendosjen e tyre edhe
23 emërimin e tyre e bëjnë, e kanë bërë komandantët e zonave.
24 Faktikisht është njëfarë lloji pëlqimi që mund t'i jipet nga
25 kjo drejtori që tregon sa është aftësia e tij për të komanduar

1 me këto njësi apo jo dhe a mund të jetë në atë detyrë. Nga ky
2 aspekti është shkruar -- është përkthyer për policinë
3 ushtarake.

4 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Thuhet shumë qartë këtu:

5 "Organet e policisë ushtarake varen nga drejtoria e
6 policisë ushtarake...".

7 A nuk është kështu?

8 PË. Varen nga aspekti profesional që përgatiten, trajnohen,
9 për këtë detyrë. Por të gjitha vartësitë këtu njësitë që janë
10 më poshtë janë në komandën e komandantëve që i kanë pranë
11 vetes, zonave apo brigadave.

12 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Shikoni te lista e detyrave
13 të policisë ushtarake që jepen nën pikën 5. Nuk është shumë e
14 lexueshme në këtë version. Megjithatë sikurse ju thashë edhe
15 më herët, në qoftë se doni që t'ju tregoj një version që mund
16 të lexohet më lehtë, ma thoni. Atëherë shikoni detyrat e
17 policisë ushtarake tek pika 7 [Sipas përkthimit] që është te
18 faqja tjetër.

19 Sekretarit i lutem që të kalojmë te faqja tjetër si në
20 versionin shqip ashtu edhe në versionin anglisht.

21 Pika e dytë këtu në këtë faqe, konfirmojmë që një prej
22 detyrave të policisë ushtarake është:

23 "- të ndihmojë dhe të bashkëpunojë me drejtorinë e
24 shërbimit të fshehtë të zbulimit e kundërzbulimit për të
25 ndriçuar forma të ndryshme të kriminalitetit."

1 A e shihni këtë?

2 PË. Po.

3 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në fund të faqes, fjalia e
4 fundit fare i referohet policisë ushtarake. Dhe këtu theksohet
5 që policia ushtarake "nuk duhet të ketë mëshirë ndaj armiqve
6 dhe të gjithë atyre që përpiqen që të pengojnë dhe sabotojnë
7 luftën tonë çlirimtare".

8 A e shikoni këtë?

9 PË. Po.

10 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pra, përshtypja që të
11 krijohet kur lexon këtë dokument është që, së pari, policia
12 ushtarake është e varur nga drejtoria e policisë ushtarake; së
13 dyti, ata kanë detyrën e rëndësishme që të bashkëpunojnë me
14 drejtorinë informative dhe me hetimet; dhe së treti, ata nuk
15 duhet që të kenë mëshirë fare ndaj të gjithë atyre që përpiqen
16 që të pengojnë ose sabotojnë luftën çlirimtare.

17 E kam kuptuar drejt këtë pjesë të rregullores?

18 PË. Po, ashtu edhe shkruan këtu. Po veprimi i saj është në
19 polici ushtarake koordinon edhe bashkëpunon edhe me zbulimin,
20 por bashkëpunon edhe me sektorin juridik. Është shumë e qartë
21 që ka bashkëpunim me ta punon. Por të gjitha këto bashkë ashtu
22 nuk e di.

23 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Është shumë e qartë prej
24 këtij dokumenti që ata kanë pasur detyra të rëndësishme sa i
25 takon hetimeve. Dhe që atyre u kërkohet që t'i kryenin këto

1 hetime në koordinim ose në bashkërendim me drejtorinë
2 informative.

3 PË. Me këtë dokument, po, ashtu i bjen.

4 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Kaq pyetje kisha.

5 Faleminderit.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Zyrapi, kam një pyetje të
7 fundit. Ju pretoj nuk kam pyetje tjetër përveç kësaj. Pyetja
8 ka të bëjë me një provë materiale që jua tregoi Gjykatësi
9 Gaynor, kolegu im, përpara pak çastesh.

10 Do i kërkoja Sekretarit që të paraqesë në ekran provën
11 materiale 1D00166. Faleminderit.

12 Thatë më herët, z. Zyrapi, në përgjigje të pyetjes që ju
13 bëri kolegu im, Gjykatësi Gaynor, që ky dokument në fakt nuk
14 ishte nënshkruar në Prishtinë, por në Tiranë. Dhe keni thënë
15 po ashtu siç thuhet në faqen 60 të transkriptit në kohë reale,
16 që në qoftë se do ishte bërë, domethënë pyetja është që "... a
17 është bërë në Prishtinë apo jo".

18 Pyetja ime është kjo: Pse është e rëndësishme që të
19 thuhet në një dokument që ishte bërë ose që ishte nënshkruar
20 fizikisht në Prishtinë?

21 PË. Nuk e di aspektin kush a ka shkrujt. Këtë e ka shkru këtë
22 dokument që është përgatitur, përgatit te ministria e
23 mbrojtjes Qeverisë në Ekzil. Me ato qa ka dash me thënë, nuk e
24 di. Por ka, por e di që ky dokument nuk është nënshkru në
25 Prishtinë, por është nënshkru në Tiranë.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po ta bëj këtë pyetje, sepse
2 kemi parë edhe dokumente të tjera të cilat pretendohet që të
3 jenë nënshkruar ose përgatitur, të jenë përgatitur në
4 Prishtinë dhe është pretenduar që nuk ka qenë ky rasti, sepse
5 nuk ka pasur një institucion të tillë në Prishtinë në atë
6 kohë.

7 Pra, pyetja ime e radhës është kjo, që sipas asaj çfarë
8 dini ju, me aq sa dini juve a është bërë kjo në raste të
9 tjera? Domethënë që dokumenti është shkruar ose është
10 përgatitur në një vend të ndryshëm nga ai që pretendohet të
11 jenë shkruar ose përgatitur?

12 PË. Po, sidomos ky dokument, po. Këtë po e di mirë që këtë e
13 kemi përgatitur dhe është nënshkruar në Tiranë, jo në
14 Prishtinë. Për tjerët nuk e di, mundet me qenë që ka pas, por
15 s'më kujtohet.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Nuk kam pyetje
17 të tjera.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë sa
19 për të ditur sa kohë na duhet. Znj. Prokurore, a ju duhet kohë
20 më për të bërë pyetje mbështetur në pyetjet e bëra nga
21 Gjykatësit?

22 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Kam një çështje organizative dhe
23 kam pak pyetje. Ndoshta pesë minuta ose edhe më pak sesa kaq.
24 Vetëm për një temë i kam pyetjet.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Misetic.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bislim Zyrapi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese nga znj. Lawson

Faqe 87

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Më duhen më pak sesa 30 minuta.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

3 Z. EMMERSON: [Përkthim] Më duhet pak a shumë një orë.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
5 çaktivizuar].

6 Z. ROBERTS: [Përkthim] Maksimumi pesë minuta.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
8 çaktivizuar]. Z. Ellis.

9 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
10 planifikoj maksimumi dy orë.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
12 Faleminderit. [Mikrofoni çaktivizuar].

13 Po, znj. Prokurore. Sa i takon çështjes organizative,
14 doni që ta diskutoni me praninë e dëshmitarit?

15 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Nuk ka problem. Edhe mund të jetë
16 dëshmitar, por ndoshta do ishte më mirë që ta bëjë në fund,
17 ndërkohë që nuk do jetë dëshmitari i pranishëm.

18 Të fillojmë me pyetjet për dëshmitarin tani.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

20 Pyetje vijuese nga znj. Lawson:

21 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

22 PY. Dëshmitar, shembulli që diskutuat me Gjykatësit, sa i
23 takon një komandanti zone që nuk ka ndjekur kërkesat e bëra
24 nga Shtabi i Përgjithshëm, ai lidhet me Remin për mostërheqjen
25 e ushtarëve të tij nga fronti Prishtinë-Podujevë në dhjetor të

1 vitit 1998. Dua t'ju bëj disa pyetje të tjera shtesë lidhur me
2 këtë episod.

3 Së pari, në qoftë se e kam kuptuar siç duhet dëshminë, ju
4 keni folur vetëm me zëvendëskomandantin në zonën e Llapit me
5 Kadri Kastratin lidhur me këtë gjë. A është e saktë kjo?

6 PË. Po.

7 PY. Atij i keni dhënë këshillime të caktuara lidhur me këtë
8 situatë, kështu? Ju vetë nuk keni pasur ose nuk keni qenë
9 dëshmitar i kontakteve të tjera ndërmjet Shtabit të
10 Përgjithshëm dhe Remit ose zonës së Llapit lidhur me këtë
11 temë, lidhur me këtë çështje, a është kështu?

12 PË. Po, e saktë.

13 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit të
14 paraqesë në ekran provën P00668. Ju kërkoj ndjesë, ju dhashë
15 numrin e gabuar. Në fakt është numri 688.

16 PY. Ky është një dokument që e keni parë gjatë dëshmisë suaj.
17 Mban datën 19 nëntor 1998.

18 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Shkojmë më poshtë në faqe, që
19 dëshmitari të ketë mundësinë ta shohë në shqip dhe të kalojmë
20 tani te faqja tjetër.

21 PY. Këtu mund të shohim një kërkesë që të tërhiqeshin forcat
22 serbe nga disa postblloqe. A keni pasur dijeni me këtë
23 përpjekje që është bërë asokohe për të larguar forcat serbe
24 nga postblloqet?

25 PË. S'e di, m' duket se ka qenë pas marrëveshjes së

1 armëpushimit të njëanshëm që edhe ata t'i heqin postbolloqet.
2 Edhe ne prej -- të largohemi, prej rrugëve të largohemi dhe të
3 lemë qarkullimin e lirë të rrugëve. Që më kujtohet kjo ka
4 qenë. Tash a është kjo bash aty nuk po mbaj mend.
5 PY. Te pika 7 janë përmendur disa vende në Llap -
6 Llapashtica, Lluzhani, Orllani dhe Kërpimëh. Lluzhani është në
7 rrugën Prishtinë-Podujevë. Në fund të nëntorit 1998, Shtabi i
8 Përgjithshëm u ka kërkuar forcave të policisë serbe të
9 tërhiqen nga postbolloqet e vendosura në këtë rrugë, kështu?
10 PË. Po, në rrugët kryesore për qarkullimin ose lëvizjen e
11 lirë më pas. Si ata që kanë pas lëvizjen aty, por edhe ne me e
12 pas.

13 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Shkojmë në faqen tjetër të
14 dokumentit.

15 PY. Këtu ka një paralajmërim që nëse nuk tërhiqen forcat
16 serbe dhe vazhdojmë me të vjetrën do të goditen nga njësitë e
17 patrullimit të UÇK-së.

18 Ju keni konfirmuar në deklaratën tuaj të mëhershme - tek
19 gjykimi Sainovic në faqen 5988 - keni thënë që gjatë periudhës
20 së armëpushimit ka pasur disa raste kur njësitë e UÇK-së kanë
21 sulmuar postbolloqet serbe në raste kur pengonin lëvizjet
22 tuaja, kështu?

23 PË. Po, saktë.

24 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit. Nuk kam më pyetje.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Misetic,

1 ke gjysmë ore, pra, para, dhe të përfundoni para pushimit të
2 drekës.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit. Vetëm më jepni një
4 çast ju lutem.

5 Shkojmë në faqen e parë të dokumentit që kemi në ekran.
6 Më falni faqja 2.

7 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Misetic:

8 Z. MISETIC: [Përkthim]

9 PY. Nejse. Ndërkohë që presim të shfaqet faqja përkatëse,
10 mirëdita, z. Zyrapi.

11 PË. Mirëdita.

12 PY. Dua të sqaroj diçka këtu. Kjo është -- shikoni paragrafin
13 e parë. Kjo është një kërkesë drejtuar KDOM-it, apo jo?

14 PË. Po.

15 PY. Pra, keni kërkuar që të ndërhyjë KDOM-i i SHBA-së. Nuk
16 është se keni bërë ju drejtpërdrejt deklaratë, nuk keni bërë
17 ju kërkesë drejtpërsëdrejti forcave serbe, kështu? Dhe kur
18 them ju, jo ju personalisht, po kushdo që ka qenë autori i
19 këtij dokumenti.

20 PË. Po e qartë është. Ky ka shku përmes KDOM-it dhe OSBE-së,
21 jo drejtpërsëdrejti.

22 PY. Të shohim disa pika së bashku. Do fillojmë me disa nga
23 pyetjet që ju bëri Gjykatësi Barthe.

24 Ai ju pyeti: Kush e kishte kompetencën të zëvendësonte
25 një komandant zone? Dhe unë kam pyetjen ndërlidhëse me këtë.

1 Faktikisht, në terma praktikë, Azem Syla, a mund ta

2 zëvendësonte komandant Remin?

3 PË. Në cilin aspekt të zëvendësonte? Se te ne kuptimi

4 zëvendësim ka dy.

5 PY. Ta hiqte, ta hiqte dhe të vendoste dikë tjetër.

6 PË. Po, komandanti i përgjithshëm, në qoftë se është dhënë,

7 vlerësuar nga shtabi, nga të gjithë që duhet të largohet dhe

8 atëherë edhe komisioni [E pakuptueshme] që ka qenë i përcaktum

9 atëherë ka mujt ta lëvizë.

10 PY. Tani po ju pyes, nuk po flasim teorikisht tani, por në

11 realitet, a mund të bënte diçka praktikisht. Për shembull, ju

12 personalisht apo z. Syla, a mund të dërgonit ndonjë njësit të

13 policisë ushtarake për ta arrestuar komandant Remin dhe për ta

14 hequr nga pozita që kishte?

15 PË. Në qoftë se marrim atë kohë atëherë e duke marrë parasysh

16 që komandanti i zonës ka pasur vërtet më tepër në zonën e vet

17 se ne si shtab, ka qenë vështirë të bëhet ai veprim i tillë.

18 Ne kemi mujt të evidentohet apo të merret masë masandej, por

19 në atë kohë jo, jo. Është shumë vështirë.

20 PY. Do t'jua bëj të njëjtën pyetje për Sylejman Selimin. Azem

21 Syla, në realitet flasim, e hiqte dot Sylejman Selimin, e

22 zëvendësonte me dikë tjetër?

23 PË. Si mendon në pozitën e komandantit të zonës apo komandant

24 të përgjithshëm kur u vendos?

25 PY. Po. Unë fillimisht po ju pyes nëse në realitet, *de facto*,

1 a kishte kompetencë, a e hiqte dot Sylejman Selimin si

2 komandant zone ta zëvendësonte me dikë tjetër?

3 PË. Me kompetencë po, por në realitet jo. Ka qenë vështirë se
4 ka pas autoritetin në atë zonë.

5 PY. Po, këtë e kemi diskutuar, por *de facto*. Sylejman Selimi
6 ishte ai që zëvendësoi Azem Sylën përfundimisht, apo jo?

7 PË. Ajo po zëvendësimi i komandantit të përgjithshëm.

8 PY. Në lidhje me këtë ju bëri disa pyetje Gjykatësi Barthe,
9 lidhur veçanërisht me incidentin e komandant Remit në rrugën
10 Prishtinë-Podujevë. Ju thatë:

11 "Unë nuk isha në pozita të merrja ... masa" kundër Remit.

12 Dhe unë po ju pyes: Pse nuk ishit ju në pozicion që të
13 merrnit masa kundër Remit?

14 PË. Po nuk mundet të merrsha unë [E pakuptueshme] veprime se
15 nuk kam pas autoritetin e tillë edhe faktikisht e ka pas një
16 autoritet më të madh në zonën e tij. Por çdo lëvizje të një
17 komandanti sigurisht me autoritet që ka pas në atë zonë ka
18 qenë shumë problem për atë zonë dhe për shtabin.

19 PY. Gjykatësi Barthe ju bëri disa pyetje për rolin që ka
20 pasur z. Thaçi për median. Dhe ju pyeti nëse e kishit parë
21 ndonjëherë të fliste me gazetarët.

22 Pyetja ime e parë për ju është kjo: Ju kujtohet ajo
23 videoja propagandiste që kishit bërë ju edhe për të cilën
24 folët gjatë dëshmisë suaj, kështu?

25 PË. Po.

1 PY. Kjo ishte një video e përgatitur nga gazetari Nuhi

2 Bytyqi, apo jo?

3 PË. Saktë.

4 PY. Kameramani ka qenë Abaz Zeka?

5 PË. Po.

6 PY. Z. Thaçi ka qenë i pranishëm kur është incizuar kjo

7 video?

8 PË. Sa më kujtohet më duket ka qenë, më duket, nuk e di.

9 PY. Do përpiqem t'ju rifreskoj kujtesën e t'ju them se çfarë
10 ka thënë, çfarë ka shkruar Nuhi Bytyqi në librin e tij për
11 këtë.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Do ju lutesha të shfaqej në ekran
13 prova materiale P01264. Në anglisht faqen SPOE00128683, në
14 shqip i njëjti numër. Pjesa -- 683 duhet të jenë tre shifrat e
15 fundit të anglishtes.

16 Pra, është pjesa kur fillon, "Pas çdo ofensive të forcave
17 serbe, ky titulli këtu. Ju lutem, të shfaqni fundin e faqes të
18 shqipja.

19 PY. Paragrafi i dytë ku thotë:

20 "Në Likoc takova edhe shefin e Shtabit Operativ të UÇK-
21 së, Bislum Zyrapi, me të cilin realizova një bisedë për
22 zhvillimet në zonat e luftës, pas ofensivave të forcave serbe.
23 Ai me qetësinë e tij, por me përvojën e tij të madhe luftarake
24 në Bosnje dhe tani në Kosovë, shprehu vullnetin dhe
25 vendosmërinë e madhe të djemve dhe të vashave trima e

1 trimëresha të UÇK-së për vazhdimin e luftës”.

2 Pastaj thotë:

3 “Në Likoc takova edhe një shok të studimeve të Hashim
4 Thaçit, profesorin e historitë Murat Halitin nga fshati
5 Lubovec i Skënderajt. Murati para kamerës shprehu optimizmin
6 se lufta e UÇK-së do të shpie deri te fitorja. Ai i ftoi
7 intelektualët shqiptarë t’i bashkëngjiten dhe ta mbështesin më
8 fuqishëm luftën e UÇK-së. Bile kur e dëgjoi Hashimi këtë apel
9 ftesë të Muratit sikur bëri shkak me të tha, ‘Shoku im,
10 faleminderit për apelin, por ti nuk je Rexhep Qosja’”.

11 Pra, nga sa kuptojmë ne këtu edhe z. Thaçi ka qenë në
12 Likoc në të njëjtën kohë. Të kujtohet ty që të ketë qenë dhe
13 z. Thaçi me Nuhi Bytyqin kur keni incizuar videon?

14 PË. Po.

15 PY. Pra, a ju kujtohet tani që në fakt vërtetë e keni z.
16 Thaçi me të paktën një gazetar?

17 PË. Po mundet me e pa jo veç me një gazetar. Mund me u konë
18 me Nuri Bytyqin, ka pas edhe gazetarë të huaj kur është takue.
19 Unë çka kam bisedu tek kam bisdeu nuk kam qenë afër me e
20 ditën.

21 PY. Të flasim tani kontaktet me reporterët e huaj.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Shohim në ekran DHT04056 deri në
23 DHT04069 [Sipas përkthimit].

24 PY. Unë në ekran do nxjerr një artikull të gazetës *New York*
25 *Times* që mban datën 12 korrik [Sipas përkthimit] 1998.

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Shohim faqen 2 të anglishtes. Të
2 dyja versionet.

3 PY. Ky është një raport për ofensivën në Rahovec. Thotë:

4 "Ky është hapi i parë që është marrë për të
5 intensifikuar cilësinë e luftës nga lufta kundër zonave rurale
6 në fazën e lëvizjes kundër zonave urbane', tha shqiptari etnik
7 komandant i sulmit, i cili do të jepte edhe emrin e luftës
8 Gjapri. Ai tha se strategjia e kryengritësve tani ishte të
9 merrnin qytete të tjera dhe përfundimisht të kapnin
10 kryeqytetin e provincës, Prishtinën."

11 Së pari, a pajtoheni që në atë kohë nuk ka pasur dhe duke
12 parë edhe këtë që shohim këtu, tregon që nuk ka pasur ndonjë
13 strategji në ofensivën e Rahovecit?

14 PË. Jo veç në ofensivën e Rahovecit jo, veç po dhe të tjerat.
15 Se njësitë nuk kanë qenë të gatshme operationale për me vepru
16 në këtë lloj operatione. Se për të vepruar ose për të
17 përgatitur një operation për në fshatra, qytete, sidomos
18 qytete nevojitet goxha shumë kohë të përgatitet si njësitë po
19 ashtu edhe kohë për mjete, resurse për të gjitha. Nuk mund të
20 thuhet veç është përgatitur dhe mund të jenë në sulm.
21 Domethënë nuk është ashtu.

22 PY. Pra, nuk ka pas ndonjë plan për të sulmuar Prishtinën,
23 apo jo? Për të përgatitur një sulm kundër Prishtinës, kështu?

24 PË. Jo. Në atë kohë jo. E tjerët të gjithë përgatitën goxha
25 shumë kur kemi mbërri, faktikisht, operationi kur kemi fillu

1 ta zhvillojmë një operacion të tillë të madh që thonë
2 operacione operative dhe strategjik është Operacioni Shigjeta
3 nga Shqipëria në Kosovë edhe që ka pas këtë detyrë që të hyjnë
4 me forca të tjera nga ka dalë të bën çlirimin e Kosovës. Por
5 deri atëherë vështirë ka qenë edhe nuk kemi pas kesi lloj
6 përgatitje.

7 PY. Po. Po a pajtoheni me mua që kjo është një pjesë e
8 propagandës që bënte z. Thaçi me shtypin ndërkombëtar?

9 PË. Po sigurisht është propagandë se ky është fare s'ka qenë,
10 domethënë, e tillë për t'u përgatitur ose për ta pas një
11 strategji të tillë.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani do shohim një artikull të
13 *Washington Post*, DHT04053, ju lutem. Artikull i *Washington Post*
14 që mban datën 6 gusht 1998.

15 Kjo është pas ofensivave serbe.

16 Shkojmë në paragrafin e tretë por edhe tek anglishtja.
17 Mbase nuk jua dhashë numrin të saktë. Në anglisht është
18 055828.

19 PY. Paragrafi i tretë thotë:

20 "Politika e re u detyrua nga rrethanat 'të krijuara në
21 fushë' tha një komandant i cili nuk pranoi të jepte emrin, por
22 tha se emri i tij i luftës është 'Gjarpër'. Ai akuzoi forcat e
23 sigurisë po përpiqeshin 'të shkatërronin gjithçka në rrugën e
24 tyre dhe të zhvendosin sa më shumë civilë të jetë e mundur'".

25 E shihni këtë?

1 PË. Po.

2 PY. Kur thatë ju që z. Thaçi ka punuar me median, a është kjo
3 një pjesë e punës së tij, të kontaktonte, pra, shtypin
4 ndërkombëtar dhe t'u jepte versionin e shqiptarëve të Kosovës
5 lidhur me atë që po ndodhte?

6 PË. Po, detyra e tij ka qenë edhe kjo. Me dhe jo vetëm me
7 gazetarë të brendshëm që ka pas në Kosovë, por edhe gazetarët
8 e jashtëm.

9 PY. Dhe ka qenë puna e tij që të tërhiqte vëmendjen për
10 pasojat që kishin ofensivat dhe krimet serbe në popullatën
11 shqiptare dhe fshatrat shqiptarë, kështu?

12 PË. Po.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Kryegjykatës, kërkoj të
14 pranohet si prova të dy këto artikuj.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
16 kundërshtime?

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Jo.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Materiali
19 DHT04056 deri në DHT04059 pranohet.

20 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Materiali DHT04056 deri
21 në DHT04059 në anglisht dhe shqipja që ka numrin DHT04056 - më
22 falni - DHT040506 [Sipas përkthimit] deri në DHT0606-AT [Sipas
23 përkthimit] do të marrë numrin e provës materiale 1D00170 dhe
24 klasifikimin e ka publik.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Materiali

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bislam Zyrapi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 98

1 DHT04053 - mirë e thashë numrin?

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Ky ishte versioni në shqip.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe ishte një
4 tjetër që përfundonte me 055828. Po ashtu pranohet.

5 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Materiali do të marrë
6 numrin 1D00171 dhe klasifikimin e ka publik.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

8 PY. Tani dua të flasim për pyetjet e Gjykatësit Mettraux. Më
9 falni kam ende sqarime për pyetjet e Gjykatësit Barthe.

10 Ju pyeti për marrëdhënien që kishte Adem Demaçi me z.
11 Thaçi, ju kujtohet?

12 PË. Po.

13 PY. A e keni ditur ju dhe në fakt ju keni marrë pjesë në
14 procesin e zëvendësimit të Azem Sylës me Sylejman Selimin; a e
15 keni ditur ju - më falni - a e keni ditur ju faktin, ditur ju
16 që Adem Demaçi ka kundërshtuar marrëveshjen e Rambujesë?

17 PË. Po.

18 PY. A e keni ditur se në një pikë të caktuar, z. Thaçi shkoi
19 me avion në Lubjanë që ta takonte Adem Demaçin që të merrte
20 pëlqimin e tij që të jepte pëlqimin për këtë marrëveshje në
21 Rambuje?

22 PË. Për shkuarjen në Lubjanë edhe atë nuk e di, me avion se
23 nuk kam qenë afër tij, ai ka qenë jashtë. Por e di që Adem
24 Demaçi ka qenë në atë kohë aty në Slloveni.

25 PY. Nuk e dini ju që z. Thaçi shkoi me avion për ta takuar?

1 PË. Jo, jo.

2 PY. Mirë atëherë, po vazhdoj. Tani të flasim për pyetjet e
3 Gjykatësit Mettraux. Së pari, të flasim për librin e z.
4 Krasniqi.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Dorëshkrimin. P01138 në faqen
6 SPOE00231430. Shkojmë më poshtë tek anglishtja, ju lutem.

7 PY. Këtu ju ka bërë disa -- domethënë Gjykatësi Mettraux ju
8 bëri disa pyetje për dorëshkrimin e pretenduar të z. Krasniqi
9 ku thotë, "Këto ishin anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm të
10 UÇK-së në nëntor të 1998-s".

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Shkojmë më poshtë, mbase te faqja
12 tjetër, në faqen tjetër. Këtu mund të shihni, për shembull, që
13 në qershor ka pasur inspektor i përgjithshëm, por ju më duket
14 se thatë që në atë kohë ky pozicion nuk ka ekzistuar, kështu?

15 PË. Saktë.

16 PY. Paragrafi poshtë emrave thotë kështu:

17 "Anëtarë në Drejtorinë Politike ishin Hashim Thaçi, Jakup
18 Krasniqi, Kadri Veseli dhe Xhavit Haliti dhe të tjerë. Dhe më
19 vonë caktohet Bardhyl Mahmuti për të trajtuar çështjet jashtë
20 Kosovës."

21 E shihni këtë?

22 PË. Po.

23 PY. A ka ekzistuar drejtoria politike e Shtabit të
24 Përgjithshëm të UÇK-së në qershor të '98-s me sa keni ju
25 dijeni?

1 PË. Unë e shpjegova mirë edhe më herët që as nuk ka qenë
2 inspektori gjeneral në atë kohë, as ka qenë drejtorja
3 politike. Edhe thotë kryeshefi i drejtorisë së pushtetit
4 civil. Edhe këto s'ka pas. Në qoftë se ka pasur unë nuk e kam
5 dit këtë. Atëherë paskan qenë pa dijeninë time.

6 PY. Dorëshkrimi ka një poshtëshënim, poshtëshënimi 17.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe shohim çfarë thotë këtu, ku
8 mbështetet ky propozim.

9 PY. Thotë që është deklaratë e Shtabit të Përgjithshëm të
10 UÇK-së numër 6. E shihni këtë poshtëshënim?

11 PË. Po, po e shoh.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani ta shohim deklaratën me numër
13 6. Deklaratën politike. Është prova materiale P221 [Sipas
14 përkthimit] - P291. Zmadhojmë pjesën majtas poshtë.

15 PY. Nuk do t'ju kërkoj ta lexoni të gjithë tekstin. Nëse doni
16 sigurisht që mund ta lexoni, z. Zyrapi. Po këtu thuhet që
17 është data 31 korrik 1998, poshtë majtas. Që thotë as e
18 qershorit nuk është. A shihni ndonjë gjë në këtë dokument ku
19 të diskutohet formimi i një drejtorie politike dhe anëtarësia
20 e saj, shihni gjë në këtë dokument?

21 PË. Jo.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Të flasim tani për librin e z.
23 Krasniqi. Kërkoj të shfaqet në ekran prova materiale P01277 në
24 ekran.

25 PY. Këtë jua tregoi Gjykatësi Mettraux.

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Vendosim në ekran materialin U015-
2 8835. Më lart ju lutem.

3 PY. Gjykatësi Mettraux jua tregoi këtë pjesë që thotë:

4 "Struktura e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së në këtë
5 kohë do të dukej kështu ..."

6 Dhe ju tha që kjo është e verës '98-s dhe ju thatë që kjo
7 strukturë nuk ka ekzistuar në verën e '98-s, saktë?

8 PË. Po, saktë.

9 PY. Këtu thotë: "Organizimi i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-
10 së në këtë kohë ..."

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Por duhet të shohim për cilën kohë
12 bëhet fjalë, për cilën kohë e ka pasur fjalën z. Krasniqi
13 këtu. Prandaj, shkojmë në krye - më falni - në fund.

14 PY. Fjalitë këtu thonë kështu:

15 "Vendime të rëndësishme për të krijuar sektorë të
16 ndryshme me për Shtabin e Përgjithshëm dhe Ushtrinë Çlirimtare
17 të Kosovës ishin marrë -- merreshin në Kleçkë, domethënë nga
18 Kleçka. CNN, BBC dhe kompani të tjera të informacionit kanë
19 njoftuar opinionin botëror për fillimin e legalizimit të
20 kuadrit udhëheqës të UÇKP-së [Sipas përkthimit]. Në Dragobil
21 janë mbajtur takime të rëndësishme diplomatike në selitë, në
22 selinë e KDOM-it amerikan që në këto kohë organizimi i Shtabit
23 të Përgjithshëm të UÇK-së po bëhej sipas organizimit të një
24 ushtrie të rregullt. Por gjithmonë duke u përshtatur me
25 rrethanat e luftës tonë, sigurisht."

1 Pastaj paragrafi tjetër është ky që thotë, ai që lexuam
2 ne:

3 "Organizimi i SHP-së së UÇK-së në këtë kohë do të dukej
4 kështu..."

5 KDOM-i amerikan, nëse ju kujtohet, ka ardhur në Kosovë
6 nga mesi i tetorit, apo jo?

7 PË. Po, po qartë është kur të lidhet me këtë kohë tash që po
8 është e shpjegum, kjo po, ka fillu prej nëntorit tutje të
9 formohen këto drejtori, por më herët nuk kanë qenë.

10 PY. Po, por unë po ju them kështu: A pajtoheni ju me mua që
11 ajo që thuhet në këtë paragraf ose propozohet në këtë paragraf
12 është për një periudhë, pra, diskutohet kjo periudhë kohore
13 pasi ka hyrë KDOM-i amerikan në Kosovë që i takon nga mesi i
14 tetorit '98-s apo jo?

15 PË. Po, saktë.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Kryegjykatës, unë po e
17 shoh orën, por unë kam edhe nja dhjetë minuta pyetje pas
18 pushimit.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sa do ju
20 pyesja në fakt t'i përfundonit tani, por dhjetë minuta është
21 pak si shumë. Në rregull do jua japim dhjetë minuta.

22 Dëshmitar, tani është orari i pushimit të drekës. Mos
23 harroni të mos flisni me askënd për dëshminë tuaj.

24 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

25 Z. ELLIS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, ne e kemi pak më

1 të qartë tani sa kohë na nevojitet. Do ju lutesha sikur ta
2 fillonim nesër pjesën tonë të pyetjeve.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po të shohim
4 si do shkojë. Ka një orë z. Emmerson, kanë çerek ore z.
5 Emmerson [Sipas përkthimit]. Unë do doja të fillonit sa po të
6 përfundojnë me ata. Gjatë natës mund të përgatisni pjesën
7 tjetër të pyetjeve, por e kemi kohën shumë të çmuar këtu.

8 Z. ELLIS: [Përkthim] Po edhe po filluam nesër në orën
9 09.00 ne në orën 11.00 do përfundojmë nesër.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po e mirë
11 është të ndjekim procesin që kemi bërë gjithmonë. Filloni sot
12 me pyetjet dhe vazhdoni nesër, por nuk do e mbyllim sot që
13 t'ju japim një kohë për t'u përgatitur.

14 [Mikrofoni çaktivizuar].

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Misetic, nuk e di a na
16 ndihmoni që ta kuptojmë ku po doni të dilni, çfarë qëndrimi
17 keni. A po thoni ju se përbërja e Shtabit të Përgjithshëm që
18 kemi ne tani në ekran është një pasqyrim i asaj që ka
19 ekzistuar nga mesi i tetorit '98 dhe përpara ristrukturimit më
20 12 nëntor të '98-s, që ta kem të qartë çfarë po përpiqeni të
21 thoni?

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Unë po them që ju e kishit gabim
23 kur thatë që kjo ka qenë për verën e '98-s. Por ne nuk
24 kundërshtojmë atë që ka thënë z. Krasniqi në librin e vet.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, ju po thoni që kjo

1 nuk pasqyron përbërjen e Shtabit të Përgjithshëm në asnjë
2 moment kohor?

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, thjesht doja të thoja që
4 sugjerimi që bëtë ju që unë e kundërshtova dhe ju më thatë ta
5 trajtoja te pjesa e pyetjeve të mia dhe pikërisht atë po bëj.
6 Unë po ju them që sa i takon të paktën klientit tonë dhe rolit
7 të tij keni qenë gabim. Dhe Prokuroria ka barrën e provës
8 sigurisht.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
10 Bëjmë pushim deri në 14.30.

11 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.04

12 --- Seanca rifillon në orën 14.30

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
14 silleni dëshmitarin në sallë.

15 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ndërkohë që
16 po sillet dëshmitari në sallë, do trajtoj çështjen
17 organizative.

18 Kur po kërkoja pranimin në provë të një dokumenti, kam dhënë
19 dokumentin e gabuar si referencë. Lidhet me provën P01449. Unë
20 lexova dokumentin me numër ERN-je që përfundon me 9449, për
21 procesverbal, ndërkohë që faqja që i kemi treguar dëshmitarit
22 dhe që u komentua është faqja që përfundon me 9451. Kërkesa
23 ime ka të bëjë me faktin që dokumenti në faqen SPOE00209451 të
24 shtohet në numrin e provës dhe faqja 9449 të hiqet prej
25 provës.

1 [Dëshmitari vijon dëshminë]

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
3 kundërshtim?

4 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Kryegjykatës, na lejoni
5 kohë që t'i hedhim një sy deri në pushimin e radhës dhe pastaj
6 do ju themi në qoftë se jemi dakord apo jo. Deri në 15.30.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Zyrapi, do
8 të kemi një tjetër raund me pyetje nga Avokatët.

9 Domethënë, z. Misetic do vazhdojë me pyetjet.

10 Z. MISETIC: [Përkthim]

11 PY. Z. Zyrapi, besoj që do ju bëhet qejfi që dëgjoni që është
12 hera e fundit që ju bëj pyetje, shpresojmë. Tani do ndryshojmë
13 temë. Do kalojmë tek një pyetje që ju bëri Gjykatësi Barthe
14 dje, që kishte të bënte me rastin e z. Desku dhe z. Kastrati.

15 I thatë dje Gjykatësit Barthe që këtë rast ju e keni
16 ngritur në një takim pas lirimit të tyre. A ju kujtohet kjo
17 pjesë e dëshmisë tuaj?

18 PË. Po, më kujtohet që pas lirimit të tyre kam marr vesh që
19 kanë qenun, dhe është diskutu pak, po jo me u ngrit si
20 çështje.

21 PY. Në rregull. Gjykatësi Barthe ju informoi, dhe kjo jepet
22 në faqen e transkriptit 18375, që ata janë liruar më 27 nëntor
23 të vitit 1998. A të kujtohet kjo, Dëshmitar?

24 PË. Po.

25 PY. Më herët në kundërpjetje, ju thatë që z. Thaçi nuk ka

1 qenë në Kosovë, ose se ju nuk e keni parë z. Thaçi në Kosovë
2 deri nga mesi -- nga mesi i nëntorit deri diku nga marsi i
3 1999. A ju kujtohet kjo?

4 PË. Po, më kujtohet.

5 PY. A është e drejtë atëherë që në këtë takim ku është
6 diskutuar rasti i z. Desku dhe z. Kastrati, përderisa duhet të
7 ketë qenë më datë 27 nëntor ose pas datës 27 nëntor, që z.
8 Thaçi të mos ketë qenë i pranishëm në atë takim?

9 PË. Në -- po, s'ka qenë.

10 PY. Në rregull. Tani do kaloj tek pyetjet e Gjykatësit
11 Mettraux.

12 Ju janë bërë disa pyetje lidhur me komandantët me përvojë
13 dhe efektet e personave pa përvojë në komandë dhe se si kjo
14 mund të kishte ndikim mbi strukturën komanduese. Pyetja e parë
15 e imja lidhur me këtë temë ka të bëjë me çështjen e
16 koordinimit dhe komandës. A ju kujtohen këto pyetje të bëra
17 nga Gjykatësi Mettraux, Dëshmitar?

18 PË. Po.

19 PY. A është e saktë se -- ta formuloj ndryshe. Vetëm për
20 shkak të faktit që ju mund të koordinoni, ose mund të
21 bashkërendoni punën, kjo nuk do të thotë që të kesh kontroll
22 efektiv mbi personat që po koordinon, a është kështu?

23 PË. Po në aspektet ushtarake koordinimi është edhe një pjesë
24 e këtij kontrollit. Kur folim këto [E padëgjueshme]
25 operacionale, operacionet. Koordinimi mes sektorëve është

1 diçka tjetër. Koordinim në punë dhe veprimet, ajo është
2 koordinimi.
3 PY. Atëherë për të dhënë një shembull, do i kthehemi dhe një
4 herë rastit të frontit të Podujevës. Ju u përpoqët që të
5 koordinoni punën e zonës së Llapit edhe forcave tuaja atje.
6 Megjithatë, faktikisht, *de facto*, aftësia juaj për të
7 koordinuar atje mbështetej tek bashkëpunimi i komandantit Remi
8 me ty, domethënë, bashkëpunimi vullnetar i tij për të lejuar
9 koordinimin, në një farë mënyre. A është e saktë kjo?

10 PË. Po, është ajo pjesë, po.

11 PY. Ju kam pyetur disa herë për faktin në qoftë se ju dhe
12 Azem Sylja kemi pas mundësi, për shembull, që të arrestonit një
13 komandant zone në qoftë se ata nuk respektonin urdhrat tuaj.
14 Dhe ju më keni thënë që nuk e keni pas këtë kompetencë, ose
15 nuk është se ka qenë e mundur për juve për ta bërë këtë gjë.

16 A është e saktë atëherë, që në qoftë se ju do koordinonit
17 punën e komandantëve të zonave, këtë mund ta bënit vetëm në
18 qoftë se ata do të jepnin pëlqimin e tyre vullnetar? A është e
19 saktë kjo, Dëshmitar?

20 PË. Unë e kam cek atë që normalisht ku kemi pas mundësi që të
21 bëjmë, ndërrimin ose arrestimin e komandantit të zonës, se ka
22 pas një autoritet jashtëzakonisht të madh në atë zonë. Por,
23 sigurisht që në atë drejtim, po.

24 PY. Në qoftë se aftësitë koordinuese vareshin nga pëlqimi i
25 personave me të cilët ju do koordinonit, nga aspekti ushtarak

1 a pajtoheni me mua që i takon që ju nuk është se keni pas
2 kontroll real mbi ta?
3 PË. Po, saktë është. Kontroll real nuk ka qenë. Është, ka
4 qenë më së shumti në atë kohë ai me pëlqimin ose me pajtimin e
5 komandantit, kah mund të shkon, komandantit të zonës, mund të
6 zbatohet diçka.

7 PY. Ju bë pyetje, ose më konkretisht, Gjykatësi Mettraux ju
8 pyeti në qoftë se ka pasur persona me përvojë në Shtabin e
9 Përgjithshëm. Pyetja e parë që kam për juve është kjo. Tani e
10 kemi parë disa herë provën 1D66, që është marrëveshja midis
11 FARK-ut dhe UÇK-së. Në shtojcën e nënshkruar më 2 nëntor, Agim
12 Çeku mendohej që të ishte komandanti i ri i përgjithshëm i
13 UÇK-së. A është e saktë kjo?

14 PË. Po, saktë.

15 PY. Agim Çeku ishte oficer i ish-armatës jugosllave dhe ka
16 qenë gjithashtu edhe oficer në armatën kroate në kohën që
17 është nënshkruar kjo. A është e saktë kjo?

18 PË. Po, saktë.

19 PY. A e kam kuptuar saktë unë që t'i jepje atij titullin e
20 komandantit të përgjithshëm synimi ishte që ai të zëvendësonte
21 Azem Sylën, a është kështu?

22 PË. Po, saktë.

23 PY. Sa i takon rastit konkret të z. Çeku, a është e saktë se
24 arsyeja e vetme se pse nuk e mori këtë rol, ishte që ai ishte
25 oficer në detyrë në ushtrinë kroate dhe nuk kishte marrë leje

1 nga ushtria kroate në mënyrë të tillë që ta diskutonte këtë

2 çështje me UÇK-në? A është e saktë kjo, Dëshmitar?

3 PË. Saktë. E kam spjegu edhe gjatë pyetjes kur kam spjegu

4 ardhjen e tij që ka ardh vonë. Për arsye se ka qenë epror

5 ushtarak aktiv edhe u dasht kohë që të demobilizohet prej asaj

6 ushtrie.

7 PY. Sa dini ju, a ka ndonjë lidhje politike Agim Çeku? Për

8 shembull, a ka ndonjë lidhje me LPK-në?

9 PË. Nuk e di. S'di a ka pas.

10 PY. Gjykatësi Mettraux ju bëri pyetjen e mëposhtme, do t'jua

11 lexoj. Gjendet në faqen 15 të transkriptit të ditës së sotme,

12 rreshti 13. Gjykatësi Mettraux ju thotë kështu:

13 "Pyetja ime është kjo: Në qoftë se vendosni persona pa
14 përvojë ushtarake përgjegjës për organizatat ose strukturat
15 ushtarake, a ekziston rreziku që një strukturë e tillë të mos
16 funksionojë ashtu siç duhet?"

17 Përgjigja që ju jepni është kjo:

18 "Po, ekziston ky rrezik, por ne nuk kishim zgjidhje
19 tjetër. Na duhej që të bënim me çfarë kishim."

20 Ju lutem, na e shtjelloni pak më tepër këtë përgjigje.

21 Kur keni thënë që nuk kishim zgjidhje tjetër, dhe duhej që të

22 bënit me çfarë kishit në dispozicion, mund të na e thoni pak

23 më tepër këtë, na e shpjegoni?

24 PË. Në qoftë se keni përcjell prej kohës, prej fillimit, për

25 me spjegu strukturën qysh ka shku, qysh është zhvillu, është e

1 saktë. Kemi tentuar që edhe eprorët ushtarakë që t'i bijmë
2 aty. Edhe në shtab. Por nuk kemi arrit. Por me qëta që kanë
3 qenë, që janë vendosur më herët, që kanë qenë në këto pozita,
4 me këta kemi shku përpara, aq sa kanë ditë, ose kanë mujt,
5 kanë dhanë kontributin e vet për të udhëheq këto sektorë edhe
6 për të qenë në Shtabin e Përgjithshëm. Kjo ishte që e dhashë
7 unë si përgjigje.

8 PY. Në rregull. A do të thotë kjo se faktikisht ju nuk keni
9 pasur ish-oficerë të mjaftueshëm për t'i vendos në Shtabin e
10 Përgjithshëm?

11 PË. Po, saktë. S'kemi pas aq shumë.

12 PY. Në rregull. A është e saktë që ju e keni vendosur si
13 përparësi që personat ose oficerët me përvojë, në fakt, t'i
14 caktonit si pjesë e forcave të komandave në terren?

15 PË. Q'ato që kanë ardh, që kanë hy aty dhe që kemi pasun, ata
16 veç kanë qenë nëpër zona poshtë, edhe nëpër njësi më poshtë.
17 Është normalisht që duhet të forcohen këto njësi. Këto janë
18 bazë të udhëheqin një ushtri. Në qoftë se një epror ushtarak
19 është nën njësinë e brigadës që udhëheqin dhe zonës, është më
20 e lehtë edhe shtabi të vepron.

21 PY. Faleminderit. Tema e fundit lidhet me pyetjet që ju ka
22 bërë Gjykatësi Mettraux, duke filluar në faqen 42. Janë pyetje
23 të cilat kanë të bëjnë me urdhëresën e lëshuar prej jush në
24 nëntor 1998, që ka numrin e provës 1D0029. A ju kujtohet kjo
25 urdhëresa, Dëshmitar? Pra, urdhëresa që ka të bëjë me mënyrën

1 se si njerëzit duhet të trajtonin civilët e gjëra të tilla --

2 PË. Po.

3 PY. -- ju kujtohet?

4 PË. Po.

5 PY. Gjykatësi Mettraux ju bëri këtë pyetje. Së pari ai ju

6 pyeti:

7 " ... kush e ka pas si përgjegjësi që të sigurojë që kjo
8 urdhëresë e juaja zbatohet?"

9 Përgjigjja që ju jepni është:

10 " ... komandantët e zonave."

11 Pastaj ai vijon më tej:

12 "Kush e ka pas përgjegjësinë për të siguruar që
13 komandantët e zonave e respektonin ose e zbatonin urdhëresën
14 tuaj?"

15 Dhe ju përgjigjeni:

16 "Sigurisht që ka qenë përgjegjësi e shtabit që të kenë
17 nën kontroll zbatimin e tyre deri në masën e mundshme në atë
18 kohë, lidhur me atë se çfarë kishin dëgjuar për urdhrin."

19 Pyetje:

20 "Dhe kur thoni shtabi, e keni fjalën për Shtabin e
21 Përgjithshëm?"

22 Përgjigjja juaj është:

23 "Po."

24 A ju kujtohen këto pyetje dhe këto përgjigje, Dëshmitar?

25 PË. Po.

1 PY. Ju e keni lëshuar urdhëresën, jo Shtabi i Përgjithshëm, a
2 është e saktë kjo?

3 PË. Jo individ, por Shtabi i Përgjithshëm. Se ai ka qenë në
4 koordinim me komandantin e përgjithshëm.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit të
6 paraqiste në ekran, është prova 1D29.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mendoj, z. Misetic, është
8 gjithashtu edhe prova P884.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Në rregull. Të lutem, të kalojmë
10 në fund të faqes.

11 PY. Është nxjerrë nga ju, si shef i shtabit, a është e saktë
12 kjo, Dëshmitar?

13 PË. Po, saktë.

14 PY. E saktë. Ne e diskutuam në fakt që kur folëm për zbatimin
15 e kësaj urdhërese, në këtë kohë, a kam të drejtë, kam
16 përshtypjen që e keni thënë disa herë, megjithatë më
17 korrigjoni në qoftë se nuk e kam kuptuar siç duhet. Në vend që
18 të siguronit që komandantët e zonës të zbatonin këtë

19 urdhëresë, ju nuk është se kishit mundësi ose nuk është se
20 kishit të drejtë që të arrestonit komandantët e zonave, në
21 qoftë se ata nuk e zbatonin, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

22 PË. Po, e saktë është.

23 PY. Na tregoni pak, ju lutem, si ose me çfarë mjetesh, çfarë
24 mënyrash do kishit pasur në dispozicion për të siguruar që
25 komandantët e zonave do ta zbatonin këtë urdhër?

1 PË. Po si pikëpari me urdhëresën këtu që është dhënë, është
2 qenë që të binden ata që të merren masa disiplinore në kuadër
3 të zonave të tyre. Si pikëpari ka qenë edhe ankesa edhe
4 komandantët e zonave që kanë pas këto probleme në territoret e
5 veta, që është dashtë që të jipet edhe një urdhër i tillë. Në
6 veç në këtë mënyrë.

7 PY. Në rregull. Por po flasim këtu hipotetikisht. Le të
8 mendojmë për një çast që komandant Remi e merr këtë urdhëresën
9 tuaj, dhe thotë, "Z. Zyrapi, nuk më bëhet vonë fare për
10 urdhrin tuaj, dhe nuk do e zbatoj atë".

11 PË. Asgjë.

12 PY. Çfarë ndodh në këtë rast, çfarë instrumentesh, çfarë
13 mjetesh keni ju në dispozicion që ai ta zbatojë këtë urdhëresë
14 edhe në qoftë se nuk i shkon për shtat ose nuk i pëlqen?

15 PË. Asgjë s'kish mujt të marr.

16 PY. Faleminderit.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kam pyetje të tjera.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Emmerson,
19 fjala për ju.

20 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Emmerson:

21 Z. EMMERSON: [Përkthim]

22 PY. Kam pesë tema që dëshiroj të mbulojmë bashkë, z. Zyrapi.
23 Së pari, jeni përgjigjur disa pyetjeve të bëra nga Gjykatësi
24 Gaynor dhe Gjykatësi Barthe lidhur me procesin që ka ndodhur
25 nga fillimi i shtatorit të vitit 1998 dhe deri në fund të

1 tetorit 1998, duke çuar më tej në nënshkrimin e asaj çfarë
2 quhet ndryshe marrëveshja e UÇK-FARK-ut në Tiranë më 21 tetor.
3 Përfshirë këtu edhe pyetje të komunikimeve midis Tiranës dhe
4 Stambollit, për shembull, dhe midis Tiranës dhe Kosovës.

5 A mund t'ju pyes dhe një herë për të na sqaruar pak
6 datat? Së pari, më thatë në përgjigje të pyetjes së bërë më
7 datën 8 korrik, është në faqen -- do e them dhe një herë.
8 Është faqja 17795 e transkriptit. Ju më keni thënë që jeni
9 larguar nga Kosova dhe me këtë proces, ose ndërmjet proceseve
10 të tjera që të realizoheshin jashtë Kosove. Keni thënë që jeni
11 larguar nga Kosova në shtator, dhe keni thënë që dokumentin e
12 keni nënshkruar më datë 21 tetor.

13 Domethënë, a janë të sakta këto data që përmenda, apo jo,
14 Dëshmitar?

15 PË. 21 nëntor, dokumenti i nënshkrum? Jo.

16 PY. 31 tetor.

17 PË. 31 tetor është përfundim bisedimi. Si bisedim që është
18 përfundim në, që kemi pas mes të dy palëve, nënshkrimi është bërë
19 më vonë mbas një, dy ditëve, a, dy ditë a tri. Dy, e di. Ka
20 qenë 2 maj.

21 PY. 2 maj, e keni fjalën për 2 nëntor, apo?

22 PË. 2 nëntor, më fal. Gabimi im.

23 PY. Në rregull. Kjo na ndihmon, sepse dokumenti të cilin në
24 fakt e keni parë disa herë dhe nuk do kërkoj që të paraqitet
25 dhe një herë në ekran, sepse në këtë dokument përfshihen dy

1 data. Është data e 31 tetorit edhe data në të cilën është
2 arritur marrëveshja, që është diku 3 ose 2 nëntor. Përsëri në
3 një vend në Prishtinë, që është data e nënshkrimit. Dhe që ju
4 e shpjeguat në përgjigje të pyetjes së, Gjykatësit Barthe, që
5 të gjitha negociatat deri në përfundimin dhe nënshkrimin e
6 marrëveshjes, në fakt kanë ndodhur në Tiranë. Kjo është e
7 vërtetë, apo jo, Dëshmitar?

8 PË. Po, përfundimi i të gjitha që është bë, nënshkrimi e
9 gjithë janë në Tiranë.

10 PY. Në përgjigje të pyetjeve që ju bëra unë, dhe në fakt unë
11 ju pyeta lidhur me të njëjtën pjesë. Ju u kthyet në Kosovë në
12 fillim të nëntorit dhe jeni kthyer mbrapsht në Kosovë në mes
13 nëntorit. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

14 PË. Në mes të -- në mes të nëntorit.

15 PY. A mund të jemi pak më të saktë, më preciz për sa i takon
16 mesit të nëntorit, sepse nga dokumenti që kemi parë, dokumenti
17 që ju kam treguar në pyetjet e mia, ne pamë se procesi i
18 ristrukturimit domethënë data e parë e procesit të
19 ristrukturimit pas kthimit tuaj ka qenë më datë 12 nëntor,
20 çfarë i takon që juve duhet të jeni qenë i kthyer në Kosovë më
21 datë 12 nëntor, kështu?

22 PË. Më 10, po. Më 10, 11, me kanë, për shkak se kemi qëndruar
23 në fshatin Lubizhdë për shkak të rrethimit që na është bë nga
24 forcat serbe. Kemi qëlluar dy ditë të fshefun në pjesën e malit
25 për të arritur me u largu prej aty edhe mos me pas pasoja as

1 në njerëz e popullatë. Kështu që kur e marrim me e këqyrë, ky
2 i bie dikund kah i 11, kemi mbërri, kam mbërri, mbrenda. 10,
3 11, kam hy mbrenda.

4 PY. Keni hyrë në Kosovë së bashku me dokumentet e z. Veseli,
5 kështu?

6 PË. Kemi hy së bashku me z. Veseli.

7 PY. Dhe me dokumentet dhe me z. Veseli. Ne e dimë që më datë
8 11, sepse kemi parë në pasaportën e z. Veseli, pra, më 19
9 nëntor z. Veseli ka qenë jashtë Kosove sepse e pamë në
10 pasaportën e tij që ai ka fluturuar nga Tirana jashtë vendit.
11 E keni parë, besoj këtë, kur jua tregova në pasaportë, vulat?
12 Z. Veseli nuk ka qenë në Kosovë, domethënë?

13 PË. Po. Po, saktë është. Se kur kemi hy në atë, kemi ardh
14 bashkë, kemi hy bashkë në Kosovë, është spjegue, ka raportue
15 se çka kemi pas këto bisedime brendapërbrenda shtabit. Dhe
16 është kthye për Shqipëri. Tash datat saktë s'po mund i mbaj
17 mend, për afërsisht i di që këto janë datat kur kemi hy, pak a
18 shumë e di këto 10, 11 që mund të jetë, për shkak se kur jemi
19 rrethu na në fshat diku ka qenë 8 apo 9 nëntor. Tash llogariti
20 dy-tri ditë, dy ditë që kemi ndejt atje, sa po i bjen? Edhe
21 për afërsisht këto janë datat na kur kemi hy mbrenda, dhe kemi
22 fillu [E pakuptueshme] pastaj kemi fillu ristrukturimin e
23 Shtabit të Përgjithshëm.

24 PY. Unë kam gjithashtu të drejtë, apo jo, që në fillim të
25 shtatorit, kur jeni larguar me atë objektiv në mendje, jeni

1 larguar bashkë me z. Veseli, domethënë keni udhëtuar në
2 drejtim të Shqipërisë së bashku me z. Veseli, a kam të drejtë?
3 Domethënë, kur jeni larguar në fillim të shtatorit, keni qenë
4 bashkë me z. Veseli kur jeni larguar, kështu?
5 PË. Jo. Jo, nuk kam qenë bashkë me z. Veseli. Veçse unë u
6 nisa me [E pakuptueshme] kam përfunduar prej atij vendi me u nis
7 prej Shqipëri, kam udhëtuar. Me mu ka qenë Agim Kuqi, kanë qenë
8 dhe një pjesë e ushtarëve të, disa të plagosur. Edhe kemi dalë
9 për Shqipëri. Edhe, anëtarë të tjerë të shtabit nuk kam pas
10 afër.
11 PY. Shumë mirë. Por, jeni takuar me z. Veseli në Tiranë kur
12 mbërritët, besoj, apo jo?
13 PË. Pastaj, jo menjëherë. Se kur kam mbërri në Tiranë më
14 duket kam ndejt një ditë, dy, edhe menjëherë kam dal jashtë në
15 Perëndim dhe kur jam kthyer nga perëndimi faktikisht për të
16 filluar bisedimet me qeverinë Bukoshi, jam thirrur nga ana e
17 z. Veseli që të vij në Tiranë [E pakuptueshme] dhe të fillojmë
18 bisedimet. Kështu është. Kështu e kam spjeguar.
19 PY. Pra, kështu, pikërisht. Dhe kjo ishte pyetja ime tjetër,
20 domethënë juve ju bënë pyetje lidhur me thirrjet telefonike
21 ndërmjet jush dhe Azem Sylën ndërkohë që ju keni qenë në
22 Stamboll? Në fazën e Stambollit të diskutimeve, ose të
23 bisedave në qoftë se mund ta quaja kështu. Por ka pasur
24 gjithashtu komunikim përmes telefonit ndërmjet z. Veseli në
25 Tiranë dhe jush, kur ju keni qenë në vendet perëndimore për

1 punë të tjera. A ka qenë kështu, Dëshmitar?

2 PË. Po. Një telefonatë në -- për me -- u nisën me ardh në
3 Tiranë me ia fillu këtë bisedimet. Q'aq kam pas me të, s'kam
4 pas kontakte të tjera.

5 PY. Shumë mirë. Ndërkohë që keni qenë në Tiranë, as ju
6 domethënë, ti vetë, ose ta bëj ndryshe. I ke thënë Gjykatësve
7 që ti nuk ke qenë në komunikim me askënd brenda Kosovës, a
8 është e vërtetë kjo, Dëshmitar?

9 PË. Po, e saktë.

10 PY. Arsyeja për këtë mendoj që të paktën e nënkuptuar mbase
11 nuk është thënë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të shprehur,
12 por arsyeja për këtë ka qenë për arsye sigurie sepse bisedat
13 mund të përgjoheshin. Ka qenë kjo arsye?

14 PË. Po, është një ndër arsyet kryesore është siguria,
15 mospërgjimit, po plus kësaj edhe komunikimit, [E pakuptueshme]
16 për arsye se unë nuk kam pas nevojë të komunikoj brenda
17 njëherë për njëherë, për shkak se veç unë kjartë e kam
18 komandanti afër aty i përgjithshëm, në cilin e kemi pas kjartë
19 detyrën të bisedohet për, me palën, domethënë, të qeverisë së
20 përkohshme të Bukshit, Qeverisë në Ekzil të Bukshit, dhe ky
21 ishte detyra ime e orientuar në atë kohë.

22 PY. Juve iu bë pyetja në qoftë se z. Veseli ju përditësoi
23 lidhur me situatën në terren brenda Kosovës, ndërkohë që të dy
24 keni qenë në bisedime me qeverinë e Bukshit. Dhe përgjigjja
25 që dhatë juve ishte "jo".

1 A mund të ndihmoni, a jeni në gjendje të na ndihmosh dhe
2 do ta them konkretisht, që z. Veseli nuk ka qenë, nuk ka pasur
3 komunikime telefonike me Kosovën në të njëjtën mënyrë që edhe
4 ju nuk keni pasur komunikime përmes telefonit me Kosovën,
5 kryesisht për arsye sigurie, siç keni pas një ndër shqetësimet
6 dhe juve, siç e thatë?

7 PË. Po, saktë, është ashtu. Unë foli vetëm për periudhën kur
8 ka qenë afër meje dhe që në atë kohë as ai s'kemi fol me
9 pjesën e mbrendshme të, në Kosovë. Prej Stambollit kemi pas
10 kontakte me komandantin e përgjithshëm, Azem Sylën, e me të
11 tjerët jo. Dhe nuk është diskutuar.

12 PY. Por ju e dini, apo jo, që z. Veseli ka qenë në Tiranë,
13 nga fillimi. Domethënë, përveç udhëtimeve jashtë në perëndim,
14 ai nuk ka qenë në Kosovë nga fillimi i shtatorit deri në
15 fillim të këtyre bisedimeve, apo jo?

16 PË. E di që ka dal edhe ai, tash se cilën kohë a fillimi,
17 mes, e di që pas, unë përnjëherë kam dalë, pastaj me siguri
18 ai ka dalë mbasandej. E kur jemi taku jemi taku në tetor, tash
19 cila datë është, cilën kohë ka dalë, nuk e di.

20 PY. Sepse procesi që shohim pastaj në biseda që thatë ju, me
21 zgjedhjen përfundimtare të negociatave në qoftë se mund të
22 shprehem kështu, ishin kryer brenda Tiranës, përpara se sa të
23 mbërrinit ju. Domethënë, me fjalë të tjera, negociatat kishin
24 zgjatur për disa javë sepse ju thatë që negociatat ose
25 bisedimet filluan në fillim të shtatorit, apo jo?

1 PË. Po bisedimet -- më fal, bisedimet kanë fillu edhe më
2 herët, kanë pas shumë bisedime tash edhe unë kur kam mbërri
3 aty veç kanë qenë në proces. Kanë qenë, edhe [E pakuptueshme]
4 të cilat, të precizohet dhe disa bisedime që është dasht të
5 bohen në atë kohë, dhe pastaj edhe përfundimi i bisedimeve që
6 është nënshkru me një marrëveshje.

7 PY. Sërish, që të jemi të qartë për këtë, sepse z. Veseli ka
8 qenë, z. Veseli ka qenë në procesin e negociatave dhe më pas
9 ju mori ju në telefon dhe ju tha, shiko kemi arritur në një
10 pikë të negociatave ku është e nevojshme të jesh këtu dhe të
11 marrësh pjesë, a ka ndodhur kështu?

12 PË. Po.

13 PY. Tani, flas, folëm këtu për vulën e nëntorit, megjithatë
14 ka dhe një vulë të 10 shtatorit që tregon se z. Veseli ka qenë
15 në Shqipëri dhe po largohet. Nuk thotë se ku po shkonte, por
16 po largohet. Tani ndonëse ju nuk e mbani mend datën e saktë,
17 ai ka mbërritur në Tiranë ose para, i takon para datës 10, si
18 rregull. Para 10 shtatorit. E pranoni këtë?

19 PË. Mund të --

20 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Nuk mund t'i përgjigjet
21 dëshmitari kësaj pyetjeje.

22 Z. EMMERSON: [Përkthim] Mirë.

23 PY. Atëherë, po ju bëj pyetjen ndryshe. Keni arsye për ta
24 kundërshtuar propozimin që sapo bëra unë?

25 PË. Jo, se s'e di. Sepse ai në qoftë se e ka pasaportën edhe

- 1 e ka vulën, s'mund të jem kundër asaj.
- 2 PY. Tani do kaloj tek tema e dytë. Kjo është diskutuar edhe
3 me Gjykatësin Barthe, dhe më duket se bëri disa pyetje të
4 mëtutjeshme z. Misetiç për këtë temë. Kjo ka lidhje me rastin,
5 me ngjarjet kur komandantët e zonës ose ndërmerrnin veprime
6 ushtarake në kundërshtim me udhëzimet që u ishin dhënë, ose
7 ndërmerrnin veprime ushtarake pa marrë pëlqimin paraprakisht.
8 Patët një diskutim lidhur me, konkretisht me incidentin me
9 komandant Remin. Por pati dhe disa shembuj të tjerë. Dhe ju
10 përdorët terma të ndryshëm për të përshkruar natyrën e
11 marrëdhënieve që kishit ju si shef shtabi me komandantët e
12 zonave në rastet kur ata nuk bënë atë që ju kërkonit ose
13 bënë diçka që ju nuk donit që ata ta bënin. Ju kujtohet kjo
14 linjë pyetjesh?
- 15 PË. Kenë pyetje të shumta, por tash -- [Folës që flasin
16 njëkohësisht] -- pak ma mirë se --
- 17 PY. Ke të drejtë. Por po përpiqesha të të jepja kontekstin më
18 shumë se çfarë pyetjesh do ju bëja. Ju përdorët shprehjen
19 këshilla, thatë edhe urdhra, thatë që dhe komandanti i zonës
20 kishte të drejtë të merrte edhe vetë vendime, dhe se ju mund
21 t'ju bënit kërkesa edhe në rast kur ata nuk e respektonin
22 kërkesat tuaja, ju nuk mund të bënit asgjë. Ata kishin liri
23 zgjedhje nëse mund të themi kështu, e vërtetë?
- 24 PË. Po, po. Ashtu është.
- 25 PY. Tani, jo me -- realisht, në realitet, kush i takon të

1 jetë vartësi epror, pra, më falni, atëherë si i bie të jetë
2 këtu marrëdhënia epror-vartës, kur një vartës nuk i bindet
3 urdhrave. Sepse ne e dimë që teorikisht komandanti i zonës
4 është vartës i shefit të shtabit, por praktikisht ka qenë e
5 kundërta, apo jo?

6 PË. Së pari, komandanti nuk është vartësi i shefit të
7 shtabit, por i komandantit të përgjithshëm, në këtë strukturë
8 edhe në këtë formë që te na. E dyta, çka i përket kësaj duhet
9 të kemi parasysh, nuk jemi tu fol për një ushtri klasike, një
10 ushtri profesionale. Jemi tu fol për një ushtri e cila ka dalë
11 nga populli, jemi tu fol për do komandanta që e kanë marrë
12 autoritetin, që e kanë pas qysh para se të hyjnë dhe të
13 strukturohej këtë ushtri, që e kanë pas ma tepër autoritetin
14 se ne shtabi, dhe normalisht nuk mund të bisedohesh as të
15 marrësh ndonjë masë ndaj tyre kur ata kanë autoritetin në atë
16 zonë dhe në ato njësi. Kjo me e thanë shkurt në këtë drejtimin
17 pse s'kemi mujtur, se pse është bërë [E pakuptueshme].

18 Është dash me pas shumë kujdesin me ta se ka mujt të
19 kthehet edhe kundra dhe të kemi shumë probleme mes veti.

20 PY. Siç ua tha dhe Gjykatësi Barthe, ose ju pyeti, a ishte
21 problem kur komandantët e zonave nuk zbatonin urdhrat tuaj. Ju
22 thatë po, ishte problem.

23 Megjithatë ju thatë gjithashtu se ky ka qenë një problem
24 përgjatë gjithë luftës, a është kështu?

25 PË. Po, sigurisht.

1 PY. Pra, nuk ka qenë një problem vetëm në 1998 ky, ka qenë
2 një problem nga fillimi deri në fund, apo jo?

3 PË. Po çdo herë kemi pas kujdes edhe këto probleme.

4 PY. Kemi dëgjuar dëshminë se komandant Drini i refuzonte
5 urdhrat, për shembull, ka refuzuar një urdhër nga Shtabi i
6 Përgjithshëm që të mos hynte në Prizren më 12 qershor të 1999,
7 që ka qenë rreth ditët, kanë qenë ditët e fundit të luftimit.
8 Dhe komandant Drini vendosi të hynte në Prizren me një grup
9 ushtarësh në kundërshtim me direktivën që ishte dhënë. A mund
10 të na tregoni diçka në lidhje me këtë?

11 PË. Së pari, nuk kam qenë brenda unë për atë me e ditun. E
12 dyta, këtu është urdhër ka pasur, nuk di prej kujt ka pas
13 urdhër. Kur dihet që [E pakuptueshme] gjatë përgatitjes së
14 operacionit Shigjeta kanë të ndamë detyrat për të gjithë si
15 ata për jashtë ashtu dhe mbrenda. Kështu që detyrën komandant
16 Drini e ka pas që të është në bjeshkën e Kabashit me njësitë e
17 Kabashit dhe Brigadës 125 të drejtohet në drejtim të
18 Prizrenit. Në atë kohë kur njësitë nga jashtë, operacioni që u
19 zhvillojke nga pjesa e Pashtrikut e hyn në drejtim të
20 Prizrenit. Domethënë të bashkohet në atë drejtim.

21 Kështu e ka pas një detyrë shumë të kjartë për me hy në,
22 me shku në drejtim të Prizrenit. Por nuk e di që a ka pas
23 ndonjë urdhër tjetër nga komandanti ose në atë kohë, shefi i
24 shtabit, nuk jam në dijeni me thanë po ose jo. Po unë e di
25 çfarë detyra ka pasur para se u ndal në, jashtë në, operacioni

1 Shigjeta.

2 PY. Besoj se thatë pak më herët se keni dëgjuar [REDAKTUAR]

3 [REDAKTUAR]

4 Mbase do të kalojmë pak në fakt në seancë private. Po jeni
5 njohur me dëshminë e Burim, e këtij personi?

6 Z. EMMERSON: [Përkthim] Një çast, ju lutem, sa të
7 konsultohem.

8 [Përfaqësuesit e Mbrojtjes këshillohen]

9 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ju lutem të kalojmë në seancë
10 private për këtë pyetje që do të kem tani, shkurtimisht.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë në
12 seancë private, ju lutem.

13 [Seancë private]

14 [Seancë private teksti i fshirë]

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë e hapur]

2 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni, z.
4 Emmerson.

5 Z. EMMERSON: [Përkthim]

6 PY. Kur po bënte pyetje Gjykatësi Mettraux, ai iu tregoi një
7 fragment të dorëshkrimit të përgatitur, ose që thuhet se është
8 gjetur në shtëpinë e Jakup Krasniqit, dhe që pretendohet se
9 është përgatitur prej tij. Si dhe ju tregoi dhe një
10 procesverbal të një takimi të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-
11 së më 23 korrik. A ju kujtohet që thatë më përpara se nuk keni
12 marrë pjesë në këtë takim se ishit të angazhuar me luftimet në
13 këtë periudhë?

14 Ju kujtohet kjo linjë pyetjesh dhe përgjigjesh?

15 PË. Po, më kujtohet.

16 PY. Dhe ju bënë këtë parashtim, bazuar në tekstin dhe
17 poshtëshënimin në dorëshkrimin e z. Krasniqi, Gjykatësi
18 Mettraux ju bëri këtë pyetje:

19 "A e dinit ju që në korrik të 1998-s, në dorëshkrim
20 thuhet se më 23 u krijua rregullorja e përkohshme për
21 nënrepartet informative në luftë. A e dinit këtë?"

22 Dhe ju u përgjigjët se nuk e dinit diçka të tillë.

23 Tani desha t'ju pyes nëse e keni parë ndonjëherë këtë
24 rregullore, dhe të na ndihmonit të sqarojmë diçka.

25 Z. EMMERSON: [Përkthim] Së pari, do kërkoja të dilte

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bislam Zyrapi (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Emmerson

Faqe 128

1 ballina e dokumentit. Ka numrin 086960 deri 086972-ET. Me sa
2 shoh, edhe shqipja -- jo, shqipja ka numër tjetër. Jo, ka të
3 njëjtin numër.

4 PY. Do t'ju bëj pyetje për këtë dhe për disa gjëra të tjera.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Emmerson, mënyra se si
6 e bëtë ju pyetjen ishte kështu:

7 "Desha t'ju pyes, a i keni parë ndonjëherë këto
8 rregullore?"

9 Këtë deshët të thonit?

10 Z. EMMERSON: [Përkthim] Jo, do ta pyes për këtë që do të
11 shohim në ekran. Nuk e kemi parë akoma në ekran rregulloren.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Sepse nga mënyra si e bëtë
13 pyetjen ju, u kuptua sikur ju e pyetët atë a i kishte lexuar
14 ndonjëherë këto rregullore?

15 Z. EMMERSON: [Përkthim] Jo, unë në fakt e kisha fjalën që
16 të shihnim këto në tekst, në ekran, më fal.

17 PY. I keni parë ndonjëherë këto rregullore më pas, Dëshmitar?

18 PË. Jo, jo.

19 PY. A mund të na ndihmoni të sqarojmë disa nga aspektet që
20 ngrihen në këtë dokument? Kemi dy përkthime të ndryshme --

21 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Kundërshtoj. Nuk lidhet me
22 pyetjet e Gjykatësve.

23 Z. EMMERSON: [Përkthim] Si mund të jetë, si mund të mos
24 ketë lidhjet me pyetjet e Gjykatësve?

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po dëshmitari

1 tha që nuk e ka parë ndonjëherë këtë dokument.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Unë thjesht e pyeta a e
3 dinte ai që ishin miratuar këto rregullore.

4 Z. EMMERSON: [Përkthim] Unë dua që të eksploroj nëse
5 vërtet këto janë rregullore për zbulimin dhe vrojtimin. Dua të
6 di a është përkthimi i saktë, përkthim me shkrim i saktë këtu.
7 Sepse nëse e shikojmë përmbajtjen këtu nuk përmenden fare
8 kolaboracionistët. Është për njësitë e vrojtimit.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të bëni
10 disa pyetje të shkurtra për këtë, por dëshmitari ka thënë që
11 s'e ka parë ndonjëherë më përpara këtë dokument.

12 Z. EMMERSON: [Përkthim] Mirë atëherë. Po e bëj pyetjen
13 kështu.

14 PY. Dëshmitar, gjatë kohës që keni qenë ju në Kosovë, i
15 angazhuar në veprimtari luftarake, a e dini ju se ka pasur
16 disa udhëzime në qarkullim që përshkruanin veprimtaritë e
17 zbulimit në fushëbetejë? Me fjalë të tjera, se si duhet të
18 bënin veprimtari vrojtimi ushtarët gjatë veprimtarive
19 luftarake.

20 PË. Së pari është, terminologjia e vrojtimit është krejt
21 tjetër, kurse zbulimi është tjetër. Në këtë aspekt, rregullore
22 që përcakton nuk kam pa. Por për zbulimin në luftime njësitë
23 vëzhguese janë të cilat veprojnë ato, vëzhgojnë edhe bëjnë
24 vëzhgimin e terrenit, armikut, të gjitha. Vrojtimin e bëjnë
25 çdo ushtar që vrojton në vijën e frontit dhe vrojton pjesën

1 para vetit të frontit. Kjo është të kemi, të kjartë kjo çka
2 është zbulim e çka është vrojtim. Por e dyta, unë nuk e kam pa
3 këtë edhe nuk kam pa rregullore që ka, në atë kohë që ka pas.
4 Ndoshta është shkruar por unë s'kam pa.

5 PY. Atëherë, do ju bëj pyetjen kështu. Dua të shohim dhe
6 faqen që përshkruan detyrat.

7 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Kundërshtoj dhe fushëveprimin dhe
8 themelësinë.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet
10 kundërshtimi.

11 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ky është një dokument vrojtimi,
12 për vrojtimin. Nuk është për zbulim. Këtë dua të tregoj unë.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E pranoj
14 kundërshtimin e Prokurores. Je shumë larg pyetjeve të
15 Gjykatësve. Dëshmitari tha as e ka parë këtë dokument, as nuk
16 e njeh këtë dokument. Dhe nuk mendoj se dëshmitari duhet t'i
17 përgjigjet një pyetjeje të tillë.

18 Z. EMMERSON: [Përkthim] Mirë. Do shohim disa rregullore
19 të tjera që dëshmitari i ka parë dhe për të cilat ka dhënë
20 dëshmi.

21 Shohim rregulloren për veprimtarinë e brendshme të -- më
22 falni, "Rregullorja për organizimin e jetës së brendshme të
23 një ushtrie". Ka numrin P8. Ju lutem të vendosni dokumentin në
24 ekran.

25 PY. Z. Zyrapi, ju keni dhënë dëshmi si në çështjen

1 Milutinovic dhe gjykimin Haradinaj, dhe keni thënë -- po lexoj
2 transkriptin në çështjen Haradinaj:

3 "Kjo ka qenë një dokument i përkohshëm për organizimin e
4 jetës së brendshme të ushtrisë, po, është përpiluar nga fundi
5 i 1998 dhe më pas ju është dërguar njësisë në terren."

6 E keni thënë këtë edhe në gjykimin Milutinovic, të
7 njëjtën gjë, dhe pra, dhe te Milutinovic dhe te Haradinaj, në
8 faqen 3378 të transkript.

9 Milutinovic ka qenë 4959 e transkriptit. Këto, kjo është
10 pjesë e pyetjeve që ju bëri Gjykatësi Gaynor lidhur me
11 policinë ushtarake dhe rolin që kishte policia ushtarake. Ju
12 bëri disa pyetje Gjykatësi Gaynor lidhur me këtë.

13 A mund të na ndihmoni, dhe të na thoni nëse keni qenë ju
14 i përfshirë në përpilimin e këtij dokumenti?

15 PË. Së pikë të parit, ky dokument i përkohshëm domethënë që
16 është përpilue në fund të 1998, në fillimin e strukturimit të
17 shtabit dhe ushtrisë. Edhe është marrë përkthimi nga ushtritë
18 Perëndimore dhe është përkthye. Disa kam marrë pjesë unë, disa
19 ka marrë pjesë për prej jashti. Disa i kanë dërgue të
20 përkthyme nga Agim Çeku, disa i kemi përkthi vetë. Kështu që
21 përpunuar ky, ky rregullore.

22 PY. Të jemi të qartë, këto që po lexojmë në këtë rregullore,
23 nëse kam kuptuar unë siç duhet, nuk janë aspak një përshkrim i
24 asaj që po ndodhte atje, por është një kopje që është marrë
25 nga rregulloret e ushtrive të tjera se si duhet të

1 funksiononte, apo jo?

2 PË. Unë e kam spjegu dhe një herë që disa herë po e shpjegoj.
3 Këto janë rregullore që janë përshkruar dhe kanë përshkrimin e
4 detyrës dhe përgjegjësisive që i kanë këto shtabi në atë kohë
5 dhe drejtoritë. Edhe janë bazike. Nuk janë të gjitha për arsye
6 se për të qenë të gjitha në qoftë se e marrim një rregullore
7 vetëm për një drejtor dhe e bëjmë, u duhet të bëhen sigurisht
8 me thanë jo 100 faqe, por më duhet të bëhen edhe tri, katër
9 rregullore të ndryshme. Se është rregullorja që përcakton
10 detyrat, rregullore që përcakton përgjegjësitë, rregullore që
11 përcakton pozicionet, në pozicione çfarë detyra ka çdo zyrtar
12 brenda deri te ai që them thjesht punon deri te një
13 fotokopjues. Kështu që kur të marrim dalin shumë dokumente
14 aty, por ne nuk kemi pas kohë të merremi shumë me dokumente të
15 tilla.

16 PY. Kuptova. Por të fokusohemi këtu. Nëse këto ishin të
17 kopjuara nga ushtritë perëndimore, nuk ka se si të kenë qenë
18 një përshkrim i praktikave ekzistuese, një përshkrim i asaj që
19 vërtet po ndodhte në kohën që u hartuan. Por kanë qenë një
20 model i asaj që duhet të ndodhte në të ardhmen, apo jo?

21 PË. Po, unë shumë kjartë [E pakuptueshme] atë. Se e kemi
22 marrë nga ushtritë perëndimore, e kemi përkthyer dhe kemi fillu
23 të shtijmë në funksion. Dhe normalisht ky është për zhvillimin
24 prej ristrukturimit kur kemi fillu në nëntor e tutje.

25 Normalisht që nuk ka qenë domethënë saktë aty, por

1 përafërsisht kemi shku në këto që shkon në këtë drejtim të
2 zhvillohet.

3 PY. Po. Po këto rregullore a u materializuan ndonjëherë gjatë
4 konfliktit, a u jetësuan ndonjëherë realisht?

5 PË. Kjo rregullore kur është përpilue, është dhanë në, ka pas
6 Shtabi i Përgjithshëm, kanë pas drejtoritë, që kanë marrë në
7 funksion. Kemi bart, edhe te zonat atje, po sa ka mujt me hy
8 në funksion shpejt edhe ato, kjo varet. Zakonisht i kemi dhënë
9 që të përdoren.

10 PY. Po, pyetjen e kisha më shumë -- nuk po them a u shpërnda.
11 Po ju po thoni, po thoni ju tani që këto rregullore u zbatuan
12 në terren?

13 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po u përgjigj.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, u
15 përgjigj. Tha që është përdorur.

16 Z. EMMERSON: [Përkthim] Mirë, shohim disa hollësi
17 atëherë.

18 PË. Kreu V thotë "Marrëdhënia mes ushtarëve".

19 Z. EMMERSON: [Përkthim] Tek anglishtja është faqja 5,
20 edhe shqipja është faqja 5.

21 PY. Shohim vetëm një shembull pse po e them unë këtë, që nuk
22 mund të jetë e vërtetë.

23 Z. EMMERSON: [Përkthim] 5, 5, faqja pararendëse për të
24 dyja. 4 dhe 5, jo 6 dhe 7.

25 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Po kjo që shohim në

1 anglisht është Kreu IV?

2 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po shoh numrin e faqeve në fund,
3 në fund të ekranit. Kreun V, Kreu V. Kjo është VI. Mirë, më
4 jepni pak një çast sa të gjej referencën e duhur.

5 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faqja 5 në anglisht dhe
6 faqja 5 në shqip.

7 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po.

8 PY. Kreu V i rregullores, që e ka titullin, ka dhe, kalon dhe
9 në faqen 6, por nuk është nevoja të shohim në faqen 6, thotë
10 "Komandantët dhe vartësit, oficerët dhe jo-oficerët", ç'është
11 ky oficer -- çfarë është eprori dhe nëneprori, kush është
12 dallimi, nëse mund të na e shpjegoni? Meqë keni përvojë
13 ushtarake.

14 PË. Oficerët janë pjesë komanduese, që kanë kry akademitë
15 ushtarake, dhe janë nga nëntogeri tek ma lart. Nënoficerët
16 janë rreshterët e në vijim.

17 PY. E keni pasur ju një dallim të tillë brenda UÇK-së?

18 PË. Jo, se s'kemi pas grada fare.

19 PY. Pra, është marrë kopja fiks nga një tekst i një ushtrie
20 perëndimore, apo jo?

21 PË. Po, teksti është marrë është përkthi. Kjo është tentu për
22 të shkuar në atë drejtim.

23 PY. Ama s'ka se si të jetë zbatuar ndonjëherë kjo në terren.

24 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Kundërshtoj, është pyetur dhe ka
25 marrë përgjigje.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.

2 Vazhdoni.

3 Z. EMMERSON: [Përkthim]

4 PY. Pra, s'ka se si të jetë zbatuar në terren sepse ky tekst
5 ka elementë që mund të funksionojnë në një ushtri
6 konvencionale, por ama nuk mund të funksiononte në Ushtrinë
7 Çlirimtare të Kosovës.

8 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Kundërshtoj, është tendencioze.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përsëriteni,
10 Dëshmitar.

11 Z. EMMERSON: [Përkthim]

12 PY. Keni nevojë ta përsërisim pyetjen?

13 PË. Jo, s'keni nevojë ta përsërisësh, shumë mirë, domethënë.
14 Sa i përket kësaj është e vërtetë që ne kemi tentu në ato dhe
15 nuk mund të jetë, ne grada s'kemi pas. Dhe grada s'kanë qenë,
16 por veprimet janë të njëjta dhe pa grada. Se si duhet të
17 zëvendësohet këtu, komandanti është i drejtpërdrejtë dhe jo i
18 drejtpërdrejtë ndaj vartësve të tij. Komandanti i njësisë së
19 kompanisë e të tjera. Ato kanë ekzistue si pozicione, jo si
20 grada. Dhe a ka mujt të zbatohet plotësisht ato a jo në [E
21 pakuptueshme] e kanë dëgjue, tash është tjetër send. Është
22 pjesa e, disiplinore.

23 PY. Do ta them dhe ndryshe. Nuk është nevoja të shohim
24 shembuj të tjerë, por këtu për shembull përmendet në tekst
25 mbikëqyrësi i kuzhinës, ofrimi i shërbimit të mensës. Këto

1 s'kishin lidhje fare me realitetin tuaj, apo jo?

2 PË. Nuk, në qoftë se e marrin në aspektin klasik, kjo është
3 q'ashtu. Në, nuk po, mensa, kuzhinat kanë pas, janë në mënyrë
4 ma të thjeshtë kanë qenë edhe te njësitë. Tash a është
5 përdorur vetëm tek civilë që e kanë nëpër dhomë nëpër shtëpi,
6 po edhe ajo është një pjesë kuzhine që bohet. Dhe vendi se ku
7 duhet hëngur është përcaktu dhe kanë mbikëqyrur eprorët.
8 Kështu që nuk është në aspektin klasike që ti ki objektet e
9 infrastrukturën i ke pas, edhe i ke bo të gjitha ato. Ne jemi
10 kanë ushtri në zhvillim. Kështu që të gjitha këto elementë
11 jemi mundur t'i punojmë aty me ato kushte që ekzistojnë. Se
12 kuzhina kryesore për ne ka qenë popullata e Kosovë.

13 PY. Duhet t'ju pyes shkurtimisht për diçka, dokumenti tjetër
14 që keni parë që ka një natyrë të ngjashme, P83.

15 Z. EMMERSON: [Përkthim] Nuk është nevoja ta vendosim në
16 ekran.

17 PY. E kishte emrin "Rregullorja e Brendshme e Shtabit të
18 Përgjithshëm", titullin, më falni, jo emrin. Dhe ju bëri
19 Gjykatësi Gaynor disa pyetje në lidhje me këtë, veçanërisht
20 për rolin që kishte drejtoria informative dhe ndihmën që u
21 jepte njësive vartëse dhe monitorimin e veprimtarive
22 luftarake.

23 Pyetja ime për ju është sërish kjo: A keni marrë pjesë ju
24 në përgatitjen e kësaj rregullore, pra "Rregullorja e
25 Brendshme e Shtabit të Përgjithshëm"?

1 PË. Po, por në qoftë se përshkrimi i detyrave dhe
2 përgjegjësive të drejtorive, po.

3 PY. Sërish, edhe kjo rregullore është kopjuar nga ushtritë
4 perëndimore apo u bë apostafat, e përshtatur me rrethanat e
5 Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së?

6 PË. Unë shumë i kjartë kam qenë. Çdosend që kemi bo, çdo
7 ristrukturim kemi përkthi nga ushtritë perëndimore dhe kemi
8 përshtatur për kushtet tona. Ka përdor ato ç'ka është, [E
9 pakuptueshme] përdor te na.

10 PY. Pra, në përgjithësi, ajo çfarë po shikojmë këtu dy
11 dokumente, a pranoni që këto janë thjesht plane ose aspirata
12 për zhvillime të mëvonshme?

13 PË. Po të gjitha këto, të gjitha këto janë bo për zhvillimet
14 e në të ardhmen. Folim prej kohës kur janë këto përkthi ose
15 ristrukturu Shtabi i Përgjithshëm edhe ushtria.

16 PY. Sigurisht në atë kohë askush nga ju nuk e dinte që lufta
17 do të futej në një fazë të re më datë 24 mars 1999, me
18 përfshirjen e NATO-s? A nuk është kështu, Dëshmitar?

19 PË. Është shumë e kjartë ne nuk kemi dit kur do përfundohet
20 lufta. Na kemi punue çdo herë që të shkojmë të ndërtojmë një
21 ushtri të mirëfilltë që del zot kryes së detyrës së vet. Tash,
22 ka mujt me ndodh edhe mbas një muaji mbas e kemi shkru,
23 ristrukturu, të ndodhë kjo. Kam bo edhe ka ndodh, si shifet
24 ajo ka ndodh mbas katër, pesë muajve, ne nuk kemi mujt ta
25 parashohim këtë se kur do të përfundojë lufta. Ne kemi, por,

1 ushtaraku punon gjithnjë përgatit ato pa marrë parasysh se kur
2 parashifet ose kur mund të ndodhë të ndalet lufta ose veprimi
3 operacional. Ai duhet të punon edhe të përgatisë çdo herë
4 zhvillimin e saj. Edhe kjo ushtri është shku në atë drejtim që
5 të zhvillohet. Por nuk e kemi dit këtu kur të përfundon.
6 PY. Faleminderit. Tema e fundit që dëshiroj të trajtojme
7 bashkë, nuk di se si t'jua përshkruaj tamam, por është pyetja
8 që kishte të bënte me këtë muze, me çështjen e muzeut që u
9 tregua nga Gjykatësi Mettraux. Një dokument që pretendohet që
10 të jetë shkruar nga z. Selimi që quhet "Ruga drejt formimit
11 dhe organizimit të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së".

12 Mendoj që është në listën e dokumenteve tani.

13 Z. EMMERSON: [Përkthim] Dhe në mos gabohem është
14 dokumenti SPOE00226856 deri në 6857. I njëjti numër është edhe
15 në versionin në anglisht, por përfundon me ET në fund. Ju
16 lutem, paraqiteni dokumentin në ekran dhe të kalojmë tek faqja
17 e dytë e tij. Edhe fillimin e faqes së dytë nëse mundeni.

18 PY. Ju nuk e dini se kur është shkruar ky dokument, apo jo,
19 Dëshmitar?

20 PË. Jo.

21 PY. Por e dini se çfarë përmban dokumenti, se e kemi përpara,
22 domethënë thotë:

23 "Në maj të vitit 1998, Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së
24 formon të gjitha drejtoritë përbërëse të shtabit, ku edhe merr
25 formën complete të tij që nga struktura komanduese. Dhe pastaj

1 vazhdon me detalet përbërëse të organizimit të shtabit.”

2 Këtu më vonë jepet një listë drejtorish, duke përfshirë
3 dhe me drejtorinë e shërbimit informativ që përcaktohet si G2.

4 Do t'ju bëj disa pyetje. Tani, së pari, nomenklatura e
5 G1, G2 e kështu me radhë është marrë nga NATO-ja, apo jo,
6 Dëshmitar?

7 PË. Po, saktë.

8 PY. Kjo nuk është bërë pjesë e formulimit ose gjuhës që
9 përdorte UÇK-ja deri në mars, domethënë me fjalë të tjera,
10 përdorimi i G1, G2, G3 e të tjerë e të tjerë nuk ka qenë në
11 përdorim në maj të 1998, apo jo? Janë përdorur më vonë, apo
12 jo, Dëshmitar?

13 PË. Po, saktë.

14 PY. Megjithatë, ajo çfarë është më e rëndësishme z. Zyrapi,
15 ju dhe z. Veseli jeni futur më datë 28 në Kosovë, pra të atij
16 muaji, më 28 maj, dhe kjo ka qenë situata apo jo? Por kur jeni
17 futur juve më 28 maj të vitit 1998, a është e imagjinueshme që
18 këto departamente të logjistikës dhe drejtori të tjera,
19 domethënë, të kenë ekzistuar në nivelin e Shtabit të
20 Përgjithshëm që në maj të 1998?

21 PË. Unë e kam spjegu edhe atëherë edhe e thashë edhe ma
22 herët. Nuk kam pa drejtori të tjera që kanë qenë të zhvilluara
23 dhe që kjo strukturë që ka qenë në maj. Po të ishte kjo do të
24 kisha ditur dhe do kisha koordinuar me këto. Por nuk kanë
25 qenë.

1 PY. Në përgjigje të një prej pyetjeve të bëra nga Gjykatësi
2 Mettraux, lidhur me librin e z. Krasniqi thatë që çdo libër që
3 keni lexuar për sa i takon luftës së UÇK-së, pra librave që
4 janë shkruar nga persona lidhur me luftën e UÇK-së, të gjitha
5 këto kanë qenë ekzagjerime ose zmadhime të gjendjes faktike, a
6 është e saktë kjo, Dëshmitar?

7 PË. Po, e saktë. E kam thanë, edhe ashtu është.

8 PY. Gjykatësi Mettraux ju tha se mund të sugjeroni që Rexhep
9 Selimi dhe Jakup Krasniqi do ta kenë gabim në atë çfarë ju
10 kujtohet atyre, sipas jush. Por, a mund të pranojmë që ka një
11 tjetër shpjegim, një shpjegim që ka të bëjë me faktin që unë e
12 thashë dhe më përpara, që pavarësisht nga fakti se kush e ka
13 shkruar një libër apo një tjetër, përgjithësisht lufta e UÇK-
14 së është ekzagjeruar dhe roli i tyre që sa i takon çfarë kanë
15 bërë ata në luftë për të gjitha arsyet e mundshme, përfshirë
16 këtu edhe arsye politike, ose qëllime të tjera, është i
17 zmadhuar, është i zgjeruar në përgjithësi, Dëshmitar?

18 PË. Unë jam tu foli për ato çka po lexoj, edhe që e kam mujt
19 me e parë. Kur të, leximi ose shkrimi i librit dhe realiteti
20 nuk përputhen. Po ju them pa marrë parasysh kush e ka shkru
21 këto, a e ka shkru Jakup Krasniqi apo ka shkru Rexhep Selimi,
22 apo Bislime Zyrapi. Po nuk është ajo në përputhje me
23 realitetin. Unë e foli realitetin ato që e kam gjetun në atë
24 kohë, prej majit 1998, e deri në fund.

25 Jo veç këto, por dhe disa libra, meqenëse këtë libër nuk

1 e kam lexu, po dhe disa libra të tjera që kam mujt me i pa
2 njëjtë kanë bo ekzagjerime të shkresave që kanë bo në libra.
3 Tash për përfitimet a janë të tyre ditore politike apo çka,
4 është çështje e tyre. Por realiteti nuk është përcaktu, nuk
5 është tregu.

6 PY. Për pasojë do të pajtoheshit me mua që ekziston një
7 mundësi e madhe që persona në pozicionet përkatëse mund ta
8 kenë përfaqësuar gabim, por nga ana tjetër, por mund të jetë
9 absolutisht edhe e mundur që ta kenë ekzagjeruar, t'i kenë
10 ekzagjeruar historitë e luftës, përfshirë këtu edhe pak
11 mitbërje në qoftë se do shprehesha kështu?

12 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] E kundërshtoj pyetjen.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

14 Z. EMMERSON: [Përkthim] Përfundova.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Roberts,
16 pyetjet nga ju?

17 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk kam pyetje. Faleminderit.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

19 Alagendra, do ta merrni fjalën tani?

20 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Do bëjmë pushim prej dhjetë
21 minutash?

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni nevojë
23 të bëjmë pushim, keni nevojë të bëni pushim, Dëshmitar?

24 DËSHMITARI: Mund të vazhdojmë, s'është problem.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

1 Pyetje vijuese të palës tjetër nga znj.

2 Alagendra:

3 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim]

4 PY. Mirëdita, z. Zyrapi.

5 PË. Mirëdita.

6 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit të
7 paraqesë në ekran provën P901. A mund të shkojmë në faqen 6965
8 [Sipas përkthimit]. Edhe tek faqja tjetër. Faleminderit.

9 PY. Gjykatësi Barthe, duke filluar në faqen 18369, ju bëri
10 disa pyetje lidhur me këtë dokument. A ju kujtohet kjo,
11 Dëshmitar?

12 PË. Po.

13 PY. A pajtoheni me mua se ky është një dokument i cili nuk ka
14 datë në të?

15 PË. Po, qëky dokument, po q'ashtu është.

16 PY. Më 10 korrik, në faqen e transkriptit 17946, u pyetët
17 lidhur me këtë nga z. Roberts, dhe ju thatë që:

18 "Ka ndodhur në vitin 1999, dhe në qoftë se e mbaj mend
19 saktë, ka ndodhur në mars të 1999 ..."

20 A ju kujtohet kjo, Dëshmitar?

21 PË. Po, saktë. Q'ashtu kam thanë.

22 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Të kalojmë tek faqja 6965.
23 Faqja tjetër.

24 PY. A e shihni, z. Zyrapi, se kjo duket sikur është një
25 kërkesë që mban datën 17 shkurt 1999. E shihni këtë?

1 PË. Po.

2 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Në qoftë se do kalojmë tek
3 faqja 6969. Ju kërkoj ndjesë, është faqja tjetër. Shkojmë në
4 fund të faqes te versioni në shqip.

5 PY. Shohim që ka një datë ky dokument, apo jo? Që është 11
6 shkurt 1999. Është e saktë kjo, Dëshmitar?

7 PË. Po. Ky dokument tjetër, po.

8 PY. A është e mundur, z. Zyrapi, që kur keni thënë mars i
9 1999, mund të ketë qenë nga mesi i shkurtit të 1999? Duke u
10 mbështetur tek dy dokumentet që ju tregova. Ky dokument edhe
11 faqen përpara. A është e mundur që të ketë qenë mesi i
12 shkurtit?

13 PË. Së pikë të parit, shumë mirë e di kur ka qenë edhe kur i
14 kam dhanë përgjigjen avokatit, që ka qenë mars. Se është bo
15 pyetja a ka pas kësi rasti. Unë kam thanë, po ka pas një rast
16 të tillë. Dhe e kam spjeguar që ka qenë Rexhep Selimi që e ka
17 përdorur këtë njësit në mars të 1999. Nuk kam thanë ma herët.

18 PY. Në rregull. Në transkript thuhet që:

19 "Ka ndodhur në 1999. Në qoftë se e mbaj mend mirë ka qenë
20 në mars ..."

21 Dhe prandaj thjesht doja ta sqaroja me juve se keni thënë
22 "në qoftë se më kujtohet mirë, ka qenë diku nga marsi".

23 Kam një pyetje plotësuese që lidhet me pyetjen e bërë nga
24 Gjykatësi Barthe në faqen 18732 [Sipas përkthimit]. Ju thoni:

25 "Urdhri erdhi nga komanda. Inspektori i përgjithshëm pasi

1 merr informacionin sa i takon udhëzimeve të tilla, mbështetur
2 në udhëzimet e marra nga komandanti ose nga
3 zëvendëskomandanti.”

4 A ju kujtohet ta keni thënë këtë gjë?

5 PË. Po, saktë.

6 PY. Nëse, në qoftë se e keni të saktë, udhëzimet në qoftë se
7 kanë ardhur në mars të 1999, në pajtim me atë çfarë na keni
8 thënë më herët, i takon që Jakup Krasniqi nuk ka qenë më
9 zëvendëskomandant për mbështetjen në atë kohë, sepse ai kishte
10 dhënë dorëheqjen dhe pas kësaj periudhe ka qenë në Shqipëri. A
11 i takon të jetë e saktë kjo, Dëshmitar?

12 PË. Mendoni, pjesëmarrësit, po?

13 PY. Po.

14 PË. Po, pjesëmarrësit, q'ashtu është, saktë.

15 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Do i lutesha Sekretarit të
16 paraqiste në ekran provën materiale P633.

17 PY. Në faqen 18333, rreshti 9 i transkriptit, ju thoni:

18 “Periudha e kohës kur ka ndodhur kjo, komandanti i
19 përgjithshëm ka qenë jashtë vendi, zëvendësi i tij ka qenë
20 brenda vendi, dhe ne filluam procesin që të zëvendësonim
21 komandantin e përgjithshëm siç mund të shikohet në takime të
22 mëvonshme me komandantët e zonave.”

23 A ju kujtohet kjo, Dëshmitar?

24 PË. Më kujtohet, por nuk kam thënë që ne filluam të
25 zëvendësojmë, por zëvendësuan komandantët e zonave. Ne

1 takimin, shumë mirë e kam spjegue, se qysh ka ndodh.

2 PY. Po lexoj nga transkripti, z. Zyrapi. Përgjigjet tuaja
3 mjaftojnë të jepen me "po" ose "jo". Në qoftë se do më
4 nevojitet një shpjegim prej jush, mund t'jua bëj pyetjen vetë
5 që të më jepni shpjegime të tjera.

6 Tani, data që përmban ky dokument, ose që ka ky dokument,
7 është 12 shkurt 1999. A është e saktë kjo?

8 PË. Po, kjo është 2 shkurt 1999.

9 PY. 12 shkurt. A mund të na e thoni dhe një herë datën?

10 PË. 12 shkurt 1999. 12 të dytit, 1999. Ma saktë.

11 PY. Faleminderit. Në atë kohë Azem Sylja, Jakup Krasniqi dhe
12 pjesa tjetër e delegacionit ishin në Rambuje, apo jo,
13 Dëshmitar?

14 PË. Më 12 të dytit, jo, Jakup Krasniqi e di që ka qenë
15 mbrenda. Q'atë kohë ka ndodh edhe ndryshimi i komandantit të
16 përgjithshëm.

17 PY. Megjithatë unë do ju them, z. Zyrapi, që më 12 shkurt
18 1999 z. Krasniqi nuk ka qenë në Kosovë. Dhe gjithashtu, po ju
19 them që kur keni thënë që komandanti i përgjithshëm ka qenë
20 jashtë vendit, dhe zëvendësi i vet ka qenë brenda vendit, e
21 keni pas fjalën për Sokol Bashotën. A pajtoheni me mua lidhur
22 me këtë, po apo jo?

23 PË. Kur kam fol, tash ju dolët në shkurt, kur folëm për
24 marsin, për marsin që kam dhanë atë deklaratën që po, ashtu ka
25 kanë. Por komandanti i përgjithshëm ka qenë, në mars ka qenë

1 z. Sylejman Selimi. Ky dokument nuk ka të bën më fare me atë
2 punë. Ky dokument ka tjetër --
3 PY. Mendoj që nuk më kuptove mirë, më keqkuptove, Dëshmitar.
4 Mendoj se më keqkuptove. Unë e kisha fjalën për provën P633.
5 Ti më the që dokumenti mban datën 12 shkurt. Qartazi po flasim
6 për shkurtin për periudhën e shkurtit. Më ndjek, apo jo, z.
7 Zyrapi?

8 PË. Unë po ju ndjek shumë mirë, po që ky dokument çka ka të
9 boj me pyetjet që e bënë? Ky dokument ka të bëjë me diçka
10 krejt tjetër, ky dokument është që unë kam refuzuar që të
11 nënshkruhet.

12 PY. Po, dhe unë vazhdova me diçka, me diçka tjetër. Dhe këtu
13 jeni për t'iu përgjigjur pyetjeve të mia jo për të më pyetur
14 mua.

15 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Toni, i nderuar Gjykatës. Kujdes
16 tonin.

17 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim]

18 PY. Gjykatësi Barthe vazhdoi më tej në faqen 18333 për të
19 pyetur lidhur me zëvendësimin e komandantit Drini. A ju
20 kujtohet kjo, Dëshmitar?

21 PË. Po, saktë.

22 PY. Ju thatë që:

23 "Nuk më kujtohet procedura ekzakte që është ndjekur nga
24 komisioni i personelit. Ata kanë dhënë propozimin e tyre për
25 komandantin e përgjithshëm dhe komandanti i cili e mori këtë

1 vendim për zëvendësimin në atë kohë ka qenë Sylejman Selimi,
2 komandanti i përgjithshëm. Ai ka qenë personi që e ka marrë
3 këtë vendim ...”

4 A ju kujtohet ta keni thënë dje këtë, Dëshmitar?

5 PË. Po, saktë. Ashtu është.

6 PY. Në Pjesën 10 të intervistës së 2019, në faqen 18, keni
7 konfirmuar se ka qenë një ditë ose dy ditë përpara 14 marsit
8 të 1999 që komandant Drini u zëvendësua nga Tahir Sinani si
9 komandant zone. A pajtoheni me këtë, Dëshmitar?

10 PË. Po, saktë. Ashtu [E pakuptueshme].

11 PY. Edhe Tahir Sinani është emëruar nga Sylejman Selimi që në
12 atë kohë ka qenë komandanti i përgjithshëm, a është e saktë
13 kjo?

14 PË. Po, e saktë.

15 PY. Zëvendësimi i komandant Drinit ka ndodhur pasi Jakup
16 Krasniqi kishte dhënë dorëheqjen si zëvendës komandant për
17 mbështetjen, a është e saktë kjo?

18 PË. Po, po. Se ka shku në Rambuje atje në, normalisht nuk ka
19 qenë më këtu.

20 PY. Më 15 korrik --

21 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Do duhet të kalojmë në seancë
22 private, të nderuar Gjykatës, lidhur me këtë pyetje.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Le të kalojmë
24 në seancë private.

25 [Seancë private]

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8 [Seancë e hapur]

9 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
10 jemi në seancë publike.

11 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Faleminderit.

12 PY. Gjatë javëve që keni dhënë dëshmi përpara Trupit Gjykses,
13 ju nuk iu është treguar asnjë raport nga komisioni i
14 personelit, a nuk është kështu z. Zyrapi?

15 PË. Po, saktë.

16 PY. Mbështetur në dëshminë tuaj sot dhe më herët, drejtorja e
17 personelit është krijuar në nëntor të 1998. A është e saktë
18 kjo?

19 PË. Po, e saktë.

20 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Do i lutesha Sekretarit të
21 paraqesë në ekran provën P1414.

22 PY. Këtë dokument jua tregoi Gjykatësi Barthe. Jepet në faqen
23 18328 të transkriptit të datës 16 korrik. Gjykatës Barthe ju
24 pyeti konkretisht në faqen 18329, se si i keni marrë ankesat
25 nga anëtarët e UÇK-së sa i takon maskave. Dhe ju thoni që:

1 "Kryesisht ka ndodhur gjatë vizitave të mia në zona, por
2 gjithashtu edhe në takimet me komandantët."

3 A ju kujtohet kjo, z. Zyrapi?

4 PË. Po.

5 PY. Si shef i drejtorisë operative keni konfirmuar se ju
6 ishit personi që keni dërguar në zona të ndryshme për të
7 ndihmuar me organizimin në verën e 1998, a është e saktë kjo,
8 z. Zyrapi?

9 PË. Po.

10 PY. Keni dëgjuar ankesa nga komandantët e zonave, apo jo?

11 PË. Po, nga komandantët e zonave, nga civilët, nga, nga
12 ushtarët.

13 PY. Dëshmia juaj është se keni marrë masa për disa nga
14 ankesat që keni marrë prej tyre, në konsultim me komandantin e
15 përgjithshëm dhe lëshuat në vijim urdhrin e 28 nëntorit 1998,
16 saktë?

17 PË. Po, saktë.

18 PY. Ky urdhër ama nuk trajtonte çështjen e maskave, apo jo?

19 PË. Urdhri i mëhershëm, po mendojshe, apo ky?

20 PY. Urdhri i 28 nëntorit 1998.

21 PË. Po, saktë.

22 PY. Gjykatësi Mettraux ju pyeti sot, kush e kishte për
23 përgjegjësi të sigurohej se komandantët e zonave e zbatonin
24 urdhrin? Ju kujtohet kjo pyetje?

25 PË. Po.

1 PY. Dhe ju u përgjigjët kështu:

2 "Sigurisht që ishte përgjegjësi e Shtabit të Përgjithshëm

3 ..."

4 Kështu thatë?

5 PË. Po.

6 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] A mund të kalojmë në seancë

7 private, ju lutem?

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë në

9 seancë private.

10 [Seancë private]

11 [Seancë private teksti i fshirë]

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18 [Seancë e hapur]

19 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
20 jemi në seancë publike.

21 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim]

22 PY. Atëherë, z. Zyrapi, unë po ju them këtë. Drini nuk do
23 t'ju kishte kërkuar ju një urdhër nëse nuk do ju kishte
24 konsideruar ju si autoritet, pikë së pari, për faktin se ju
25 mund ta lëshonit një urdhër, dhe së dyti, sepse ai e dinte që

1 urdhrat tuaj do të zbatoheshin si shef shtabi i cili kryesonte
2 të gjitha çështjet operative. A pajtoheni me parashtrimin tim?
3 PË. Jo. Ajo është, e bën një kërkesë me thënë a ka ditur, ne
4 e kemi pas tjetër send që ne jemi njoftur dhe më herët, dhe
5 jemi eprorë ushtarakë, dhe i dimë procedurat e respektuara si
6 shkojnë. Ai e ka kërkuar këtë një mundësi të tillë, por kjo
7 nuk e ka realizuar. Dhe përmes, duhet t'i dallojmë autoritetin
8 edhe profesionalizmin. Na është e vërtetë që kam pasun, jam
9 kanë profesionist, por s'kam pas autoritetin. Autoritetin kanë
10 pas ata të cilët autoriteti i tyre është zhvillu prej fillimit
11 të formimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës deri në fund.

12 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Tani të shohim në ekran
13 dokumentin që mban numrin P1414.

14 PY. Z. Zyrapi, a pajtoheni me mua që në janar të 1999-s u bë
15 e domosdoshme të lëshohet një urdher i mëtutjeshëm për maskat?
16 Pajtoheni?

17 PË. Po. Unë e kam spjeguar atë dhe si dhe pse është lëshu.

18 PY. Për këtë kërkuan zonat?

19 PË. Po, se ankesat më të madhe kanë qenë të zonat.

20 PY. Dhe ju ia kishit komunikuar këtë Shtabit të Përgjithshëm,
21 apo jo?

22 PË. Ankesa nuk ka shku veç në drejtim tim, me u anku te unë,
23 por u janë anku edhe të tjerëve. Edhe të tjerë anëtarë. Për
24 atë është pru ky vendim. Edhe e ka edhe me shkrim kur është
25 mbajt takimet me komandantët.

1 PY. Dhe qëllimi i këtij urdhri ishte parandalimi i sjelljeve
2 negative, të shprehem kështu.

3 PË. Saktë. Kjo është një masë parandaluese të cilën duhet të
4 ndaleshin këto dukuritë negative.

5 PY. Në fund të transkriptit provizor -- besoj se faqja 18329
6 e transkriptit të ditës së djeshme. Ju bëri pyetje Gjykatësi
7 Barthe:

8 "... me sa keni ju dijeni, a u zbatua dhe a u respektua
9 ky urdhër?"

10 Ju u përgjigjët:

11 "U dërgua në të gjitha zonat, nuk e di deri në ç'skallë
12 u zbatua. Ne kemi nxjerrë shumë urdhra, por jo të gjithë këta
13 urdhra janë zbatuar tërësisht nga komandantët e zonave."

14 A ju kujtohet ta keni thënë diçka të tillë?

15 PË. Po, saktë.

16 PY. Tani shohim dokumentin që kemi përballë, z. Zyrapi. Nëse
17 shohim pikën 2, shohim pikën 2 ku thuhet, për zbatimin e kësaj
18 urdhërese, përgjegjës është komanda e zonës operative, kështu?

19 PË. Po, saktë.

20 PY. Kur thatë dje që nuk e dini deri në ç'skallë është
21 zbatuar ky urdhër, atëherë a pajtoheni ju me mua që nëse ju si
22 shef shtabi nuk e dini a ishte zbatuar apo jo ky urdhër,
23 atëherë s'kishte se si ta dinte pjesa tjetër e Shtabit të
24 Përgjithshëm?

25 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Kjo nuk një pyetje që mund t'i

1 përgjigjet dëshmitari.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet
3 kundërshtimi.

4 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Dëshmitari po pohonte me kokë,
5 besoj se kishte mundësi t'i përgjigjej pyetjes.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet
7 kundërshtimi.

8 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim]

9 PY. Gjykatës Barthe ju pyeti në faqen 18329 të transkriptit,
10 ju tha:

11 "Po pse ishte problem që njerëzit apo ushtarët të mbanin
12 maska?"

13 Ju kujtohet kjo pyetje, z. Zyrapi?

14 PË. Po. Po, më kujtohet.

15 PY. Dhe ju u përgjigjët kështu, thatë:

16 "Ishte problem se nuk identifikoheshin dot ata që mbanin
17 maska. Dhe mund të vepronin ndonjëherë në zona kur nuk duhej
18 të vepronin, dhe nuk kishin autoritet për t'u marrë me civilët
19 apo të merrnin materiale apo nuk duhet të ndalonin persona.
20 Pra problemi ishte që nuk mund të identifikonim personat që i
21 kryenin këto veprime, dhe këta ishin ushtarë që nuk i
22 përkisnin zonave në fjalë."

23 Pra, kjo ka qenë dëshmia juaj, apo jo?

24 PË. Po, saktë.

25 PY. Në atë kohë ka qenë problem se kishte persona që

1 pretendonin të ishin të UÇK-së dhe mbanin maska e kryenin
2 veprime të paautorizuar. Për shembull merreshin me civilët,
3 ndalonin persona, dhe ju pikërisht për këtë keni marrë ankesa
4 nga zonat, edhe për shkak të ankesave që morët nga zonat, ju
5 nxorët vendimin e 28 nëntorit 1998, apo jo?

6 PË. Po.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

8 Alagendra, po i bëni pyetje a pajtohet me atë që ka thënë më
9 përpara. Ju s'po bëni pyetje.

10 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Unë thjesht po përgatis, po
11 jap kontekstin fillimisht dhe pastaj të bëj pyetjen.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po pra. E
13 dëgjoi, u përgjigj, e konfirmoi. Ju s'po bëni pyetje.

14 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim]

15 PY. Shtabi i Përgjithshëm nuk pajtohej me këto sjellje dhe
16 kjo ishte një përpjekje për t'i parandaluar sjelljet e tilla,
17 apo jo?

18 PË. Po, saktë.

19 PY. Shtabi i Përgjithshëm nuk donte që UÇK-ja të
20 portretizohej si një organizatë terroriste, apo jo?

21 PË. Sigurisht po.

22 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Shohim në ekran provën P623.

23 PY. [Mikrofoni çaktivizuar].

24 Z. Zyrapi, a ju kujtohet që jua tregoi Gjykatësi Mettraux
25 këtë dokument dje?

1 PË. Po.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Sot, znj. Alagendra.

3 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Sot, ju kërkoj ndjesë.

4 PY. Kjo është një urdhëresë për caktimin e kufijve të zonave
5 operative. Shohim faqen 45 të transkriptit provizor, dhe ju
6 treguan dhe disa procesverbale të disa takimeve që ishin
7 mbajtur lidhur me këtë çështje. A ju kujtohet kjo?

8 PË. Po.

9 PY. A ju kujtohet që për të njëjtën gjë ju ka pyetur dhe
10 Prokuroria gjatë intervistës së 2019?

11 PË. Më fal, për çka më ka pyt?

12 PY. A ju kujtohet që ju ka bërë pyetje për këtë dokument, për
13 të njëjtin dokument ju ka bërë dhe pyetje Prokuroria në 2019?

14 PË. Jo, më fal, në 2019 këtë dokument s'e kam pa. E kam pa
15 gjatë fazës përgatitore.

16 PY. Më falni, faji im. Jo dokumentin, por për të njëjtën
17 temë. Për të njëjtën temë që diskutohet në dokument, ju ka
18 bërë pyetje Prokuroria në 2019.

19 PË. Po, pyetje po.

20 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Tani shohim Pjesën 14, faqja
21 16 e intervistës në ekran. Shqipja është faqja 14 dhe 15.
22 Shqipja fillon në rreshtin 24.

23 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] A mund ta sqaroni për
24 cilin dokument e keni fjalën?

25 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, faji im.

1 Është dokumenti që mban numrin 083280.

2 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Është me numër P01355.14.

3 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Pra, Pjesa 14, faqja 16 tek
4 anglishtja. Dhe faqet 14 dhe 15 të shqipes. Tek faqja 14,
5 fillojmë me rreshtin 24. Tek faqja 14, ju lutem. Nxorët Pjesën
6 4. Shqipja, ju lutem, faqja 14, rreshti 24. Fillon aty.

7 PY. Ju është bërë pyetje lidhur me këtë temë, pra për
8 vendosjen e një këshilli për caktimin e kufijve mes zonave
9 operative, dhe ju jeni përgjigjur kështu:

10 "Ekzistonte drejtoria operative dhe oficerët e drejtorisë
11 operative me mua në krye. Ne përgatitëm hartat, mu në krye
12 kemi hartue hartën ose ndarjen e zonave operative me harta
13 simbas terrenit të zonave operative."

14 Kështu? Ju kujtohet kjo pjesë që e keni thënë në 2019?

15 PË. Po.

16 PY. Më pas, thoni që janë mbajtur disa takime për këtë
17 çështje, dhe keni thënë:

18 "Kam filluar ta diskutoj këtë me njerëzit e mi në nëntor
19 e në dhjetor."

20 E shihni?

21 "Kemi fillue ta bisedoj këtë çështje me ata që kam pas në
22 nëntor, në dhjetor."

23 PË. Po.

24 PY. Kur thoni "me ata që kam pas" e kishit fjalën me stafin,
25 a me personelin e drejtorisë operative?

1 PË. Po, me personelin e drejtorisë operative, që kam pas në
2 kuadër të drejtorisë operative.

3 PY. Pajtoheni me mua, z. Zyrapi, që kjo detyrë në fakt ka
4 qenë pjesë e kompetencave të drejtorisë operative, saktë?

5 PË. Po, e saktë është.

6 PY. Ju shkuat në zona, vrojtuat terrenin edhe diskutuat me
7 komandantët e zonave lidhur me këtë çështje, apo jo?

8 PË. Jo. Këto përpara kemi bërë në kuadër të drejtorisë për
9 arsye se unë i kam njoft terrenin komplet, i kam dit të gjitha
10 zonat ku janë, dhe nga aspekti ushtarak edhe aspekti operativ
11 i terrenit i kam ndajt përgjegjësitë e zonave, faktikisht,
12 kufijte e zonave. Edhe pas kësaj që është përfunduar, atëherë
13 është përcaktuar edhe një komision për problemet të cilat duhet.
14 Ne normalisht i kam pas edhe me komandantat, bashkë bisedimet
15 me to. Biles me komandantin kemi shku edhe nëpërmes dy zonave
16 ku kanë pas, domethënë, ndarje aty e atyre dy zonave si pjesë
17 e kufijve të përgjegjësive. Pasi është përfunduar edhe komisioni
18 që është formuar i tillë, kam spjeguar, kjo është tjetër. Ky
19 është komision që ka shku për problemet që kanë pasun mes të
20 dy zonave, zonës së Nerodimës edhe zonës së Pashtrikut.

21 Dhe është shku, janë dërguar atje është shqyrtuar ajo
22 çështje, është rregulluar, dhe është prurë raporti.

23 Përgjegjësia, përgjegjësi është e drejtorisë operative
24 dhe e Shtabit të Përgjithshëm -- e shefit të shtabit.

25 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Shohim dokumentin e mëparshëm,

1 dokumenti me numër P623.

2 PY. Z. Zyrapi, pajtoheni me mua që në fund të faqes shohim
3 inicialet S.V/SH.A. A mund të na thoni kujt i përkasin këto
4 inicialet?

5 PË. Inicialet janë të, Sali Veseli, Shqipe Ahmeti.

6 PY. Sali Veseli është personi që ka përgatitur këtë dokument,
7 apo jo?

8 PË. Po, e ka përpiluar këtë dokument.

9 PY. Dhe ai është një nga personat që ishte caktuar për këtë
10 komision, sipas dokumentit, si pjesë e këtij komisioni, sipas
11 dokumentit, apo jo?

12 PË. Po.

13 PY. Që ta kuptoj qartë, kjo është çështje operative që po
14 diskutohet nga drejtoria operative, për muaj me radhë ishte
15 diskutuar kjo. Ju personalisht dhe kolegët në drejtorinë
16 operative e kishit diskutuar me zonat, e njihnit terrenin.
17 Zëvendësi juaj apo një ish-oficer përpilon këtë dokument, i
18 jep dhe një pozitë vetes në këtë komision, kështu?

19 PË. Ai nuk i ka dhënë pozitë vetes, por e kemi përcaktuar na.
20 Faktikisht, e kam përcaktuar unë. Edhe është përgatitur dokumenti,
21 për t'ia dhënë komandantit, faktikisht, zëvendëskomandantit me
22 nënshkruar, se unë nuk kam të drejtë t'i jap urdhër inspektorit
23 të përgjithshëm që të hyjë në komision ose të vepron. Atë e
24 jep veç komandanti ose zëvendëskomandanti. E për atë që bë ky
25 dokument edhe është dhënë zëvendëskomandantit me nënshkruar edhe

1 të formon këtë komisionin.

2 PY. Pra, ju po thoni që ia keni dhënë zëvendëskomandantit ta
3 nënshkruante?

4 PË. Po, është përpiluar nga drejtoria, për qëllimet për çka
5 është. Iu ka dhanë dhe e ka nënshkru. Dhe iu ka spjegu pse
6 është kjo.

7 PY. Dhe ai nuk kishte formim ushtarak për të bërë ndryshime
8 apo për të bërë komente, apo jo? Sepse vendimin e kishit marrë
9 ju brenda drejtorisë operative. A do ishte ky një përshkrim i
10 drejtë?

11 PË. Nuk është çështje thjesht e vendimit. Kjo është çështja e
12 përgatitjes në sajë të nevojës që është dhanë. Se vendimin e
13 jep komandanti. Normalisht ai s'ka pas përvojë ushtarake, por
14 është autoriteti.

15 PY. Më duket se në transkriptin e ditës së sotme -- faqja 47,
16 rreshti 22, pyetja është kjo: Jakup Krasniqi nuk të ka dhënë
17 ty ndonjë urdhër për të përzgjedhur personat të paktën lidhur
18 me këtë dokument, kështu?

19 PË. Normalisht ai e ka kërkuë kush do të është në këtë
20 dokument nëse, në këtë komision, por diçka tjetër kur kërkon
21 për t'i vendosur për të bërë këtë, se ajo shifet këtu kemi
22 edhe disa drejtori që u dasht të jenë, nuk ka emër. Se s'ka
23 pas. Kështu që është q'ashtu.

24 PY. Po thjesht kërkonte informacione që i kishit ju, z.

25 Zyrapi, apo jo?

1 PË. Po, sigurisht.

2 PY. Tani po i referohem transkriptit provizor, faqja 33,
3 rreshti 4 deri në 8. Ju bëri pyetje --

4 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Është transkripti i sotshëm,
5 pra.

6 PY. Gjykatësi Mettraux ju pyeti për rolin që kishte
7 zëvendëskomandanti i parë dhe i dytë. A ju kujtohet kjo?

8 PË. Po, saktë.

9 PY. Dhe ju thatë, e keni thënë në intervistën për ZPS-në
10 Pjesa 7, se zëvendësi i dytë në fakt ishte varës i
11 zëvendëskomandantit të parë. Ai vepronte kur nuk ishte i
12 pranishëm zëvendëskomandanti i parë ose kur nuk ishte, kishte
13 mundësi të ushtronte detyrën.

14 Kështu ka qenë, apo jo?

15 Dhe ju pastaj --

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po nuk dha
17 përgjigjen.

18 Pyetja ishte, a e keni thënë këtë, z. Zyrapi?

19 DËSHMITARI: Po.

20 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim]

21 PY. Më tej, ju shtuat:

22 "Po, në bazë si rregull, si rregull, si rregull kështu
23 funksionon, në bazë të rregullave ushtarake kështu
24 funksionon."

25 A ju kujtohet, z. Zyrapi?

1 PË. Po, saktë.

2 PY. A është e vërtetë, z. Zyrapi, se UÇK-ja nuk ka
3 funksionuar sipas rregulloreve ushtarake tradicionale?

4 PË. Është e vërtetë që nuk ka funksionu. Janë kanë në
5 zhvillim të saj.

6 PY. Dhe as nuk kishte burime të mjaftueshme për të
7 funksionuar si një ushtri e rregullt?

8 PË. Domethënë, burime, domethënë, resurse nuk ka pas të
9 tilla, për me funksionu plot. Duke e marrë, që e spjegova dhe
10 ma herët, tu e marrë prej institucioneve shtetërore që duhet
11 t'i ketë, që s'i ka pas, e deri te zhvillimi i saj që është
12 shku gradualisht që s'ka arrit të përfundonte në fund.

13 PY. Ju folët për rregullat ushtarakë, por nuk na përmendët
14 ndonjë rregull konkret apo ndonjë dispozitë të veçantë që
15 trajton faktin që një zëvendëskomandant është vartës i
16 zëvendëskomandantit tjetër, kështu?

17 PË. Po, ashtu është, saktë.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

19 Alagendra, duhet ta mbyllim tani.

20 Dëshmitar, përfunduar për sot. Faleminderit që ishit me
21 ne. Nesër do të përfundoni deri në orën 11.00, besoj se do ju
22 bëhet qejfi ta dëgjoni këtë.

23 Faleminderit dhe një herë. Mund të dilni tani nga salla.

24 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Roberts,

1 kishit një kërkesë.

2 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit. Nuk isha shumë i
3 qartë sot paradite për një nga afatet që shtytë. Ju miratuat
4 shtyrjen e afatit për përgjigjen ndaj mocionit të rregullës
5 154, që kishte numrin F250, besoj. Do të kërkonim dhe një
6 shtyrje afati për përgjigjen që lidhet me njoftimin e
7 dëshmitarëve nëse do të kemi ndonjë kundërshtim për dokumentet
8 që do të përdoren. Ju e dini që dokumentet ngarkohen
9 paralelisht nga Prokuroria. Pra, unë kërkoja shtyrje për
10 dëshmitarët e rregullës 154, por nuk ju kërkoja shtyrje edhe
11 për dokumentet korrespondues. Pra, do ju lutesha që të
12 dorëzoja edhe përgjigjen për këtë dokumente, brenda 23
13 gushtit, flasim për dëshmitarët që nuk do të japin dëshmi
14 menjëherë pas pushimit.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duhet të ma
16 kishe thënë kur më funksiononte ende kujtesa.

17 Z. ROBERTS: [Përkthim] Keni të drejtë, duhet ta kisha
18 bërë që në fillim.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pa problem.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Kam dy çështje organizimi. Një
21 lidhet me kërkesën e Prokurorisë për ndryshimin e provës
22 P1449, nuk kemi kundërshtime.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë,
24 ndryshohet prova P144 [Sipas përkthimit] siç u propozua nga
25 Prokurorja.

1 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Në rregull, atëherë.
2 Atëherë, ky dokument tani merr numrin P01449, dhe në shqip dhe
3 në anglisht, dhe zëvendësohet faqja 1449 me faqen 1462. Pra,
4 kemi -- ju kërkoj ndjesë, do ta filloj nga e para. Kemi faqet
5 1451, 1462, dhe 1472 tashmë si pjesë e kësaj prove.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe diçka tjetër për t'ju njoftuar
7 paraprakisht. Kur përfundoi pyetjet z. Emmerson, besojmë që ka
8 pasur një gabim në transkript dhe kërkojmë një verifikim
9 zyrtar. Në faqen 120, rreshti 2, ai tha, këtu thuhet sikur ai
10 ka thënë:

11 "Përputhet me realitetin."

12 Por besojmë që ai ka thënë që:

13 "Nuk përputhet me realitetin".

14 Ju lutem, të bëhet një verifikim për këtë, desha t'ju
15 njoftoja paraprakisht.

16 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Është në faqen 9451, 9462, 9472.
17 Por besoj që është e qartë nga parashtrimet e mëhershme.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mbrojtja e
19 Krasniqit keni përdorur 45 minuta, keni edhe një orë e një
20 çerek nesër, për pyetjet e mbetura, znj. Alagendra.

21 Maksimumi i kohës që mund t'ju japim.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësit
23 Smith. Kam një kërkesë për ZPS-në.

24 Z. Misetic, ka aftësi të jashtëzakonshme gjuhësore, dhe
25 ka ngritur një paqartësi për përkthimin me shkrim që është

1 bërë në një nga dokumentet, në qoftë se ju kujtohet, ju lutem
2 verifikoni përkthimin me shkrim nëse vërtet ka pasur një
3 problem të përkthimit.

4 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po, e morëm shënim kërkesën e z.
5 Misetic dhe po kryhet kjo, po realizohet kjo kërkesë.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Fillojmë
8 nesër në orën 9.00, më falni.

9 --- Seanca mbyllet në orën 16.33

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25